




**Muhammad Shafiq
Mohammed Abu-Nimer**

DIALOGU NDËRFETAR

UDHËZUES PËR MUSLIMANËT

Prishtinë, 2018



DIALOGU NDËRFETAR
UDHËZUES PËR MUSLIMANËT

Muhammad Shafiq, Mohammed Abu-Nimer

Dialogu ndërftar: udhëzues për muslimanët

Titulli origjinal: *Interfaith Dialogue: A Guide for Muslims*

Copyright © 2011 International Institute of Islamic Thought

Edicioni i parë në gjuhën shqipe. Copyright © 2017 Fakulteti i Studimeve Islame – Prishtinë

Përktheu dhe përshtati nga gjuha angleze: Besa Ismaili Ahmeti

Boton: Bashkësia Islame e Republikës së Kosovës, Fakulteti i Studimeve Islame – Prishtinë | **për botuesin:** Prof. asoc. dr. Fahrush Rexhepi, dekan | **lektura:** Festime Mehdiu | **ballina:** Bashkim Mehani | **realizimi kompjuterik:** Suhejb Xhemaili | **shtypi:** _____ | **tirazhi:** 500 copë | Prishtinë, 2017.

Muhammad Shafiq
Mohammed Abu-Nimer

**DIALOGU
NDËRFETAR**
UDHËZUES PËR MUSLIMANËT

Ky libër është botuar me ndimën e
Institutit ndërkombëtar i mendimit islam (IIIT)
dhe Qendra për Studime të Avancuara (CNS).

PËRMBAJTJA

MIRËNJOHJET	9
PARATHËNIE	11
PARATHËNIA	13
E BOTIMIT TË DYTË	13
HYRJE.....	17
QËLLIMI.....	17

KAPITULLI I

DIALOGU I BRENDSHËM DHE NDËRFETAR	29
PËRKUFIZIMI I DIALOGUT NDËRFETAR	29
NJË HISTORI E SHKURTËR E DIALOGUT MODERN NDËRFETAR NË PERËNDIM	32
PSE NJË PJESË E MUSLIMANËVE E KUNDËRSHTOJNË DIALOGUN NDËRFETAR.....	37
PËRKUFIZIMI I EKUMENIZMIT DHE ANALIZIMI I RËNDËSISË SË TIJ HISTORIKE.....	43
A ËSHTË DUKE KRIJUAR NJË RELIGJION DIALOGU NDËRFETAR?	45
SFIDAT: SHFAQJA E UNGJILLËZIMIT RADIKAL.....	48
MBËSHTETJA PËR DIALOGUN NDËRFETAR	51
DISA PIKA KRYESORE TË KËTIJ KAPITULLI.....	53
PYETJE PËR DISKUTIM.....	54

KAPITULLI II	
UDHËZIMET PËR DIALOG TË BRENDSHËM DHE	
NDËRFETAR.....	55
PARIMET UDHËZUESE:³.....	57
NIVELET E DIALOGUT NDËRFETAR.....	67
NIVELET TJERA TË DIALOGUT NDËRFETAR DHE	
PJESËMARRËSIT	72
TEMAT E SUGJERUARA.....	75
PLANIFIKIMI I PROGRAMEVE NDËRFETARE	81
PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT	83
PYETJE PËR DISKUTIM.....	84

KAPITULLI III	
PERSPEKTIVAT KURANORE TË DIALOGUT	
NDËRFETAR	85
DISA TERME KURANORE	85
SHEMBUJT KURANOR TË PAJTIMIT FETAR DHE	
BASHKËKZISTENCËS PAQËSORE	92
PËRDORIMI I KURANIT PËR TË ADRESUAR ÇËSHTJE	
SFIDUESE	96
KUFR.....	97
VALI	103
A DO TË HYJNË TË KRISHTERËT DHE HEBRENJËT NË	
PARAJSË SIPAS ISLAMIT?	106
DAR AL-ISLAM.....	111
DHIMMI.....	114
XHIZJA.....	116
BASHKËJETESA PAQËSORE DHE TË DREJTAT FETARE	
DHE NJERËZORE.....	117
PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT	122
PYETJE PËR DISKUTIM.....	122

KAPITULLI IV

TRAJTIMI I JOMUSLIMANËVE NË DRITËN E SIRAH TË PROFETIT DHE HISTORIA MUSLIMANE	125
BASHKËVEPRIMET E PROFETIT MUHAMED	
ME MEKASIT	126
MUHAMEDI FALET PËR FITOREN BIZANTINE NDAJ PERSIANËVE	128
MBRETI I KRISHTERË E ETIOPISË MIRËPRET	
REFUGJATËT MUSLIMANË	128
MUHAMEDI NË MEDINË	130
DELEGACIONI I KRISHTERË NGA NAJSPAN	132
PAKTI I HUDAYBIYYAH	133
PERIUDHA ABASIDË DHE PROMOVIMI I DIALOGUT	
NDËRFETAR	134
ANDALUZIA DHE DIALOGU NDËRFETAR	137
KRYQËZATAT DHE SULLTAN SALAH AL DIN AL AYYUBI (SALADIN)	140
PERIUDHA OSMANE.....	141
PERIUDHA BASHKËKOHORE.....	142
PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT	145
PYETJE PËR DISKUTIM.....	146

KAPITULLI V

BESIMET IBRAHIMIKE:	
RAST STUDIMI NGA PËRVOJAE E ROÇESTERIT.....	147
NEVOJA PËR DIALOG	147
DIALOGU HEBRE-MUSLIMAN	151
SFIDAT AKTUALE NDËRMJET PJESËTARËVE MUSLIMANË NË DIALOG	153
BESIMET IBRAHIMIKE: SHEMBUJ BASHKËKOHORË TË DIALOGUT NDËRFETAR	156
KËSHILLA PËR FORMIMIN E PROGRAMEVE	
NDËRFETARE	160

PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT	163
PYETJE PËR DISKUTIM.....	164
PËRFUNDIM	167
SHTOJCAT.....	171
SHTOJCA I	
DEKLARATA E PARË E ALEKSANDRISË	171
SHTOJCA II	
KOMISIONI PËR MARRËDHËNIET NË MES TË	
KRISHTERËVE DHE MUSLIMANËVE	174
SHTOJCA III	
KOMISIONI PËR MIRËKUPIM NË MES TË HEBRENJËVE	
DHE MUSLIMANËVE (KMHM).....	177
SHTOJCA IV	
NJË MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI..	179
SHTOJCA V	
DIALOGU KATOLIK - MUSLIMAN (DKM) I VIRGJINIAS	
VERIORE	181
SHTOJCA VI	
ZOTIMI PËR PËRKUJTIM DHE ANGAZHIMI PËR PAQE	184
SHTOJCA VII	
DISA PROGRAME MODEL TË DIALOGUT NDËRFETAR	186
SHTOJCA VIII	
TRAJTIMI I UDHËHEQJES MUSLIMANE: SENSIBILITETI	
NDAJ BESIMEVE TË KRESHTERA.....	192
SHTOJCA IX	
VLERËSIMI I PËRVOJËS/PROGRAMIT TUAJ NDËRFETAR	193
SHTOJCA X	
DEKLARATAT QË MBËSHTESIN DIALOGUN NDËRFETAR.....	195
SHËNIME	197
BIBLIOGRAFIA	211

MIRËNJOHJET

KY udhëzues është sponsorizuar nga Granti për Transformim të Konflikteve, një projekt ndërfetar i bashkë-menaxhuar nga Fuller Seminary dhe Instituti Salam për Paqe dhe Drejtësi (lehtësues i konzorciumit) me Shoqërinë Islamike të Amerikës së Veriut (SHIAV) dhe Fakulteti i Shkencës Shoqërore Islame (FSHSHI).

Falënderojmë SHIAV, posaçërisht Dr. Sayyid M. Syeed dhe Dr. Louay Safi, dhe Institutin Ndërkombëtar të Mendimit Islam (INMI) për mbështetjen e tyre profesionale dhe morale. Institutin Salam për Paqe dhe Drejtësi dhe Qendrën për Studime Ndërfetare dhe Dialog (QSND) që njohin kontributet e veçanta të Projektit për Transformimin e Konflikteve që udhëhiqet nga Shkolla Teologjike Fuller. Pa mbështetjen e tyre financiare, ky projekt nuk do të mund të realizohej. Duke iu falënderuar Dr. Aly Nahas për korrekturë të dorëshkrimit dhe për sugjerimet e vlefshme, Louai Haffar-it për kontrollimin e fusnotave, dhe shumë të tjerë që na ndihmuan në këtë detyrë të shenjtë. Falënderojmë Imamin Yusuf Zia Kavacki, Imamin Abolfazal Nahidian, Imamin Ahmedin Taquddin, Imamin Zafeer Khan, Imamin Abdul Malik Johari, Dr. Iqbal Unus, Louai Haffar, Dr. Louay Safi dhe Dr. Ashraf Adeel për pjesëmarrje në konferencën dy-ditore të mbajtur më 09-10 qershor 2006, për të rishikuar dhe përmirësuar dorëshkrimin. Në fund, falënderojmë shumë mikun tonë George Dardess për redaktimin dhe komentet e tij të çmuara.

PARATHËNIE

Instituti ndërkombëtar i mendimit islam (INMI) ka kënaqësinë të prezantojë këtë botim të dytë të rëndësishëm dhe në kohë të Dialogut Ndërfetar nga Muhammad Shafiq dhe Mohammed Abu-Nimer.

Angazhimi i muslimanëve me pjesëtarët e besimeve të tjera, në veçanti të Krishterimit dhe Judaizmit, ka qenë, i fuqizuar nga Kurani, gjithnjë një komponentë e rëndësishme e takimit të Islamit me të Tjerët. Andaj, edhe pse një term relativisht modern, dialogu ndërfetar ka pasur në fakt një histori të gjatë dhe të qëndrueshme për muslimanët, të theksuar nga një frymë e mirëfilltë hetimi dhe shkëmbimi plot respekt.

Roli primar i dialogut ndërfetar është të largojë keqkuptimet dhe të pranojë dallimin, duke pasur për qëllim të krijojë një klimë të bashkëjetesës paqësore dhe të marrëdhënieve harmonike shoqërore. Dhe kjo mbase është më e nevojshme sot se asnjëherë më parë, pasi që njerëzve po u bëhet thirrje gjithnjë e më shumë të praktikojnë tolerancën në një botë dukshëm të paqëndrueshme, ku të jetuarit dhe puna e përbashkët në diversitet është duke u bërë shpejt normë. Dialogu ndërfetar nuk është aspak i lehtë, reagimi mbrojtës, shkëmbimi i mundimshëm dhe një dëshirë e madhe për të shmangur një kompromis të perceptuar të parimeve thellë të rrënjosura janë disa nga kurthet që mund të ftohën lehtë angazhimin dhe përpjekjet më të mira. Në këtë pikë, ky libër jep një kontribut të rëndësishëm. Sepse ai është projektuar si një udhëzues për muslimanët, të cilët janë të interesuar apo të përfshirë në ndërtimin e marrëdhënieve me të krishterët dhe hebrejët, me qëllim të mirëkuptimit, vlerësimit dhe lavdërimit të besimeve përkatëse.

Aty ku datat citohen sipas kalendarit Islam (hixhret) ato janë të shënuara. Përndryshe, ato pasojnë kalendarin Gregorian dhe janë të shënuara aty ku është e nevojshme. Fjalët arabe janë të shkruara me shkronja italiane, përveç atyre që kanë hyrë në përdorim të përgjithshëm. Shenjat diakritike janë shtuar vetëm për ata emra arab që nuk konsiderohen bashkëkohor.

INMI, i themeluar në vitin 1981, ka shërbyer si një qendër kryesore për të lehtësuar përpjekjet e sigërtë dhe serioze shkencore të bazuara në vizionin, vlerat dhe parimet islame. Programet e saj kërkimore, seminarët dhe konferencat gjatë këtyre tridhjetë viteve të fundit kanë rezultuar me publikimin e më shumë se katërqind titujve si në anglisht ashtu edhe në arabisht dhe në gjuhë të tjera të mëdha.

Dëshirojmë të ju shprehim falënderimet tona autorëve: Muhammed Shafiq dhe Mohammed Abu-Nimer, si dhe redaktoret Dr. Kathryn M. Mathews për cilësinë e punës së saj. Falënderimet i dedikohen edhe ekipit redaksional dhe të produksionit të Zyrës INMI në Londër, ku bëjnë pjesë Salma Mirza dhe Dr. Merjem Mahmood.

*Zyra e INMI në Londër
Gusht, 2011*

PARATHËNIA E BOTIMIT TË DYTË

Një grup i dijetarëve të Lindjes së Mesme vizitoi Qendrën Islame të Roçesterit, Nju Jork, në vitin 2010. Njëri prej tyre diskutoi mbi dialogun ndërftetar. Fjalët e tij hasën në rezistencë. Situata doli jashtë kontrollit kur u bë një koment nga një person në audiencë se dialogu ndërftetar është *Kufr* (mosbesim) dhe ata që përfshihen në dialog ndërftetar duhet të verifikojnë përkushtimin e tyre ndaj Islamit. Dijetari u paralajmërua për zjarrin e xhehenemit për arsye të mbështetjes së dialogut ndërftetar. Zërat u ngritën dhe moderatori bëri më të mirën e tij për të marrë situatën nën kontroll.

Që nga viti 2007, pas publikimit të këtij libri, kanë ndodhur shumë zhvillime në botën muslimane në mbështetje të dialogut ndërftetar. Shtytja kryesore erdhi nga Arabia Saudite kur Mbreti Abdullah sponsorizoi Konferencën Ndërftetare në Madrid në vitin 2008. Sot, është duke u zhvilluar dialog ndërftetar në vendet muslimane si në nivel shtetëror ashtu edhe në nivel publik. Shumë muslimanë që jetojnë në Perëndim, duke përfshirë SH-BA-të dhe Kanadanë, janë pjesëmarrës aktivë në dialogun ndërftetar, por dialogu ndërftetar ende duhet të zhvillojë pranim të gjerë në mesin e muslimanëve. Ekzistojnë dy pengesa të mëdha me të cilat duhet të merren muslimanët që marrin pjesë në dialogun ndërftetar:

Së pari, dialogu ndërftetar është një aktivitet fetar. Por shumë muslimanë që shkojnë në xhami për adhurim të përditshëm janë kundër ose kanë mendime negative për dialogun ndërftetar.

Në shumë xhami anembanë Amerikës aktiviteti ndërftetar është i rrethuar me polemika. Qendrat Islame në Amerikë që drejtohen kryesisht nga profesionistë e kanë të vështirë të njoftojnë për aktivitetet ndërftetare publikisht. Është edhe më e vështirë të ketë aktivitet ndërftetar në xhamitë e vendeve muslimane. Ne kemi shpresuar që ky libër do të inkurajonte një dialog të brendshëm musliman nëpër xhami për çështjen e dialogut ndërftetar që do të edukojë besimtarët për kuptimin, fushëveprimin dhe përdorimin bashkëkohor të dialogut modern ndërftetar sipas perspektivave islame. Ekziston një shqetësim që xhamitë do të përçahen nëse besimtarët nuk edukohen siç duhet në këtë fushë.

Së dyti, imamët shpesh hezitojnë të marrin pjesë në dialog ndërftetar. Disa imamë kanë idenë e gabuar se dialogu ndërftetar ka për qëllim të krijojë një fe qytetare. Udhëheqës të tjerë njohin rëndësinë e tij por i frikësohen reagimeve negative nga personat që shkojnë përditë në xhami duke shmangur në mënyrë të hapur pjesëmarrjen në dialog ndërftetar. Ata imamë të cilët hapur marrin pjesë në dialog përballen me akuza nga disa besimtar si: “shkuarja në ferr”, “ringjallja me hebrenjtë dhe të krishterët në ditën e gjykimit”, dhe një pjesë e praktikuesve hezitojnë të falen pas imamëve të tillë. Mendojmë se ky libër do të inkurajojë trajnimin e imamëve për dialog të brendshëm dhe ndërftetar, për të kuptuar polemikat e tilla dhe pastaj për edukimin e besimtarëve për dialogun ndërftetar. Ekziston një nevojë po aq e madhe për kuptimin dhe mësimin e dialogut të brendshëm dhe ndërftetar në xhamia, ashtu siç ekziston nevoja për mësimin e Kuranit, Haditheve, Fikhut, dhe lëndëve të tjera në Islam.

Ne gjithashtu shpresojmë se ky libër do të mësohet si pjesë e programit mësimor të fundjavës për të rinjtë e shkollave. Rinia jonë është e ardhmja jonë; mënyra se si ne i trajnojmë ata dhe sesi i mësojmë ata do të përcaktojë suksesin e tyre dhe shërbimin tyre dhënë komunitetit musliman në të ardhmen, si dhe botës në përgjithësi. Për fat të keq, mësimi i feve të botës dhe të kuptuarit e dialogut ndërftetar rrallëherë po ndodhë madje edhe në shumë xhami në Amerikë.

Kurdo që ka dialog ndërftetar, jomuslimanët pyesin për kon-

ceptet e *dhimmi*, *xhizje*, *Dar al-Islam* si dhe zbatimet e *kufri*, *uali* dhe nëse të krishterët dhe hebrenjët do të hyjnë në *Xhennet* (Parajsë).

Këto tri të fundit ishin në botimin e parë; ne i kemi shtuar tri të parat në botimin e dytë. Më tej, ne i kemi shtuar katër shtojcat e fundit botimit të ri. Këto indekse do të ndihmojnë në organizimin e dialogut ndërfaqetor dhe zbatimit të suksesshëm të tij. Po ashtu, ne kemi redaktuar dhe kemi bërë ndryshimet e duhura në gjithë tekstin për të përmirësuar dhe për të bërë botimin e ri të kuptueshëm. Për t'i bërë muslimanët të vetëdijshëm për urgjencën e dialogut ndërfaqetor, ne i kemi disa grafika në parathënie për të demonstruar se si shihen muslimanët në botën tonë sot duke e bërë të qartë se nuk ekziston alternativë tjetër përveç se të bëhen pro-aktiv dhe të përfshihen në dialogun ndërfaqetor.

Falënderoj INMI për përpjekjet e tyre të vazhdueshme në promovimin e diturisë dhe dialogut ndërfaqetor dhe përkrahjen e nevojave arsimore të muslimanëve në Amerikë dhe në pjesën tjetër të botës. Të shpenzuarit në ngritjen e njohurive njerëzore dhe të kuptuarit njerëzor të çështjeve të vështira që çojnë në bashkëjetesën paqësore është bamirësia më e madhe në Islam që njeriu mund t'i japë krijimit të Zotit. Ju lutemi lexoni këtë libër me zemër dhe mendje të hapur. Na falni nëse ekziston ndonjë gabim i paqëllimtë dhe Zoti i Plotfuqishëm e di më së miri.

Muhammad Shafiq
Rexheb 20, 1451, 3 korrik 2010

HYRJE

QËLLIMI

KUR marrim parasysh historinë dhe mësimet e Islamit, shohim se Muslimanët kanë një trashëgimi të gjatë të jetuarit në lagje dhe shoqëri multi-fetare. Islami njih shumë fe dhe kërkon që muslimanët të respektojnë fetë e tjera. Në përgjithësi, muslimanët i janë përgjigjur pozitivisht kësaj thirrjeje, e cila është evidente në burimin e pasur historik të dialogut që reflekton komunikim të suksesshëm me të gjitha nivelet e shoqërisë. Ky libër është i projektuar për të udhëzuar muslimanët, të cilët janë të interesuar dhe/ose të përfshirë në ndërtimin e marrëdhënieve me hebrenjtë dhe të krishterët.¹ Siç shpjegon ky udhëzues, Kurani urdhëron muslimanët të respektojnë fetë e tjera dhe pasuesit e tyre. Profeti Muhammed (SAVS)* gjithmonë është përpjekur për pajtimin me fetë e tjera. Ai pikëlluhej me të krishterët kur persianët adhuroes të zjarrit mundën bizantinët e krishterë (Kuran 30:1-6).² Kur Profeti dhe muslimanët tjerë u shpërngulën në Medine, ai nënshkroi një pakt me fiset e saj hebreje për të jetuar së bashku në paqe. Muslimanët jo vetëm që kanë jetuar në paqe dhe kanë respektuar hebrenjtë dhe të krishterët, por kur muslimanët hynë në nën-kontinentin indian, ata u sollën në të njëjtën mënyrë ndaj hindusëve dhe budistëve.

Në librin e tij, *Islami*, Ismail R. al-Faruqi thekson se Traktati i Profetit me fiset hebreje të Medinës i njihte ato si një Umet

* (SAVS) – *Salallahu alejhi ve selam*. Paqja dhe mëshira e Allahut qofshin mbi të, thuhet: Kurdo që përmendet emri i Profetit Muhammed.

(një komunitet fetar), një term i përdorur në Kuran për muslimanët. I njëjti emërtim iu dha të krishterëve dhe, më vonë në nën-kontinent, hindusëve dhe budistëve. Si rezultat i kësaj, Islami garantoj që të drejtat themelore të çdo komuniteti fetar dhe liria fetare do të ishin të mbrojtura.³

Sikurse paraardhësit e tyre, ashtu edhe shumë muslimanë të sotëm janë të etur për të promovuar dialogun ndërftetar. Por, përta bërë këtë në mënyrë efektive, ata duhet të kuptojnë sfidat me të cilat ballafaqohen ata në lidhje me jomuslimanët.

Ndër këto janë zotërimi i terminologjive bashkëkohore dhe zbatimi i saktë i tyre, krijimi i institucioneve dhe strukturave për të lehtësuar marrëdhëniet e tilla, fuqizimi profesional i muslimanëve me njohuritë e nevojshme për të arritur tek komuniteti i tyre fetar, duke adresuar realitetet politike të dhunës dhe persekutimit në mënyrë efektive, dhe për të identifikuar metodat konstruktive dhe efektive të qasjes ndaj Islamit.

Një pjesë e muslimanëve ngrenë shqetësime rreth dialogut ndërftetar, siç është rreziku i përzierjes së mësimëve islame me mësimet e tjera fetare. Ata e shohin dialogun ndërftetar si një përpjekje për të krijuar një fe nëpërmjet bashkimit në parimet kryesore të të gjitha feve ose duke krijuar një fe qytetare me adhurim, rituale dhe lutje të përbashkëta. Ky shqetësim mund të mënjanohet vetëm përmes një kuptimi të përbashkët të madhështisë dhe të veçantisë së çdo feje, siç manifestohet përmes praktikës së lirë dhe të pastër të pasuesve të fesë së tyre dhe të respektimit të të gjitha feve të tjera. Kurani thekson këtë të vërtetë duke insistuar se bukuria në botë qëndron në pluralizmin e saj racor dhe fetar; përndryshe, Zoti nuk do ta krijonte atë të tillë (10:99⁴; 5:48⁵).

Pjesëmarrës të tjerë muslimanë ngatërrojnë dialogun ndërftetar me *davet* (thirrje në Islam). Dialogu ndërftetar nuk duhet konsideruar si një mundësi për të konvertuar të tjerët, sepse përdorimi i programeve të tilla në këtë mënyrë bën që pjesëmarrësit të marrin qëndrim mbrojtës dhe ka tendencë që t'i largojë ata krejtësisht nga dialogu. Dialogu i vërtetë ndërftetar qëndron mbi parimin qëndror që ai të mos përdoret për konvertim fetar. Përveç kësaj, një pjesë e muslimanëve konsiderojnë se ak-

tiviteti ndërfetar është sinonim i ekumenizmit dhe kështu një përpjekje nga ana e shumicës së krishterë për të konvertuar të tjerët. Ajo që këta njerëz duhet të kuptojnë është se në leksikon e sotëm, aktiviteti ndërfetar nënkupton një dialog midis feve të ndryshme.

Një çështje tjetër që pengon pjesëmarrjen e muslimanëve është besimi se një dialog i tillë nuk është më shumë se një debat polemizues midis teologëve të feve të ndryshme që filloi shekuj më parë në mes të teologëve muslimanë dhe të krishterë dhe vazhdoi deri në periudhën moderne, veçanërisht nën kolonializëm. Sidoqoftë, qëndrimet agresive dhe polemizuese nuk kanë të bëjnë asgjë me dialogun ndërfetar.

Ky udhëzues është një iniciativë edukuese që kërkon të qartësojë këto dhe idetë e ngjashme të gabuara dhe ndihmon në përkufizimin dhe prezantimin e dialogut ndërfetar në përdorimin e tij bashkëkohor në këtë kontekst, Dialogu ndërfetar ushqen mirëkuptimin dhe ndërton ura për bashkëjetesë paqësore.

Pra, *Udhëzuesi ndërfetar për muslimanët* ofron:

- Një udhëzues për të përgatitur si liderët ashtu edhe pjesëmarrësit për një marrëdhënie bashkëbiseduese me jomuslimanët.
- Një sqarim i dialogut si një formë e komunikimit që dallon nga debatet tipike logjike ose teologjike që përdoren si në mes të muslimanëve ashtu edhe në mes të muslimanëve dhe jomuslimanëve.
- Një mjet për të edukuar dhe për të qartësuar terminologjinë në mënyrë që të mund të shmangen idetë e gabuara në lidhje me grupet ndërfetare.
- Një metodë për të përkujtuar muslimanët për *adab* (rregullat e mirësjelljes) dhe etikën e mospajtitimit bazuar në Kuran dhe në Sunnet në mënyrë që ata të mund të arrijnë formën më efikase të komunikimit.

Ekzistojnë edhe çështje lokale. Muslimanët që jetojnë në Perëndim janë të ndarë përsa i përket çështjes së pjesëmarrjes në dialogun ndërfetar, madje deri në atë shkallë sa disa xhami

nuk pranojnë të zhvillojnë shura(konsultim reciprok) me ato xhami që janë të përfshira në dialogun ndërftetar. Në të vërtetë, disa imamë e konsiderojnë dialogun ndërftetar si bidat (risi jo-islame).

Se a është kjo pikëpamje e saktë apo a është i nevojshëm dialogu ndërftetar me të vërtetë nga Islami është një çështje që muslimanët duhet ta adresojnë në bisedat e tyre ndërftetare. Ne shpresojmë që duke eksploruar dialogun ndërftetar në një nivel të brendshëm islam së pari, komuniteti musliman, pasi të ketë qartësi për vetë fenë dhe besimet e veta, do të vazhdojë të zhvillojë besimin në vetvete dhe aftësitë e nevojshme për të marrë pjesë në mënyrë efektive në një dialog ndërftetar.

Në shumë konferenca të kohëve të fundit, dijetarët muslimanë kanë diskutuar nevojën për një udhëzues gjithëpërfshirës si ky.⁶ Dhe megjithatë, pavarësisht nga kjo nevojë e qartë, të cilën e kanë ndjerë edhe dijetarët dhe praktikuesit e dialogut ndërftetar, gjithçka që ekziston janë artikuj të ndryshëm të shkruar nga dijetarët muslimanë të angazhuar në këtë ndërmarrje. Në këta artikuj, ata paraqesin mendimet e tyre lidhur me atë se çfarë thotë Islami për marrëdhëniet në mes të muslimanëve dhe jo muslimanëve dhe tolerancën fetare (p.sh., Jamal Badawi, Muhammad Siddiqi, Sayyid M. Sayeed, Louay Safi, Ghulam Haider Aasi dhe Mohammed Abu-Nimer). Edhe pse janë shumë të çmuar, këta artikuj nuk e adresojnë dialogun ndërftetar për muslimanët në ndonjë mënyrë të plotë dhe sistematike.

Është e qartë se sot është e nevojshme një qasje e tillë gjithëpërfshirëse. Sulmet verbale mbi muslimanët dhe Islamin nga mediat perëndimore kanë ngatërruar shumë amerikanë dhe evropianë për natyrën paqësore të Islamit. Megjithatë, një armiqësi të tillë kundër muslimanëve nuk është një trend i kohëve të fundit. Historikisht, Islami mori stereotipin e “armikut tjetër,” një stereotip që u ngrit gjatë kryqëzatave dhe Rilindjes. Gjatë shekullit të nëntëmbëdhjetë, ai u zbatua përmes hijeve të holla të paragjykimit, të tilla si disiplina e re akademike e orientalizmit. Shekuj të ideve të shtrembëruara kanë ndikuar që perëndimorët të jenë dyshues dhe të kenë frikë Islamin dhe Muslimanët.

Pas Luftës së Dytë Botërore, ngritja e lëvizjeve çlirimtare kombëtare dhe luftërat antikolonialiste në kolonitë muslimane, veçanërisht në Palestinë dhe në vendet e tjera arabe, ka rezultuar me një imazh edhe më të frikshëm. Së shpejti, ky imazh i atribuhet gjithë muslimanëve, qofshin ata arab apo jo. Edhe pse luftërat e tilla kanë për qëllim në mënyrë të qartë arritjen e pavarësisë kombëtare, perëndimorët i perceptuan ato si akte të agresionit që ishin të drejtuara kundër tyre drejtpërdrejt. Revolucioni iranian është një rast i tillë.

Filmat e Hollivudit sigurojnë një indeks të dobishëm mbi stereotipat anti-muslimanë në perëndim. Shumë filma kanë përdorur si Lindjen e Mesme ashtu edhe Islamin për të krijuar një atmosferë ekzotike, të dhunshme. Për fat të keq, ata janë prodhuar kryesisht duke mos pasur njohuri për natyrën e vërtetë të aspekteve kulturore dhe fetare të Islamit. Në filmat e Hollivudit, Jezusi dhe Moisiu përdorin arsyen e përndritur për të shpëtuar shpirtrat e njerëzve; Muhammedi është portretizuar me një shpatë, duke promovuar konvertimin e detyruar ose vdekjen. Shkrimtarë popullor perëndimor të shekullit XIX kanë paraqitur Islamin si një produkt të Djallit dhe anti-Krishtit.


Kultura popullore nuk është burimi i vetëm që keqinterpretton Islamin. Aktualisht, një pjesë e klerit të krishterë predikojnë se Islami është një fe e Djallit dhe errësirës. Është kritikuar gjuha e tyre e pabazë dhe nxitëse. Si Laurie Goodstein, autor i veprës “Të parit e Islamit si Besim’i keq, Ungjillorët kërkojnë të konvertuarit,” thekson: “Gjuha e ashpër nga udhëheqësit fetarë si Franklin Graham, Jerry Falwell, Pat Robertson dhe Jerry Vines, ish-president i Konventës Jugore Baptiste, është qortuar njëlloj si nga muslimanët ashtu edhe nga grupe të krishtera.”⁷ Për fat të keq, fuqia e mendimit ekstremist fetar në Shtetet e Bashkuara ka qenë në rritje.

11 shtatori 2001 dhe pasojat e tij ngritën shumë pyetje rreth mesazhit të Islamit të paqes dhe forcuan stereotipat negativ të Islamit dhe Muslimanët që ekzistonin më parë. Sot, shumë muslimanë në Perëndim jetojnë në frikë. Në vitin 2004, Këshilli për Marrëdhëniet Amerikano-Islame (KMAI)⁸ ka përpunuar 1.522 raporte të incidenteve për shkeljen e të drejtave qytetare

kundër muslimanëve, në krahasim me 1019 raste në vitin 2003. Kjo përbën një rritje prej 49 për qind përsa u përket rasteve të raportuara të ngacmimit, dhunës dhe trajtimit diskriminues dhe shënon numrin më të madh të rasteve të tilla të raportuara ndonjëherë në KMAI në historinë e tij njëmbëdhjetëvjeçare. Përveç kësaj, KMAI ka pranuar 141 raporte për krime potencialisht të dhunshme të urrejtjes anti-muslimane, një rritje prej 52 për qind nga 93 raporte të marra në vitin 2003. Dhjetë shtete përbënin pothuajse 79 për qind e të gjitha incidenteve të raportuara tek KMAI në vitin 2004: Kalifornia (20,17%), Nju Jorku (10,11%), Arizona (9,26%), Virgjinia (7,16%), Teksasi (6,83%), Florida (6,77%), Ohajo (5,32%), Merilendi (5,26%), Nju Xhersi (4,53%) dhe Illinois (2.96%).

Edhe nëntë vjet pas sulmeve të kryera kundër Shteteve të Bashkuara në vitin 2001, imazhi negativ i muslimanëve në Amerikë është në rritje. Grafiku i mëposhtëm I KMAI është një paralajmërim në lidhje me shkeljet e të drejtave qytetare në rritje që muslimanët janë duke i raportuar në Shtetet e Bashkuara. Muslimanët duhet të veprojnë me shpejtësi duke marrë hapa pozitiv për të luftuar urrejtje në rritje kundër tyre.⁹

Graph 1. Total Number of Civil Rights Complaints by Year




Amerikanët, gjithashtu, konsiderojnë që muslimanët përballen me më shumë diskriminim brenda SHBA-ve sesa grupet e tjera të mëdha fetare sipas sondazhit të PEW të vitit 2009. Gati gjashtë në dhjetë persona të rritur (58%) thonë se Muslimanët i nënshtrohen një diskriminimi të madh, shumë më tepër se të themi të njëjtën gjë për hebrenjtë, të krishterët ungjillorë, ateistët apo mormonët. Në të vërtetë, të gjitha grupet për të cilat është pyetur, vetëm homoseksualët dhe lezbiket konsiderohen se përballen me më shumë diskriminim se muslimanët, me gati dy të tretat (64%) e publikut që thonë se ekziston një diskriminimi madh ndaj homoseksualëve. Grafiku i sondazhit të PEW është i rëndësishëm për të kuptuar se si perceptohen muslimanët në Amerikë në krahasim me të tjerët:


<i>Compared with your religion, is...</i>	Very/ Somewhat <u>Similar</u>	Very/ Somewhat <u>Different</u>	<u>DK</u>
	%	%	%
Protestantism	44	38	18
Catholicism	43	49	8
Judaism	35	47	18
Mormonism	21	59	20
Islam	17	65	19
Buddhism	15	60	25
Hinduism	12	57	32

Based on respondents who are not affiliated with the religion in question. Those without a religious affiliation asked whether each is similar to or different from their own beliefs rather than their own religion.


Rezultatet më poshtë për pyetjen, “Sa jeni të shqetësuar, nëse jeni sadopak, në lidhje me ngritjen e ekstremizmit islamik në SHBA (Shtetet e Bashkuara të Amerikës)?” në mënyrë të qartë tregon ndjenjën në mesin e amerikanëve rreth muslimanëve madje edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.



Në krahasim me rezultatet ndaj një pyetje të ngjashme, “Sa jeni të shqetësuar, nëse jeni sadopak, në lidhje me ngritjen e ekstremizmit islamik nëpër botë këto ditë?” Gjetjet demonstrojnë që ata të cilët morën pjesë në studim nuk mund të bënin dallimin në mes të një ngritje të mundshme të ekstremizmit islam në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pjesës tjetër të botës.¹⁰



Imazhi musliman është më alarmues në Evropë në krahasim me SHBA-të. Një studim që ishte bërë nga qendra kërkimore Pew Global në vitin 2008 zbuloi pikëpamjet e mëposhtme të pafavorshme për muslimanët në vende të ndryshme evropiane:



Mediat vazhdojnë të përqendrohen në grupet e ashtuquajtura ekstremiste “muslimane” dhe jo në komunitetet pozitive, paqësore islame. Ky mbulim selektiv përfshin përdorimin e fotografive të grave që bartin hixhabin në kopertinat e revistave kryesore si *Newsweek* edhe pse harta dhe statistikat e artikullit përfshijnë statistika të grupeve etnike apo laike terroriste që nuk kishin lidhje me Islamin.¹¹ Madje edhe jeta e përditshme e muslimanëve është prekur.¹² Hyrja apo puna në zonat e sigurisë është bërë e vështirë dhe muslimanët vëzhgohen me kujdeskur bëjnë pazar, kur dretojnë makinat dhe kur janë duke ecur.

Si mundën muslimanët të tejkalojnë një paragjykim të tillë? Muslimanët duhet të mos bien në dëshpërim pasi të shikojnë këta grafikë dhe imazhe; megjithatë, ne duhet t’i marrim ato seriozisht.

Sipas mendimit tonë, angazhimi qytetar dhe dialogu ndërftetar janë dy metodat bashkëkohore që, kur përdoren siç duhet, mund të ndryshojnë perceptimet negative të njerëzve, të ndërtojnë marrëdhënie të mira dhe të fitojnë simpatitë. Muslimanët duhet të vënë energjitë dhe burimet e tyre në ndërtimin e urave dhe të largojnë idetë e gabuara për të siguruar një perceptim pozitiv për Islamin dhe muslimanët.¹³

Ky udhëzues u mundëson muslimanëve të arrijnë tek jomuslimanët për të larguar keqkuptime të tilla. Ai mbështet komunitetin musliman duke shfrytëzuar metoda paqësore islame ndaj dialogut ndërftetar dhe duke ndërtuar hapësirën dhe platformën e nevojshme për shkëmbim të suksesshëm. Ai e bën këtë me bindjen e fortë se një shkëmbim i tillë, larg nga dobësimi i besimit tonë, në të vërtetë e forcon atë.

Kapitulli i hulumton pse ky udhëzues është i nevojshëm dhe u përgjigjet dy kundërshtimeve që kanë një pjesë e muslimanëve për dialogun ndërftetar. Së pari, ai adreson kundërshtimin e tyre ndaj ekumenizmit, duke e përkufizuar këtë term në mënyrë të qartë dhe duke shpjeguar historinë e tij. Ai pastaj trajton etjen e tyre lidhur me dialogun ndërftetar duke qartësuar të dhënat historike që çuan në ngritjen e dialogut modern ndërftetar.

Kapitulli II merret me kufijtë dhe shtrirjen e këtij dialogu, si dhe atmosferën dhe mjetet e nevojshme për suksesin e tij.

Kapitujt III dhe IV kanë tri qëllime. Së pari, ato merren me çështje të tjera të ngritura nga ata muslimanë që e kundërshtojnë punën ndërftetare. Së dyti, ata përkujtojnë muslimanët se si Islami filloi me pluralizmin, se si muslimanët lulëzuan kur praktikuan pluralizmin, dhe se si ata krijuan një qytetërim të ri të bazuar në bashkëveprimin e lirë të muslimanëve dhe jomuslimanëve. Ato tregojnë në hollësi rrethanat që bënë të lulëzojnë shkencën dhe teknologjinë, si dhe artet dhe arkitekturën dhe kjo krijoi një civilizim të shënuar nga dinjteti njerëzor dhe mungesa e shqetësimit të racës dhe ngjyrës së njeriut. Qëllimi i tretë është të largojë idenë e gabuar se Islami është një fe përjashtuese. Prandaj, Kapitulli IV merret me disa ajete Kuranore që duket se thonë të kundërtën.

Kapitulli V paraqet disa shembuj të shoqërisë pluraliste që u ngrit gjatë epokës së artë të botës Islamike, një shoqëri e inkurajuar nga Islami dhe në të cilën njerëzit e të gjitha besimeve përparuan. Ai gjithashtu shpjegon se si duhet bërë dialogu ndër-fetar dhe si të edukohet publiku për bashkëjetesë paqësore në një shoqëri pluraliste fetare. Pos kësaj, ai merret me disa programe model për të ndihmuar partnerët tanë ndërfetar në hartimin e iniciativave të suksesshme të dialogut ndërfetar. Ne kemi mbledhur modele të aktiviteteve ndërfetare nga disa qytete dhe i kemi bashkuar ato për të mirën e të gjithëve.

Ne shpresojmë se një qasje e tillë gjithëpërfshirëse do ta bëjë këtë udhëzues vërtet të dobishëm si për muslimanët dhe jomuslimanët, ashtu që të gjitha palët të mund të bashkohen për të ndërtuar ura të mirëkuptimit.

KAPITULLI I DIALOGU I BRENDSHËM DHE NDËRFETAR

PËRKUFIZIMI I DIALOGUT NDËRFETAR

Fjala dialog rrjedh nga fjala dia (përtej, përmes) dhe fjala logos (bisedë, fjalë). Fjalori i Uebster e përkufizon thjeshtë dialogun si bisedë në mes të dy ose më shumë njerëzve. Në Kuran, fjala më e afërt për dialog është *yuhawir* (18:34; 18:37; 58:1), që nënkupton një bisedë në mes të dy individëve apo grupeve të njerëzve. Për shembull: “Shoku i tij i tha, duke biseduar me të *yuhawiru* [argument, bisedë]: “A e mohon ti Atë, i Cili të ka krijuar nga dheu...” (18:37).¹

Më përgjithësisht, në traditën islame, biseda në mes të individëve, grupeve dhe religjioneve shihet si e një rëndësie kryesore për një jetë më të mirë. Profeti nuk hezitonte t’i dëgjonte të tjerët, qofshin ata idhujtarë, Ithtarë të Librit (hebrenjë dhe të krishterë), apo vëlla muslimanë. Më vonë, do të analizojmë bashkëbisedimet e tij me axhën e tij Abutalib, Utbah ibn Rabl’ah (një lider fisnor Kurejshit i cili kërkoj pajtim), dhe një delegacion i krishterë nga Naxhrani.

Në të kuptuarit e tij ndërfetar, dialogu reflekton këtë kuptim islam të një bisede ndërmjet individëve dhe/ose grupeve. Qëllimi i dialogut nuk është të eliminojë dallimet në mendime dhe bindje, por për të arritur mirëkuptim dhe pranimin e këtyre dallimeve. Dialogu nuk ka të bëjë me përpjekjen për të mundur apo për të heshtur të tjerët, por ka të bëjë me të mësuarit, të kuptuarit dhe rritjen e njohurisë së njeriut për to.

Profeti ka thënë, “Shpirtrat janë si trupa të rekrutuar. Ata që njohin njëri-tjetrin do të zhvillojnë mirëkuptim të ndërsjellë dhe ata qëjanëtë huaj për njëri-tjetrin ka gjasa të kundërshtohen.”² Ky hadith e bën dialogun e brendshëm-fetar dhe ndërftetar një domosdoshmëri për të fituar një mirëkuptim më të mirë dhe për të ndërtuar ura në mes të komuniteteve të ndryshme. Shumë hadithe që gjinden në “Librin e Pajtitimit” të Buhariut nxjerrin po ashtu këtë në pah.

Qëllimet e dialogut janë të luftojnë kundër kushtëzimit negativ dhe fanatizmit dhe për t’i hapur derën të dëgjuarit, komunikimit dhe respektimit.³ Siç thekson Jaco Cilliers, një praktikues i dialogut ndërftetar: “Angazhimi në dialogun ndërftetar nuk nënkupton në asnjë mënyrë minimin e besimit ose traditës fetare të njeriut. Në të vërtetë, dialogu ndërftetar është konstruktiv vetëm kur njerëzit mbështeten në mënyrë të vendosur në traditat e tyre fetare dhe përmes atij procesi fitojnë një gatishmëri për të dëgjuar dhe respektuar besimet e feve të tjera.”⁴

Dialogu ndërftetar do të thotë mbajtja fort për besimin e dikujt duke u përpjekur njëkohësisht për të kuptuar besimin e një personi tjetër. Ai kërkon ndershmëri dhe respekt nga ata që marrin pjesë në të, në mënyrë që të dy individët të mund të paraqesin fenë e tyre sinqerisht. Uniformiteti dhe marrëveshja nuk janë qëllimet; më tepër, janë bashkëpunimi dhe kombinimi i forcave tona të ndryshme për të mirën e njerëzimit.

Përtej refuzimit të gjuhës së urryer, dialogu ndërftetar do të thotë përdorim i metodave të respektueshme për të rritur mirëkuptimin e ndërsjellë mes njerëzve fetarë.

Konsideroni si në vijim: Si do të ishte në qoftë se njerëzit e feve të ndryshme do të trajtonin njëri-tjetrin me përbuzje në vend se ta trajtonin me respekt dhe mirëkuptim?

Asnjë komunitet nuk mund të përparojë me një mentalitet të tillë dhe asnjë vend nuk mund të përparojë dhe të mbetet i qetë në qoftë se strehon urrejtje fetare dhe fanatizëm. Kurani urdhëron muslimanët të respektojnë fetë e tjera dhe të jenë të sjellshëm për pasuesit e tyre: “Nuk do të ketë shtrëngim në çështjet e besimit ...” (2:256).⁵

Në veprën e tij *Dialogu nga këndvështrimi islam*, Abbas al-Jirari shpjegon konceptin islam që qëndron pas dialogut:

Dialogu, i realizuar mbi këtë bazë islame, është mënyra ideale për të arritur të vërtetën. Megjithatë, kur reflektojmë – në dritën e asaj që ofron - në gjendjen e tanishme të jetës dhe njerëzimit, ne jemi të shtyrë të vijmë në përfundimin se është e nevojshme të vendoset mirëkuptim, fuqi, bashkëpunim dhe të ngushtohet hendeku (që rrjedh nga dallimet) midis njerëzve.⁶

Siç u diskutua më sipër, dialogu ndërjetar nuk kërkon të krijojë një fe të re ose të braktis bazat e Islamit; më tepër, ai përpiqet të krijojë një atmosferë paqësore për bashkëjetesë. Imamët do të mund të ishin mësues –udhëzues në këtë rrugë të dialogut –si për dialogun e brendshëm-musliman ashtu edhe për dialogun ndërjetar. Pjesëmarrja jonë në dialogun ndërjetar do të ofrojë kornizën për ne për të:

- Ri-mësuar artin e të dëgjuarit të njëri-tjetrit
- Kuptuar ngjashmëritë dhe dallimet tona përmes diskutimeve teologjike dhe filozofike në një nivel intelektual
- Vlerësuar spiritualitetin e njerëzve të tjerë duke mësuar për religjione të ndryshme përmes shkrimeve të shenjta, historive dhe tregimeve
- Punuar së bashku në projekte të përbashkëta në nivele të shumëfishta për të sjellë drejtësi më të madhe, ndihma humanitare dhe paqe për shoqërinë, dhe
- Vepruar në një atmosferë paqësore në mënyrë që programet e bamirësisë dhe të shërbimit ndaj njerëzve të mund të sigurohen për të gjithë, pavarësisht nga feja.

NJË HISTORI E SHKURTËR E DIALOGUT MODERN NDËRFETAR NË PERËNDIM

Është e rëndësishme të kuptohet konteksti historik dhe shfaqja e dialogut modern ndërjetar. Duke u zgjeruar nga ndërveprimi spontan apo i rastësishëm, dialogu tani përfshin diskutimet e

formalizuara me të cilat ne jemi familjarizuar sot. Deri në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë, as të krishterët as muslimanët nuk kishin zhvilluar një kornizë formale për dialog ndërftetar. Edhe pse Kurani 29:46 përmend diskutimet ndërftetare teologjike dhe debate ndër-islame (jadal), ai nuk mishëronte përkufizimin e vërtetë të dialogut. Siç do të tregojmë në kapitullin III, *jadal* në fakt i referohet një debati të projektuar për të bindur tjetrin për të pranuar vetë të vërtetën e dikujt nëpërmjet bisedës logjike dhe teologjike. Përveç kësaj, *jadal* bënte përpjekje për të vënë në dukje tjetrit rrugën apo interpretimet e gabuara (sipas mendimit të tij). Dialogu modern ndërftetar shmang një objektiv të tillë agresiv dhe përqendrohet në zhvillimin e një kuptimi të vërtetë të fesë së vet duke e krahasuar atë me një tjetër.

Dialogu ndërftetar, si një lëvizje bashkëkohore, mund të ndiqet prapa në kohë deri në vendimin e disa kishave për të zgjeruar bashkëpunimin dhe për të ndërtuar marrëdhënie me jo të krishterët. Kjo nismë erdhi nga nevoja e misionarëve të krishterë për t'iu përshtatur kushteve të punës jashtë shtetit. Pasi që lëvizjet për pavarësi kombëtare të botës së tretë u vështirësuan atyre kryerjen e aktiviteteve të tyre tradicionale, ata u përpoqën të mbajnë veten të rëndësishëm duke iu bashkuar rrjedhës qendrore të shoqërisë duke punuar me udhëheqësit e feve të tjera dhe duke treguar se Krishterimi nuk ishte i huaj. Konferenca e parë botërore e misionarëve, e mbajtur në Edinburg në 1910, tentoi të përcaktojë mënyrën se si të krishterët mund të punonin me jo të krishterët pa shkelur besimin e tyre. Kjo ngjarje u pasua nga dy konferenca të mëvonshme ndërkombëtar të misionarëve në Jerusalem (1928) dhe Tambaram, në Indi (1938). Pas gjithë kësaj që është thënë dhe bërë, të krishterët mbetën të përcarë mbi qasjen e tyre ndaj feve të tjera.

Gjendja e punës së misionarëve të krishterë u përkeqësua pas Luftës së Dytë Botërore. Në vitin 1948, kishat e interesuara për të përmbysur këtë situatë të përkeqësuar formuan Këshillin Botëror të Kishave (KBK) në Amsterdam. Si Këshilli Ndërkombëtar Misionar (KNM), ashtu edhe KBK-ja diskutuan për mënyrën se si të krishterët mund të punojnë me jo të krishterët

për të mirën e njerëzimit. KBK-ja mbajti konferenca në Nju Delhi (1961) dhe Kandy, Shri Lanka (1967) për të miratuar një strategji më efektive.⁷ Në të njëjtën kohë, Papa Gjoni XXIII mblodhi Këshillin e Dytë të Vatikanit (1962). I njohur gjerësisht si “Vatikanit II,” këshilli shtyri përpara Kishën Katolike të Romës drejt dialogut ndërjetar.⁸

Një dokument kyç, *Nostra Aetate*, përcaktoi lidhjen e saj me fetë jo të krishtera. Ky depërtim i madh në dialogun ndërjetar shpejt krijoi iniciativa të rëndësishme në favor të ekumenizmit (unitetit të brendshëm të krishterë) dhe të marrëdhënieve ndërjetare. Kisha Katolike e Romës pranoi se Fryma e Shenjtë është aktive në të gjitha kishat e krishtera, madje edhe në qoftë se ata janë protestant apo ortodoks të lindjes. Vatikanit II bëri presion se uniteti i krishterë në terren nuk do të pengonte asnjë besim nga ruajtja e paprekur e traditës së vet. Kështu filloi historia moderne e përfshirjes së krishterë në dialogun ndërjetar.

Një hap i rëndësishëm i marrë nga *Nostra Aetate* ishte zgjerimi i konceptit të shpalljes, të veprimit të Fjalës, të Vërtetës dhe Vullnetit të Zotit ndaj gjithë krijimit:

Etërit e Kishës me të drejtë kanë parë në fetë e ndryshme si të thuasht aq shumë reflektime të një të vërtete, “Farërat e Fjalës,”⁹ që dëshmojnë se, edhe pse rrugët e marra mund të jenë të ndryshme, ekziston vetëm një qëllim i vetëm të cilit i drejtohet aspirata më e thellë e shpirtit njerëzor siç shprehet në kërkimin e saj për Zotin dhe gjithashtu në kërkimin e saj, përmes prirjes së saj drejt Zotit, për dimensionin e plotë të njerëzimit të tij, ose me fjalë të tjera për kuptimin e plotë të jetës njerëzore.¹⁰

Edhe pse ky koncept ishte i njohur në shkrimet e hershme të krishtera, kjo deklaratë publike nxiti shpresën në rritje për dialog me hebrenjtë, me të cilët tani të krishterët thane se ndajnë “trashëgimi shpirtërore.” Për më tepër, kjo inkurajoi dialogun me muslimanët, mbi të cilët Kisha Katolike e Romës “shikon me respekt”, sepse muslimanët adhurojnë një Zot; nderojnë Ibrahimin, Merjemen dhe Jezusin, dhe të gjithë profetët. Ishin përmendur me mirënjohje edhe fetë e tjera botërore si një mënyrë për t’iu afuar të Njëtit, të cilin të krishterët e quajnë “Zot”. Hinduizmi u përshkrua si

një fe “përmes së cilës burrat [dhe gratë] mendojnë për misterin hyjnor”, dhe për Budizmin si fe “që pranon pamjaftueshmërinë radikale të kësaj bote të ndryshueshme”.¹¹ Ky ishte një hap i madh përpara për Kishën Katolike të Romës dhe Krishterimin në përgjithësi.

Bazuar në këtë vizion më të gjerë të shpalljes së Zotit, Nostra Aetate u bëri thirrje katolikëve të hyjnë në diskutime dhe bashkëpunime me jo-katolikë me maturi dhe ndihmë. Ajo u bëri thirrje të krishterëve, ndërsa janë dëshmitarë të besimit dhe mënyrën së tyre të jetës, të pranojnë, ruajnë dhe të inkurajojnë të vërtetat shpirtërore dhe morale që gjenden në mesin e jo të krishterëve në kuadër të jetës së tyre shoqërore dhe kulturës së tyre. Të trimëruar nga këto fjalë bujare, shumë kisha katolike hynë në dialog ndërftetar, veçanërisht me Islamin. Gjithashtu, shumë kisha bënë përpjekje për të krijuar një mjedis harmonie për misionarët e tyre që punojnë jashtë vendit, duke i përshtatur detyrat e tyre me mjedisin në ndryshim dhe duke inkurajuar komunikim më të mirë, më shumë respekt për fetë tjera dhe ndërtimin e paqes. Me fjalë të tjera, ata kërkuan që të punojnë në drejtim të interesave të përbashkëta duke respektuar fenë e tyre.

Muslimanët do të mund të bënin të njëjtën gjë me anë të ri-mësimit të procesit të bashkëbisedimit të ngulitur në historinë islame deri tek Ademi. Dialogu nuk është i huaj për Islamin, sepse Kurani është libër i Dialogut midis Allahut (XH.SH)* (Zotit) dhe krijimit të tij, duke filluar me engjëjt pas krijimit të Ademit dhe pastaj me profetët:

Kur Zoti yt u tha engjëjve: “Unë do të krijoj një mëkëmbës në tokë”. Ata thanë: “A do të vësh atje dikë që do të bëjë çrrëgullime e do të derdhë gjak në të, ndërkohë që Ne të madhërojmë, të lavdërojmë dhe të lartësojmë ashtu si të takon Ty?!” Ai tha: “Unë di atë që ju nuk e dini”. (2:30)

Allahu ia mësoi Ademit emrat e çdo gjëje, pastaj ua paraqiti ato engjëjve dhe u tha: “Më tregoni emrat e tyre, nëse ajo që thoni është e vërtetë!” (2:31)

* (xh.sh) – *Subhanahu ue Teala*: Qoftë i lavdëruar ai dhe qoftë e pranuar Përsosmëria e Tij. Thoshte kur përmendte Zotin.

Ai tha: "O Adem, ua trego atyre emrat e tyre!" Kur ai ua tregoi emrat e tyre, Allahu tha: "A nuk ju kam thënë se Unë i di fshehtësitë e qiellit e të Tokës dhe Unë e di çfarë ju tregoni haptazi dhe çfarë fshihni?!" (2:33)

Kur Ibrahim i tha: "O Zoti im! Tregomë si i ngjall të vdekurit!" - Zoti i tha: "A nuk beson?" - "Besoj" - iu përgjigj Ibrahim, "por dëshiroj të më qetësohet zemra." Allahu i tha: "Merr katër zogj dhe copëtoji. Shpërndaj në çdo kodër nga një copë prej tyre pastaj thirrri! Ata do të të vijnë me të shpejtë. Dhe ta dish se Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Urtë." (2:260)

Edhe pse shumë publikime nga dijetarët muslimanë kanë adresuar statusin e "tjetrit" në Islam, institucionet fetare muslimane do të tregojnë mençuri për të rimarrë këtë formë bashkëbiseduese të komunikimit në mënyrë që ata të mund të analizojnë në mënyrë efektive hendekun e tanishëm që po zgjerohet midis muslimanëve vetë dhe muslimanëve dhe besimeve të tjera në dritën e Sheriatit. Shumë institucione muslimane (d.m.th. Al-Azhar, Organizata e Këshillit Islamik [OKI], këshillat e ndryshme për fetva në Arabinë Saudite dhe kështu me radhë) mund të udhëheqin nisma të tilla dhe të zgjerojnë rrugën për dialog ndërjetar dhe të brendshëm në mes të muslimanëve. Dialogu nuk mund t'iu lihet vetëm dijetarëve.

Kjo nevojë për aftësi në dialog është bërë më urgjente që nga 9/11, sepse muslimanët në Perëndim janë përballur me një provë të tmerrshme. Shumë muslimanë, sidomos arabët, janë arrestuar, janë burgosur, janë marrë në pyetje dhe janë poshtëruar. Në përgjigje të drejtpërdrejtë, grupet e krishtera dhe hebrenje tashmë aktive në dialogun ndërjetar u shtrinë dorën vëllezërve dhe motrave të tyre muslimane. Muslimanët nga e gjithë bota u shprehën ngushëllimet e tyre amerikanëve me fjalë të përzemërta që përkujtonin metodën e Profetit të mësimimit përmes adabit dhe dhembshurisë. Nga ana tjetër, shumë muslimanë ri-konfirmuan besimin e tyre në Islam. Si rezultat i 9/11, shumë muslimanë e kuptuan nevojën për dialog me individët dhe institucionet perëndimore në mënyrë që të shprehin dhe të ndajnë me ta pikëllimin që pasoi duke u ndjerë të sigurt në fenë e tyre.

Para 9/11, disa grupe muslimane në Shtetet e Bashkuara të Amerikës ishin pjesëmarrëse aktive ndërftetare. Komuniteti musliman i Roçesterit, në Nju Jork, ishte një nga këto pak grupe. Duke nxjerrë forcë nga marrëdhëniet e tij të mira me fqinjët e tij të krishterë dhe hebrenjë, ky komunitet musliman i mbrojti me sukses muslimanët e kësaj zone nga diskriminimi.¹² Në fillim, një pjesë e muslimanëve në këtë zonë ishin të dyshimtë. Megjithatë, jo shumë kohë pas 9/11, çdo musliman përshëndeti punën e muslimanëve të Roçester-it në ndërtimin e urave dhe mbrojtjen e komunitetit musliman. Kështu të inkurajuar, imamët nga Nju Jorku perëndimor u takuan për të diskutuar rëndësinë e dialogut ndërftetar. Në të vërtetë, shumë prej tyre pranuan se këto qendra islame dhe xhamitë që kishin qenë anëtarë aktivë të këtij dialogu para 9/11 u shpërblyen më pas me mbështetjen e jomuslimanëve.¹³

Imamët reagues në këtë mënyrë për shkak se, si dijetarë muslimanë, ata janë përgjegjës për udhëzimin e muslimanëve. Ky udhëzues synon të jetë në shërbim të Islamit dhe muslimanëve duke ngritur vlerën e dialogut ndërftetar në Perëndim dhe argumentimin e tij me Kuran dhe Sunnet. Prandaj, ai përqendrohet në ofrimin e burimeve për riedukimin e bazuar në *adab*, etikën e mospajtimit dhe artin e të dëgjuarit. Udhëheqësit e komunitetit që përdorin këtë udhëzues munden gjithashtu të kështillojnë muslimanët për të drejtat dhe detyrat që vijnë me të jetuarit në Perëndim. Ky udhëzues me siguri do të mbështesë dhe do të kontribuojë në zhvillimin e një jurisprudence islame për muslimanët që jetojnë si komunitete pakicë në Perëndim.

PSE NJË PJESE E MUSLIMANËVE E KUNDËRSHTOJNË DIALOGUN NDËRFETAR

Dialogu ndërftetar është një metodë e komunikimi midis njerëzve, një ndërmarrje që respekton dallimet e "tjetrit". Kjo mundëson dëgjimin e vërtetë në një mjedis të sigurt dhe ofron mundësi që të rritet vetë-ndërgjegjësimi i çdo pjesëmarrësi.¹⁴

Por edhe pse ajo është një element kyç i besimit dhe traditës islame, një pjesë e muslimanëve në Perëndim dhe gjetiu vazhdojnë ta kundërshtojnë atë.

Merrni në konsideratë incidentin e mëposhtëm. Një herë një burrë musliman në një xhami u dëgjua duke thirrur se dialogu ndërjetar është *kufër* (mosbesim) dhe se ata muslimanë që morën pjesë në të janë duke vepruar si *kufarë* (mosbesimtarë). Zëri i tij ishte plot me urrejtje dhe mosmiratim. Çdo njeri kaloi pranë tij në heshtje, duke parë se atmosfera nuk ishte e favorshme për bisedë. Por një ditë, imami e pyeti se pse ai e kundërshtonte kaq ashpër këtë aktivitet. Gjatë diskutimit në vijim u zbuluan idetë e gabuara të paraqitura më poshtë:

- Dialogu ndërjetar është pjesë e ekumenizmit dhe ekumenizmi është i krishterë.
- Qëllimi themelor është të krijojë një fe për të gjithë.
- Të thuhet: “Besimi yt është imi dhe nuk ekziston asnjë dallim” është e ndaluar.
- Dialogu ndërjetar angazhohet për krijimin e një adhurimi të ri, të përzier dhe të holluar të shërbimeve të përbashkëta të adhurimit për të gjithë dhe se pjesëmarrësit muslimanë ishin të përfshirë tashmë në këto shërbime adhurimi.

Kundërshtarët përdorin gjithashtu edhe disa vargje Kurano-re për të mbështetur argumentin e tyre. Megjithatë, ata i marrin kuptimet jashtë kontekstit. Pasi që iu mungon një edukim i avancuar dhe i shëndoshë islam, si dhe një kuptim i plotë islam, një pjesë e muslimanëve mund të mbështesin një qëndrim absolutist ndaj tekstit dhe të “tjerëve”. Për dallim, Kurani dhe hadithet mbështesin dialogun në mes të grupeve të ndryshme, si brenda komunitetit musliman ashtu edhe në mes të komuniteteve muslimane dhe jomuslimane. Muslimanët që kundërshtojnë dialogun ndërjetar zakonisht citojnë vargun e mëposhtëm:

Sepse, as hebrenjët, as të krishterët nuk do të jenë kurrë të kënaqur me ty, derisa të pranosh besimin e tyre. Thuaju: “Vetëm udhërrëfimi i Allahut është i drejtë!” E, në qoftë se pas diturisë që të ka zbritur, ti

ndjek dëshirën e atyre, atëherë askush nuk do të të ndihmonte apo mbronte nga dënimi i Allahut. (2:120)

Derisa një pjesë e muslimanëve e kuptojnë që ky ajet dënon çfarëdo dialogu me hebrenjët ose të krishterët, një qasje shken-core, historike zbulon se ai në të vërtetë i referohet polemikës që shpërtheu pasi që Allahu i tha Profetit të ndryshojëkiblen (drejtimin e faljes) nga Jerusalemi drejt Qabesë. Hebrenjët ishin të pakënaqur me këtë vendim. Profeti bëri gjithçka munda për të shpjeguar qëndrimin e tij për këtë zhvillim të ri dhe për të mbajtur raporte të mira me ta. Brenda këtij konteksti Allahu i tha atij që hebrenjët dhe të krishterët e asaj kohe nuk do të ishin të kënaqur me të derisa ai të pasonte mësimin e tyre në lidhje me centralitetin e Jerusalemit. Ajeti nuk kërkonte nga ai që të prishte raportet me hebrenjët dhe të krishterët, por vetëm e informoi atë që kënaqësia e përgjithshme ishte e pamundur.¹⁵

Vini re se një pjesë e muslimanëve japin për këtë ajet një interpretim alternativ, absolutist, duke pretenduar se muslimanët nuk duhet të jenë të kënaqur me jomuslimanët – qofshin ata hebrenjë, të krishterë apo të tjerë - deri sa ata të mos konvertohen në Islam. Sipas kësaj linje të menduarit, po të mësonte një i krishterë në Nju Jork për shembull, Kuranin dhe të fliste mire për Islamin, duke e paraqitur atë në mënyrë të drejtë, kjo nuk do të ishte as këtu apo atje, për një person të tillë muslimanët do të deklaronin kënaqësinë e tyre vetëm nëse ai do të konvertohej; mbase edhe duke zgjedhur të ndalnin të flisnin me të pas një kohe. Një pjesë e muslimanëve përdorin ajete të tjera të Kuranit për të mbështetur dënimin e dialogut ndërftetar. Ata pretendojnë se ajeti në vijim gjithashtu dënon dialogun ndërftetar:

“Allahu është Ai që e ka çuar të Dërguarin e Vet me udhërrëfimin dhe fenë e së Vërtetës, për ta ngritur atë më lart se të gjitha fetë, edhe nëse nuk e pëlqejnë idhujtarët”. (61:9).

Duke analizuar këtë ajet brenda një konteksti më të gjerë islam, ne kuptojmë se, së pari, Islami është mesazhi i së vërtetës dhe që muslimanët duhet të bëjnë më të mirën e tyre për të përhapur atë. Së dyti, ka njerëz që i rezistojnë gjithmonë të vërtetës kur ajo sillet

në komunitetin e tyre. Dhe së treti, Muslimanët duhet të jenë të gatshëm të përballen me pasojat që pasojnë dhe të gjejnë mënyra pozitive për t'u marrë me ta. Siç e dimë, e vërteta nuk mund të përhapet në mes të armiqësisë, por vetëm me sjelljen e duhur dhe me durim. Njeriu duhet të bëjë më të mirën për të krijuar një mjedis paqësor të mirëbesimit. Profeti na dha një model të tillë kur ai nënshkroi Traktatin e hudaybiyyah me kundërshtarët e tij nga Meka, pikërisht me ata që e kishin dëbuar atë dhe familjen e tij nga Meka. Ai mund të shihte se ky traktat do të sillte paqen dhe që duke e nënshkruar atë, muslimanët do të ishin në gjendje të lëvizin lirshëm në një ambient paqësor dhe të përhapin Islamin. Ky ajet kërkoi që muslimanët të ndërtojnë marrëdhënie të mira me të tjerët. Ajetet e tjera të ndjeshme ndaj keqinterpretimit janë:

Ju jeni populli më i mirë i dalë për njerëzimin: (sepse) ju urdhëroni që të bëhen vepra të mira, i ndaloni të këqijat dhe besoni Allahun. Sikur ithtarët e Librit të besonin, do të ishte më mirë për ata; ka prej tyre besimtarë të vërtetë, por shumica e tyre janë larg udhës së drejtë. (3:110)

Feja e vërtetë tek Allahu është vetëm Islami. Ata që u është dhënë Libri, patën mospajttime nga zilia që kishin midis tyre, vetëm pasi u erdhi dituria. Por kushdo që i mohon udhëzimet e Allahut, ta dijë se Allahu është i shpejtë në llogari. (3:19)

Kurani u bën thirrje muslimanëve, si individë ashtu edhe si komunitet, të bëhen komuniteti më i mirë përmes zbatimit dhe praktikimit të Islamit dhe t'u bashkohen përpjekjeve të organizuara dhe të drejtpërdrejta për të përhapur Islamin. Për muslimanët, Islami është feja e vërtetë e Allahut; çfarëdo dyshim për këtë fakt paraqet një shenjë të një *imani* (besimi) të dobët. Prandaj, shumë muslimanë përdorin këtë ajet për të pohuar se dialogu ndërjetar minon mundësinë për t'u bërë 'Ummeti më i mirë'. Por ata dështojnë të kujtojnë se vetë Profeti u angazhua me jomuslimanët me sjelljen e tyre në dialog dhe, në disa raste, në Islam. Merrni parasysh ajetet e mëposhtme:

Ai jua ka shpallur në Libër: Kur të dëgjoni se mohohen fjalët e Allahut dhe bëhet tallje me to, atëherë mos rrini me ata (njerëz që veprojnë kështu), derisa të ndërrojnë bisedë, përndryshe do të ishit si

ata. Allahu do t'i tubojë në Xhehenem të gjithë hipokritët dhe mohuesit. (4:140)

Kjo këshillë përsëritet në Kuran 6:68. Në vend se të marrin pjesë në një shoqëri të tillë apo të ndjekin takime të, muslimanët duhet t'i lënë ato. Por, pjesëmarrja në dialogun ndërftetar është diçka ndryshe, sepse ata që janë të angazhuar në këtë aktivitet të veçantë respektojmë çdo person dhe fenë e tij apo të saj. Është kundër frymës së dialogut ndërftetar të shihet me përçmim ose të jepen mendime për çdo fe tjetër ose pasuesit e tyre. Megjithatë, Kurani shprehimisht shpallë se vetëm Islami do të jetë i pranueshëm te Allahu.

“ Për atë që kërkon një fe tjetër përpos asaj që e ka lënë Zoti, ajo kurrë nuk do të pranohet nga ai, dhe në jetën e ardhshme ai do të jetë në mes të të humurve.” (3:85)

Por ky ajet dhe ajeti tjetër më lartë nuk ndalojnë muslimanët të ndërtojnë marrëdhënie të mira me të tjerët. Në të vërtetë, Allahu I urdhëron ata të ndërtojnë marrëdhënie të mira, siç do të shpjegohet më vonë. Megjithatë, hadithi në vijim citohet shpesh për të dekurajuar zhvillimin e marrëdhënieve me jomuslimanët: “Në Ditën e Gjykimit, çdo njeri do të jetë me ata që i do.”¹⁶

Një herë ka pasur një dialog në mes të hebrenjëve dhe muslimanëve. Ditën e nesërme pas kësaj ngjarje, një musliman i cili e kundërshtoi atë filloi të citonte hadithin e mësipërm duke thënë: “Ata që favorizojnë dialogun me hebrenjtë do të jenë me ta në Ditën e Gjykimit, sepse të bashkëbisedosh me ta është t'i duash ata.” Megjithatë, dialogu ndërftetar nuk ka të bëjë me të duash “tjetrin” në kuptimin e bërjes ‘një’ me atë person; kjo më tepër ka të bëjë me respektimin e pikëpamjeve të tjetrit dhe në këtë mënyrë hapjen e rrugës për një shoqëri paqësore. Por, shumë kundërshtarë e marrin këtë hadith dhe hadithe tjera jashtë kontekstit dhe përdorimit të tyre për të frikësuar pjesëmarrësit muslimanë duke i akuzuar ata se kanë kryer një mëkat. Vetë procesi bashkëbisedues detyron muslimanët të shqyrtojnë dhe të ri-konfirmojnë identitetin e tyre fetar, për të forcuar besi-

min e tyre duke e respektuar atë “të tjetrit” me durim, tolerancë dhe sjellje të mirë. Në të vërtetë, ky hadith i veçantë nuk ka të bëjë fare me dialogun apo ndërtimin e urave; ai në fakt u bën thirrje muslimanëve ta duan Allahun dhe të Dërguarin e Tij, të qëndrojnë të vendosur prapa kauzave muslimane dhe të ruajnë besimin e tyre në formën e tij autentike duke mos e përzier atë me besimet dhe praktikat jo-islame.

Duke i bazuar pikëpamjet mbi keqkuptime të tilla, ka muslimanë që pohojnë se bashkëveprimi i tillë është projektuar në të vërtetë për të zgjeruar ndikimin politik, ushtarak, ekonomik dhe kulturor të Perëndimit; Bëni perëndimorë muslimanët dhe vendet muslimane; bëni muslimanët të humbasin pavarësinë politike, ekonomike, dhe kulturore; zhdukni Islamin dhe mënyrën islame të jetës; dhe konvertoni gjithë njerëzit në Krishterim. Ne i pranojmë këto frika; megjithatë, shoqëritë progresive post kolonialiste kanë zhvilluar aftësinë për të adresuar shqetësimet dhe çështje të tilla në mënyrë të hapur, me barazi dhe respekt. Frika nga dialogu ndërjetar në fakt zbulon një mungesë të besimit, vetëbesimit dhe qëndrueshmërisë shpirtërore. Këto mangësi çojnë në humbjen e mundësisë për t’ua prezantuar Islamin jomuslimanëve.

Megjithatë, një rezultat edhe më pozitiv i dialogut ndërjetar është i mundur se sa vetëm prezantimi i Islamit tek jomuslimanët; bashkëveprimi me Perëndimin dhe shoqëritë e tij pluraliste përmes dialogut mund të zgjerojë njohuritë dhe të kuptuarit e Islamit nga jomuslimanët. Frika mund të zëvendësohet me besim tek muslimanët dhe të përdoret për të krijuar një të kuptuar pozitiv për Islamin përmes rrjetëzimit dhe përfshirjes me të tjerët në projekte të përbashkëta. Muslimanët që angazhohen në një ndërveprim të tillë kanë një mundësi të artë, mundësinë për të përfaqësuar Islamin si fe të vërtetë dhe paqësore të përshkruar në Kuran. Shumë njerëz të cilët nuk kanë takuar muslimanët ose që nuk kanë pasur asnjë kontakt personal me Islamin do të mirëprisnin një mundësi të tillë. Duke e bërë këtë të mundshme në mënyrë të sqartë, në vend se të mbeten prapa dyerve të mbyllura në frikë, muslimanët bëjnë që partnerët e tyre në

dialog të ndihen rehat me ta dhe madje mund të bëjnë që të tjerët të kërkojnë një ndërveprim të ngjashëm.

Përvoja ndërftetare e Roçesterit tregon qartë se pjesëmarrja e muslimanëve mund të sjellë shumë të mira për të gjithë pjesëmarrësit. Ky bashkëveprim ka sjellë respekt për komunitetin musliman dhe ka përmirësuar imazhin e tij. Si rezultat, muslimanët e qytetit zënë një pozitë më të fuqishme në komunitet se që do të kishin në qoftë se do të kishin mbajtur me frikë në vetvetë. Ata respektohen në vendin e punës dhe janë të besueshëm si qenie njerëzore morale. Pjesëmarrja e muslimanëve në dialogun ndërftetar të qytetit ka shënuar më shumë pike pozitive në jetën publike dhe private të banorëve të qytetit. Madje edhe ata muslimanë që jetojnë në Roçester që e kundërshtojnë dialogun ndërftetar kanë pranuar këtë trend pozitiv.

Shqetësimet e kundërshtarëve do të analizohen në detaje më vonë, ashtu si edhe ajetet Kuranore dhe hadithet e cituara më sipër. Është për të ardhur keq që muslimanët janë të ndarë lidhur me këtë çështje. Ndarjet e tilla kanë bërë që një pjesë e muslimanëve t'iu shmangen xhamive që marrin pjesë në dialog ndërftetar. Megjithatë, në vend se të reagojnë ndaj frikës së bazuar në idetë e gabuara, ata duhet me besim të mbështeten në besimin e tyre islam. Ndërtimi i një besimi të tillë është ajo që është ky udhëzues mbi të gjitha. Megjithatë, mbështetja duhet të rritet me njohuri të sakta teologjike dhe historike. Jo vetëm që duhet të kuptohet baza teologjike për dialog në Islam, por natyra dhe rëndësia e shkëmbimeve ndërftetare si në historinë islame ashtu edhe perëndimore duhet të vihen në kontekst.

Duke e marrë parasysh historinë perëndimore së pari, mund të shtrohen shumë pyetje të rëndësishme. Si dhe pse ka filluar ekumenizmi (dialogu ndër-krishterë) në Evropë? Si dhe pse është zhvilluar në vitet e fundit? Muslimanët duhet të shqyrtojnë këto zhvillime dhe të mësojnë se si lidhen ato me dialogun ndër-islamik. Përmes këtij studimi, ata mund të komunikojnë dhe të ndërveprojnë me jomuslimanët.

PËRKUFIZIMI I EKUMENIZMIT DHE ANALIZIMI I RËNDËSISË SË TIJ HISTORIKE

Muslimanët që kundërshtojnë dialogun ndërfaqet shpesh thonë se ekumenizmi është i ndaluar. Por ç'është ekumenizmi? Ekumenizmi fillimisht rrjedh nga fjala greke oikos (shtëpi, amvisëri)¹⁷ Ai nënkupton konceptin e unitetit, të bashkimit si një familje. Përveç kësaj, ekumenizmi mund të përdoret në formën e tij origjinale, duke iu referuar një fenomeni ndërfaqet që trajton dhe lidhë ndarjet e brendshme brenda çdo grupi fetar, etnik, ose tjetër; ai nuk është i lidhur vetëm me kontekstet e krishtera. Siç do të shohim, ky term fillimisht laik është aplikuar më vonë në lëvizjen e krishterë me qëllim të bashkimit të besimeve të ndryshme protestante.

Një grup i Muslimanëve në Roçester diskutuan për ekumenizmin dhe lexuan për të në kontekstin e tij të krishterë, siç paraqitet në veprën e Michael Molloy *Përjetimi i religjioneve botërore*.¹⁸ Por, pa e lexuar kapitullin e plotë, ata që e kundërshtuan ekumenizmin thanë: “Ja. Ne ju kemi thënë që ekumenizmi është i krishterë.” Njerëz të tjerë ndërhyjnë: “Ta lexojmë në tërësi dhe pastaj të fillojmë diskutimin për ekumenizmin me mendje të hapur “Paragrafi i mëposhtëm përmbledh diskutimin e Molloy për ekumenizmin:

Pas Reformimit dhe Rilindjes,¹⁹ bota e krishterë ishte ndarë në mënyrë të hidhur. Besimet e ndryshme që iu referuan njëri-tjetrit si të pafe (kafirs). Vatikani nuk i pranoi kishat protestante si “rebele” dhe si të pa fe. Kishat protestante hodhën të njëjtat akuza ndaj katolikëve. Përveç kësaj, besimet protestante ishin po aq armiqësorë ndaj njëra-tjetrës. Marrëdhëniet e brendshme-krishtere ishin në pikën e tyre më të ulët në histori. Pastaj me kalimin e kohës, besimet e rrymës kryesore protestante vendosën të bëjnë dialog me njëri-tjetrin për të gjetur gjuhën e përbashkët për të lehtësuar tensionin dhe për të ndërtuar marrëdhënie në mes tyre. Kjo lëvizje u bë e njohur si Lëvizja e Krishterë Ekumenike (uniteti familjar).

Kjo lëvizje, e cila sheh të gjitha grupet e krishtera të rrymës qendrore si pjesë të një “familjeje” të vetme, inkurajon dialogun për

mirëkuptim dhe ndërtim të marrëdhënieve. Organizata më e njohur ekumenike e krishterë është WCC, e cila doli nga Kisha e Anglisë. Edhe pse kishat ortodokse lindore dhe kishat katolike romake nuk ishin partnerë në organizim në fillim, ekumenizmi, duke e bashkuar si një bashkësi familjare gjatë një kohe të vështirë, dëshmoi të jetë një prej dhuratave të Zotit për Krishterimin: ai i ndihmoi ata të kuptojnë, respektojnë dhe të ndërtojnë marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Duke i njohur të mirat e këtij dialogu, sot pothuajse të gjitha kishat e rrymës qendrore, duke përfshirë ato ortodokse dhe katolike romake, marrin pjesë në WCC deri në një shkallë.

Pas leximit të librit të Molloy, ata muslimanë që ishin në favor të dialogut të brendshëm dhe ndërftetar filluan diskutimin e tyre duke thënë: “Shikoni botën tonë muslimane; sa shumë është e ndarë nga përçarjet fetare. Marrëdhëniet midis shkollave të ndryshme të mendimit musliman dhe veçanërisht ndërmjet sunive dhe shiave janë në një fazë shumë të mjerë. A nuk mund të mësojmë diçka nga ekumenizmi i krishterë për të mirën e umetit islam? Pse nuk mund të rifillojmë dialogun ndër-musliman për të ndërtuar respekt dhe për të rivendosur unitetit musliman? Kurani dhe Suneti i mësojnë Muslimanët si të jetojnë së bashku me tolerancë plot respekt si vëllezër e motra – por shikoni se sa shumëjemi të ndarë sot.”

Me fjalë të tjera, muslimanët të cilët favorizuan dialogun e brendshëm dhe ndërftetar kuptuan menjëherë se ekumenizmi në të vërtetë ka një kuptim më të gjerë përtej kuptimit të tij më të kufizuar të krishterë, prej të cilit mund të përfitojnë muslimanët dhe grupe të tjera të mëdha që përjetojnë ndarje të dhimbshme. Ky kuptim erdhi me dhimbje dhe shumë më ngadalë për kundërshtarët e tij të parë. Është e rëndësishme të kujtojmë se shumë kundërshtarë janë në të vërtetë muslimanë të sinqertë. Rezistenca e tyre nuk vjen nga mungesa e inteligjencës, por nga efekti i dëmshëm që frika mund të ketë ndaj çdokujt.

Për shembull, ndërsa po diskutohej nevoja e madhe për dialog ndërftetar musliman, disa kundërshtarë në të vërtetë kanë qarë dhe madje edhe zemrat më të forta ishin zbutur. Megjithatë, keqkuptimet vazhduan. Me lot në sy, një kundërshtar tha: “Por

ne jemi kundër pjesëmarrjes së muslimanëve në dialogun ekumenik. “Ai u përgjigj:” Por ne Muslimanët nuk po marrin pjesë në dialogun ekumenik me të krishterët dhe brenda kuptimit të krishterë të termit. Ne po marrin pjesë me të krishterët dhe të tjerët në dialog ndërjetar. “Ende i hutuar, ai pyeti: “Por, a nuk është kjo e njëjta gjë?” Atij iu tha se nuk ishte, nëse njeriu mban në mend se ekumenizmi zakonisht merret me dialogun e brendshëm të krishterë, ndërsa dialogu ndërjetar zakonisht përdoret për një bashkëbisedim në mes të religjioneve. Diskutimi u ndal në atë pikë, kur të gjithë ranë dakord të takohen përsëri për të diskutuar çështjen e dialogut ndërjetar. (Duhet theksuar se ndërjetar është përdorur sot shpesh në vend të termit të saktë ndërreligjioz, kështu duke shtuar huti në hutinë dhe keqkuptimin tashmë ekzistues).²⁰

A ËSHTË DUKE KRIJUAR NJË RELIGJION DIA- LOGU NDËRFETAR?

Muslimanët kanë frikë të tjera, e njëra prej tyre është se pjesëmarrësit jomuslimanë në të vërtetë janë misionarë në kërkim të informacionit shtesë dhe të një njohurie më të thellë për të përmirësuar përpjekjet e tyre të unguillëzimit dhe për të konvertuar muslimanët. Ndërsa ky motiv mund të karakterizojë disa misionarë, ai mund të ju hakmerret. Për shembull, një misionar i cili kishte fituar një njohuri të thellë të Islamit para se të ecte përpara për të konvertuar muslimanët, shpejt zbuloi se ai ishte ai i cili u konvertua – në Islam!

Ekziston edhe një tjetër frikë se një fe e re, e dobësuar “e Ibrahimit” do të lind nga këto përpjekje, diçka e ngjashme me Akbar Dini-Ilahi (Besimi hyjnor). Akbari (1542-1605), perandori i tretë Mughal i Indisë,²¹ është përpjekur të krijojë unitet dhe të arrijë deri tek fetet e shumta duke krijuar një fe të re - Dini-Ilahi - përmes kombinimit të Islamit, Brahmanizmit, Krishterimit dhe Zoroastrianizmit. Edhe pse ai kishte marrëdhënie të forta

me dijetarët e të gjitha besimeve, kjo fe e re nuk arriti të zinte vend në popull. Një pjesë e muslimanëve, veçanërisht ata nga Azia Jugore, kundërshtojnë sinqerisht dialogun ndërftetar për shkak të kësaj ngjarje. Ata mbështesin ndërtimin e marrëdhënieve të mira dhe miqësore me jomuslimanët, por jo përfshirjen personale në çfarëdo dialogu ndërftetar.

Kur Muslimanët tubohen për të folur për dialogun ndërftetar, ata shpesh e gjejnë veten të mbyllur në polemika. Në një takim të komunitetit musliman të mbajtur në një xhami në Nju Jork për të vlerësuar Programet ndër-muslimane dhe ndërftetare të bashkësisë muslimane, një njeri pohonte se programi ndërftetar iu dha të krishterëve një mundësi për të mësuar rreth Islamit dhe për të përdorur atë njohuri për të konvertuar muslimanët. Disa thanë se programet e tilla duhet të mbahen vetëm në kisha. Por shumë të tjerë thanë se ishte e rëndësishme që të ketë takime të tilla në një vend musliman me qëllim të edukimit të jomuslimanëve për Islam-in ose të paktën për të larguar keqkuptimet e tyre.

Polemika mori një formë të veçantë kur një shkollë e misionarëve të krishterë në Nju Jork dërgoi studentët e saj për të vizituar ligjëratën islame të mbajtur në xhami. Disa kundërshtarë shumë të zëshëm argumentuan se këta studentë po vinin për të përmirësuar aftësitë e tyre misionare. Megjithatë, të tjerët besonin se ata po vinin për të marrë informacion të saktë për Islam-in. Askush nuk e di, ata justifikuan, zemra e kujt do të ndryshohet.

Ndarja e mendimit ndahet si vijon: Mbështetësit e dialogut ndërftetar thonë se Kurani e urdhëron atë; kundërshtarët e quajnë atë një akt *kufër* (mosbesimi). Dhe opozita mund të jetë frikësuese. Një here kur u njoftua një program ndërftetar në një xhami në Çikago, disa njerëz bërtitën: "*Kufër, kufër!*" Reagimet e tilla mbajnë të heshtur shumë imamë dhe jo të gatshëm të marrin pjesë në këto bashkëbisedime. Raste të tilla krijojnë një çekuilibrë në tubime bashkëbiseduese. Duke mos qenë të pranishëm imamët e tyre, muslimanët laikë janë lënë në dialog me rabinët me arsim të lartë, ministrat dhe priftërinjtë. Pa pjesëmarrjen e imamëve, dialogu që rezulton nuk mund të sigurojë besim nga asnjëra anë. Liderët e tjerë fetar në të vërtetë mi-

rëpresim pjesëmarrjen e imamëve. Në fakt, në ato qytete ku imamët janë pjesë e dialogut, puna ndërfaqetare është më efektive dhe e respektuar.

Një arsye përfundimtare që përdoret për të kundërshtuar dialogun ndërfaqetar është se ai gjoja inkurajon njollosjen ose përzierjen e praktikave të adhurimit. Por kjo frikë mund të trajtohet lehtë duke u shprehur në mënyrë të qartë që në fillim se pjesëmarrësit janë aty për të vëzhguar, jo për të marrë pjesë në aktet e adhurimit të tjerëve. Ashtu siç janë të mirëpritur të gjithë për të parë muslimanët duke u falur, muslimanët duhet të jenë të mirëpritur për të vëzhguar (por jo për të marrë pjesë në) lutjet e të krishterëve dhe hebrenjëve. Kur Muslimanët ngritën këtë shqetësim në Roçester, partnerët e tyre në dialog u pajtuan me parimin e lutjeve të veçanta. Si rezultat, imamët ishin në gjendje të marrin pjesë me një ndërgjegje të pastër, duke siguruar që aktivitetet e larmishme të dialogut për ndërtimin e paqes do të jenë më produktive dhe të dobishme për interesat e muslimanëve.

Çështja kryesore këtu është se dialogu ndërfaqetar nuk ka për qëllim të unifikojë fetë. Pjesëmarrësit muslimanë duhet të jenë të vetëdijshëm për këtë. Kur Mekasit e pyetën Profetin që t'i lejonte ata të adhurojnë zotat e tyre për një vit dhe pastaj të adhurojnë Allahun vitin e ardhshëm, Allahu shpalli: "Ju keni fenë tuaj, ndërsa unë kam fenë time". (109: 6) Kurani mbështetë lirinë e fesë dhe të adhurimit fetar.

Nga e gjithë kjo që është thënë, është e qartë se imamët nuk duhet të hezitojnë të marrin pjesë në dialogun ndërfaqetar. Në të kundërtën, pjesëmarrja e tyre do të ndihmojë që kongregacionet (xhematet) e tyre të tejkalojnë frikën e tyre dhe të mendojnë për përparësitë pasuese. Dialogu ndërfaqetar ka të bëjë me lirinë dhe respektin e çdo feje, si dhe ndërtimin e urave për të ulur tensionin dhe urrejtjen midis pasuesve të feve të ndryshme. Fetë janë dhuratë e Zotit për të sjellë paqen, jo urrejtjen, për njerëzimin. Fetë mund të jetojnë së bashku në paqe vetëm nëpërmjet përpjekjeve të organizuara drejt mirëkuptimit, vlerësimit të ndërsjellë, dhe ndërtimit të marrëdhënieve të mira.

SFIDAT: SHFAQJA E UNGJILLËZIMIT RADIKAL

Para takimit me grupet e ndryshme të krishtera në takime ndërftetare, disa pjesëmarrës muslimanë shprehën shqetësimin e tyre se të gjithë të krishterët janë të angazhuar në ungjillëzimin agresiv dhe nuk kanë asnjë respekt për Islamin si fe. Pjesa në vijim përpiket të largojë këtë ide të gabuar duke dhënë më shumë detaje për ato grupe të krishtera ungjillore që kanë shprehur qëndrime antagoniste, si dhe ato grupe dhe besime të krishtera që fuqishëm kundërshtojnë strategjitë e tilla.

Evangelizmi i krishterë është një lëvizje komplekse brenda protestantizmit. Disa elemente brenda saj në të vërtetë janë shumë progresive. Megjithatë, krahu agresiv, fundamentalist i evangelizmit ka përjetuar një rritje të vrullshme që nga vitet 1970. Që nga fillimi i luftës në Irak, është bërë edhe më i fuqishëm dhe ka ndikuar në sektet e tjera të krishtera.²² Evangelizmi ekstrem radikal dhe fundamental, siç është parë në Indonezi, Afrikë dhe tani në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, ka nxitur përçarje në mes vete dhe besimeve të tjera të krishtera, si dhe feve të tjera. Taktikat e saj janë të fshehta. Të vendosur strategjikisht në fshehtësi misionarët kanë në shënjestër besime të tjera të krishtera, si dhe bashkësitë jomuslimane. Të përqeshurit e feve të tjera është një strategji e zakonshme. Fjalët urryese të përdorura dikur në kishat e krishtera kundër njëri-tjetrit, përdoren sot kundër feve të tjera, veçanërisht kundër Islamit. Kjo sjellje manifestohet nga shumë kisha jashtëzakonisht konservatore ungjillore, të cilat nuk tolerojnë madje besimet e tjera të krishtera që janë më pak radikale se ata. Nuk është çudi që këto kisha përgojnë Islamin. Një shembull i tillë i fanatizmit i kohëve të fundit është shenja, e dukshme nga autostrada, e vendosur para një Kise Baptiste të Karolinës së Veriut: “Kurani duhet pastruar.” Sipas Josh Humphries në *Daily Courier* të Rutherfordit, të Karolinës Veriore, më 24 maj 2005:

Ministri jo vetëm që refuzoi të kërkojë falje, por bëri deklaratë duke këmbëngulur për përshtatjen e shfaqjes. “Unë besoj se kjo është një deklaratë që mbështet fjalën e Zotit dhe ajo (Bibla) është mbi të gjithë.”

tha dhe se çdo libër tjetër fetar nga i cili nuk mësohet për Krishtin si shpëtimtarin dhe Zotin ashtu siç mësohet në 66 librat e Biblës është i gabuar”, tha ministri. “Unë e dija se kurdo që të vendosnim ne ta vëmë në pah atë do të ketë njerëz që nuk do të pajtohen me këtë, dhe do të ketë disa që do të pajtohen, kështu që ne vetëm duhet të mbrojmë atë që është e drejtë. Besimi ynë si një i krishterë, ose protestant, ose kishë Baptiste – natyrisht ne nuk kemi një besim pos Biblës – por ne kemi besim Baptist dhe mesazh që thotë se duhet të kapemi pas 66 librave të Biblës së Shenjtë dhe secili libër jashtë kësaj që pretendojnë të njohin rrugën e Zotit ose pretendojnë të jenë fjala e Zotit automatikisht janë të pavlefshme dhe përpiqen të largojnë njerëzit nga rruga e drejtësisë së vërtetë brenda pikëpamjes sonë për atë se si ne e shohim fjalën e Perëndisë”.

Kur ministri ishte pyetur nëse ai e kishte shqyrtuar, para se ta vënte në pah se mund të ketë pasoja negative ose se disa persona do të mund të ndjeheshin të ofenduar, ai tha se ai shpresonte për një rezultat të tillë. “E po, unë e kam menduar këtë gjë dhe unë kam thënë se mund të ketë njerëz që janë ofenduar nga kjo, por mënyra se si unë e shoh këtë, Jezusi u ka thënë ndjekësve të tij se nëse bota ju urren, mos u ndjeni keq për shkak se ata së pari më urren mua”, tha ministri. “ Nëse ne qëndrojmë prapa asaj çfarë është e drejtë dhe pas fjalës së Zotit dhe për Krishterimin bota do të na dënojë ne, dhe kështu menjëherë, kur kam marrë një ankesë thashë: “mirë, dikush është inatosur, dikush është ofenduar, kështu që ne duhet të bëjmë diçka të drejtë”.

Një shenjë e forcës në rritje të Evangjelizmit radikal është përdorimi në rritje i Internetit që nga 9/11. Në katër vitet e kaluara kemi qenë dëshmitarë të një “Lufta e internetit” që përfshinë sekularistët dhe Evangjelistët fundamentalist radikalë kundër Muslimanëve në forumet e organizuara dhe joformale (p.sh. diskutimeve islame në Yahoo). Për shembull, një i vetëquajtur Evangjelist paraqet veten si një person shumë i arsimuar në Islam, Urdu dhe Arabisht. Ai menaxhon një radio rrjet të Krishterë në Azinë Juglindore, dhe vazhdimisht sulmon dhe denigron ndaj Islamit dhe Profetit përderisa përkrahë besimet Evangjelite fundamentaliste. Në mënyrë të ngjashme, disa organizata hebrenje dhe muslimane angazhohen në fanatizëm të ndërsjellë. Megjithatë, në shumë programme të tjera të internetit, zhvillohet dialog dhe ka prova të një komunikimi transformues dhe të respektueshëm.

Në përgjithësi, lëvizja radikale Evangjeliste aktualisht gëzon dukshmëri të gjerë në Shtetet e Bashkuara dhe kudo nëpërmjet mediave të shkruara dhe elektronike, një rrethanë që rritë programin e saj të konvertimit të krishterëve dhe të jo-krishterëve në besimet e saj. Anëtarët e saj kanë investuar resurse të mëdha në media dhe trajnime dhe inkurajimin e folësve karizmatik për të mbështetur programin e saj. Megjithatë, jo të gjithë Evangjelistët janë radikalë. Në fakt, shumë prej tyre janë thellësisht dhe sinqerisht të përfshirë në dialogun ndërftetar. Po rata dhe anëtarët e zakonshëm të feve Ibrahimike duhet të jenë më të guximshëm dhe më të sinqertë në mënyrë që të vetdijësojnë njerëzit për pasojat e rrezikshme të çdo lloj radikalizmi fetar. Kjo përgjegjësi nuk mund të shmanget, për shkak se Dhjata e Vjetër dhe e Re, gjithashtu edhe Kur'an-i, tregojnë se Zoti i tha Ibrahimit që të punojë për paqe me përkushtim dhe sinqeritet. Një gjë e tillë është detyrë e secilit.

Veprimet e guximshme për paqe përfundimisht do të nxjerrin muslimanët nga gjendja e tyre shqetësuese. Për shkak të luftërave në Irak dhe Afganistan, kërcënimeve të vazhdueshme të drejtuara kundër Iranit, dhe sulmeve të viteve 2004 dhe 2005 në Madrid përkatësisht Londër, shumë muslimanë në Perëndim janë duke jetuar në frikë. Ata e dinë se agjencitë e caktuara qëveritare dhe grupet e krishtera ultra-konservative janë armiqësorë ndaj tyre. Sforcimi i punës ndërftetare dhe përfshirja në proceset politike lokale janë dy mënyra efektive për muslimanët që të largojnë frikën e tyre, që të luftojnë kundër paragjytimeve dhe islamofobisë, dhe të jetojnë në paqe me të tjerët.

Historia pas Luftës së Dytë Botërore e hebrenjëve në Perëndim na ofron një model për një ndryshim të tillë të fatit. Këta hebrenj, duke qenë se u kanë rezistuar sprovave të shumta të njëjta si ato që muslimanët janë duke i përjetuar tani, u bënë pjesmarrës aktiv në dialogun gjithëpërfshirës bile para se të përhapet dialogu ndërftetar. Rabinët ishin të përfshirë aktivisht në marrëdhënie ndërftetare, dhe komunitetit hebre dhuroi të holla për të inkurajuar dialogun. Sot, individët hebrenjë dhe fondacionet ofrojnë shumë grante për dialogje ndërftetare, dhe një

rabin apo një anëtar i shquar i komunitetit hebre çdoherë është prezent në çdo takim ndërjetar. Në shumicën e takimeve, një pjesëmarrës hebre do të dalë vullnetarë për të bërë procesverbalin ose të kryejë punë të sekretarisë. Hebrenjtë marrin pjesë në procese politike dhe kanë përfaqësuesit në Shtëpinë e Përfaqësuesve dhe Senat. Ata punojnë shumë me rrjetin dhe grupet e ndryshme që të sjellin ndryshime pozitive që mbrojnë interesat e tyre.²³ Me pak fjalë, ata kanë adaptuar dialogun ndërjetar dhe me sukses janë integruar në rrjedhën e shoqërisë duke fituar respektin dhe pa komprometuar besimet e tyre fetare.

MBËSHTETJA PËR DIALOGUN NDËRFETAR

Mbështetja për dialogun ndërjetar është në rritje në mbarë botën. Arabia Saudite sponsorizoi një konferencë ndërkombëtare ndërjetare në Madrid, Spanjë në korrik të vitit 2008 dhe konferencat ndërjetare në Katar, Kajro, Islamabad, Stamboll, Xhakartë dhe në qytete të tjera muslimane janë duke krijuar mbështetje dhe imazhe pozitive të muslimanëve. Në janar të vitit 2002, është mbajtur Konferenca Ndërjetare e Aleksandrisë dhe përpiloi Deklaratën e Parë të Aleksandrisë. Ky moment historik ka rezultuar nga një konsultim i përbashkët i të paktën tetëmbëdhjetë dijetarëve hebrenj, të krishterë dhe muslimanë dhe i udhëheqësve fetarë nga Toka e Shenjtë. Konferenca u zhvillua në Aleksandri, Egjipt, dhe u bashkë-organizua nga Imami kryesor i Universitetit Al-Azhar. (Teksti i plotë i Deklaratës është dhënë në Shtojcën I).

Një rritje e ngjashme e mbështetjes për dialog ndërjetar është parë në Institucionet amerikane dhe europiane të arsimit të lartë. Disa universitete amerikane dhe të huaja kanë zgjeruar programin e tyre arsimor për të përfshirë studimet islamike në raport me fetë e tjera dhe studime ndërjetare. Shkolla e Universitetit Amerikan e Shërbimit Ndërkombëtar, Qendra e Universitetit Xhorxhtaun për Mirëkuptim musliman-të krishterë, dhe Universiteti i Institutit Kroc i Notre Dame, për të përmendur

disa, janë lider të ndërtimit të paqes, të drejtësisë, dhe dialogut në kuadër të kontekstit ndërftetar. Udhëheqës të tjerë janë Qendra Macdonald për Studimin e Islamit dhe të marrëdhënieve në mes të krishterëve dhe muslimanëve e Shkollës së Hartford dhe, së fundi, Kolegji Nazareth i Roçesterit, i cili krijoi Qendrën për Studime Ndërfetare dhe Dialog (QSND). Kolegji Nazareth, QSND-ja organizuan një konferencë kombëtare të mirëkuptimit ndërftetar më 11-13 prill, 2010. Konferenca dha një imazh pozitiv të muslimanëve së bashku me rezultatet e tjera. Mbështetja e Kolegjit nga komuniteti i biznesit të Roçesterit të udhëhequr nga Brian dhe Jean Hickey dhe Instituti Ndërkombëtar i Mendimit Islam (INMI) në Herndon, Virginia e ka bërë QSND-në një qendër të pranuar në shkallë kombëtare dhe qendër të dialogut ndërftetar të respektuar ndërkombëtarisht. Qëllimet e deklaruarra të qendrës janë që të zhvillojnë aftësitë që do të sqarojnë dhe përmirësojnë komunikimet individuale dhe të komunitetit të gjerë mbi çështjet e fesë, besimit dhe natyrës shpirtërore; të kuptojnë besimet individuale dhe shoqërore; të krijojnë një metodologji të përshtatshme për arritjen e qëllimeve të tilla; dhe të zhvillojnë kapacitetin për të jetuarit në një botë pluraliste. QSND-ja përpiqet të zhvillojë mjetet kërkimore, njohuri dhe aftësi nga të cilat do të përfitojnë të gjithë; parashikon një mjedis të favorshëm për të kuptuar fe të ndryshme; dhe kërkon të komunikojë aftësitë e nevojshme që njerëzit të jetojnë me njëri-tjetrin në paqe dhe drejtësi.

Në përgjigje të këtyre zhvillimeve pozitive në arsimin e lartë, komuniteti musliman, relativisht i ri por në rritje në Perëndim, duhet të jetë i gatshëm për t'u përballur me sfidat dhe provat specifike për të siguruar një vend të sigurt për vete. Katër praktika janë thelbësore për mbijetesën e kësaj pakice fetare: të qëndrojnë të bashkuar duke ndërtuar marrëdhënie të mira me fetë e tjera, duke qenë pro-aktiv në trajtimin e sfidave, të marrin pjesë në procesin politik dhe nxitjen e programeve të zhvilluara arsimore në studimet islame në kontekstin e një shoqërie pluraliste (si brenda shoqërisë qytetare ashtu edhe të institucioneve të arsimit të lartë).

DISA PIKA KRYESORE TË KËTIJ KAPITULLI

- Dialogu ndërfaqet përfshin ndërtim të urave në mes të grupeve të ndryshme fetare për të promovuar respektin, tolerancën, dhe jetesën paqësore.
- Dialogu ndërfaqet nuk është ekumenizëm; më tepër, ai është një dialog midis feve të ndryshme.
- Ekumenizmi mëson muslimanët të forcojnë dialogun ndër-musliman në mënyrë që të merren me dallimet ndër-muslimane me respekt.
- Dialogu ndërfaqet nuk është projektuar për të krijuar një fe qytetare, por për të krijuar një atmosferë të respektit për çdo fe.
- Dialogu ndërfaqet është thelbësor për të parandaluar përhapjen e radikalizmit fetar.
- Dialogu ndërfaqet mbron të drejtat e pakicave fetare.
- Pjesëmarrja e imamëve është thelbësore për drejtimin e duhur, edukimin dhe parandalimin e keqkuptimeve.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. A jeni në dijeni për ndonjë dialog ndër-musliman? Nëse po, tregoni ku është duke u zhvilluar dialogu dhe shpjegoni ndikimin e tij në marrëdhëniet midis grupeve të ndryshme të përfshira muslimane.
2. A e dini ndonjë ajet Kuranor apo hadith, përveç atyre të diskutuar më lartë, të përdorur nga ata që e kundërshtojnë dialogun ndërfaqet? Nëse është kështu, shpjegoni se si është keqinterpretuar ai.
3. Përpjekjet e Akbarit për të themeluar një fe të unifikuar qytetare janë të mirënjohura edhe në Azinë Jugore. A e dini ndonjë udhëheqës tjetër musliman apo mendimtar i cili ka tentuar një ndërmarrje të tillë?
4. A do të bashkoheshit me një grup dialogu ndërfaqet nëse ju kërkohet? Pse po, ose pse jo?

KAPITULLI II

UDHËZIMET PËR DIALOG TË BRENDSHËM DHE NDËRFETAR

DALLIMET në mes të njerëzve të feve të njëjta ose të ndryshme janë të natyrshme. E megjithatë ato dallime janë mohuar shpesh. Për shembull, nga një imam në Nju Jork u kërkua të krijojë një këshill të imamëve në qytetin e tij për të adresuar dallimet e muslimanëve për çështje që kishin ndikim në komunitetet e tyre. Ai refuzoi ta bëjë këtë me arsyetimin se “kjo nuk është e nevojshme.” Si rezultat, dallimet vazhduan të ndajnë komunitetin musliman. Edhe kur dallimet ndër-muslimane janë të njohura, ekziston një ngurrim për t’i adresuar ato. Një herë kur ai po prezantonte një letër për dialog ndër-fetar në një konferencë arsimore të SHIAV në Çikago në vitin 2006, Muhammed Shafiq u pyet për dialogun e brendshëm fetar. Ai tha se dialogu i brendshëm fetar ishte edhe më i vështirë se dialogu ndër-fetar.

Këto dëshmi anekdotike sugjerojnë se udhëheqësit muslimanë e konsiderojnë dialogun e brendshëm fetar më të vështirë se dialogun ndër-fetar. Në përgjithësi, shumica e imamëve dhe udhëheqësve muslimanë nuk kanë qenë të trajnuar për rregullat dhe etikën e mirësjelljes të dialogut ndër-fetar, ndërsa shumë udhëheqës të besimeve të tjera kanë pasur një angazhim të vjetër me këtë lloj të dialogut dhe kështu janë shumë më të hapur për të dëgjuar dhe për të mësuar. Vetëbesimi i tyre është rritur përmes praktikimit të teknikave të dialogut të tyre në bisedat e tyre të brendshme dhe të jashtme.

Zhvillimi i aftësive themelore të nevojshme për dialog të suksesshëm dhe komunikim mund të ketë ndikime pozitive në bashkësitë muslimane, veçanërisht në Perëndim. Mungesa e aftësive të tilla është një arsye e rëndësishme për paqëndrueshmërinë dhe menaxhimin e dobët të shumë xhamive. Shumë udhëheqës të xhamivemund të jenë punëtorë të mirë, por ata kanë pak përvojë në menaxhim, dialog dhe zgjidhje të konflikteve. Shumë udhëheqës ende besojnë dhe praktikojnë strategjinë e 'heshtjes nga autoriteti'. Si rezultat, shumë xhami dhe institucione të tjera muslimane të kontrolluara nga një entitet i vetëm perceptohen si më të qëndrueshme sesa ato të drejtuara nga komuniteti.¹

Megjithatë, kur jetohet brenda kontekstit shoqëror perëndimor, dialogu ndërftetar bëhet një domosdoshmëri, dhe dialogu ndër-musliman bëhet edhe më i domosdoshëm për të ndërtuar një mirëkuptim më të mirë në mes të muslimanëve. Dialogu i brendshëm fetar mund të jetë një mjet efektiv për ndërtimin e solidaritetit dhe unitetit musliman, veçanërisht në çështjet që kërkojnë sakrificimin e kohës dhe burimeve të dikujt. Një komunitet i dobët nuk mund të shpërndajë, dhe kështu qëndron në fundin pranues. Siç ka thënë Profeti, dora që jep është gjithmonë më e mirë se ajo që pranon.² Edhe pse një komunitet mund të jetë i vogël, organizimi më i mirë do të bëjë që përpjekjet e tij në terren të jenë më efektive. Një komunitet i mirë-organizuar musliman gjithmonë do të fitojë më shumë respekt dhe do të ketë një ndikim më të madh mbi dialogun ndërftetar sesa një i çorganizuar.

Nuk duhet të ketë asnjë argument në lidhje me vlerën e dialogut të tillë dhe praktikave të nevojshme për të forcuar atë. Në fund të fundit, Kurani përkrah respektimin e diversitetit të mendimeve midis anëtarëve të komunitetit të njëjtë dhe në mes të njerëzve që pasojnë fe të ndryshme. Liria fetare, përsa i përket praktikave dhe besimeve, është e garantuar në Islam. Kurani kërkon që njerëzit të respektojnë besimet e njëri-tjetrit dhe të jetojnë në paqe. Para Islamit, hebrenjtë dhe të krishterët kanë jetuar në armiqësi në Arabi dhe në Perandorinë Romake. Ata mezi toleronin njëri-tjetrin dhe persekutimi në emër të fesë vazhdoi. Kur Allahu zgjodhi Muhammedin që ai të jetë Profeti i Tij në vitin 610 dhe filloi t'i shpallë Ku-

ranin atij, u përvijuan udhëzimet për bashkëjetesë paqësore dhe dialog. Çdo dialog, qoftë midis individëve, komuniteteve apo feve, duhet të zbulojë rrugën e bukur të Profetit dhe etikën e mospajtimit siç është paraqitur në Kuran dhe Sunet. Këto modele paraqesin themelin dhe thelbin e dialogut, nga të cilat mund të rrjedh një udhëzim që vlen sot.

PARIMET UDHËZUESE:³

Parimet e mëposhtme janë pjesë e një teknike të trajnimit për të nxitur ndërgjegjësim dhe për të krijuar një mënyrë të tëmënduarit në komunitet për mënyrën se si të sillen, të ndërtojnë marrëdhënie, dhe të diskutojnë çështjet e bashkësisë dhe dallimet në një atmosferë të përzemërt. Parimet e mëposhtme do të ndihmonin në nxitjen e mirëkuptimit paqësor dhe të jetesës së përbashkët:

Kontrolli mbi nefsin (dëshirat, epshin): Kontrollimi i *nefsit* është nevoja më e rëndësishme në dialogun e brendshëm dhe atë ndërjetar. *Nefsi* nxit një njeri të përpiqet për interes personal dhe prestigj, rehati dhe para, dhe pozitë më të lartë në dëm të parimeve islame. Pasimi i urdhrave të *nefsit* është *haua* (dëshira, epsh). Kurani ka dënuar me fjalë të fuqishme pasimin e *haua* (2:120). Duke pasuar *haua*, një individ është duke e pasuar Shejtani dhe Shejtani është armiku më i madh njerëzve (Kurani, 17:53; 7:22; 12:05). Është vepër e Shejtanit t'ia paraqes njeriut gjërat në mënyrë joshëse dhe të bukur.

Bujaria e madhe dhe vetëpërmbytja: Profeti ishte *ausa'al-na-s/adran* (njeriu më bujar në mesin e njerëzve). Kur udhëhiqet një komunitet musliman apo kur predikohen fjalët e Zotit, është e zakonshme të dëgjohet abuzim verbal, fjalë të ashpra dhe akuza të rreme, dhe madje edhe të jesh i persektuar. Durimi është jashtëzakonisht i rëndësishëm në raste të tilla. Profeti ynë ka qëndruar i qetë, i sjellshëm dhe me dinjitet në raste të tilla. Muham-

medi kurrë nuk ka treguar ndonjë pakënaqësi apo zemërim, por ai i duroi të gjitha vështirësitë me durim dhe këmbëngulje.

Universal në karakter: Një udhëheqës ndër-musliman dhe ndërftetar duhet të përmbahen nga tendencat sektare dhe nacionaliste. Tribalizmi dhe nacionalizmi janë armiq të Islamit dhe të muslimanëve. Profeti Muhammed qëndronte mbi organizim fisnor dhe etno-centrizëm, dhe kjo solli sukses të madh në misionin e tij të Islamit. Islami nuk e mohon realitetin se njerëzit kanë lindur në familjet e tyre, janë të ndarë në fise dhe kombe. Islami kurrë nuk u përpoq të eliminonte fiset dhe kombet. Prania e turqve, persianëve, indianëve, malajas dhe shumë fise afrikane jashtë arabëve janë dëshmi e qëndrimit pranues të Islamit ndaj tyre. Kultura dhe gjuha e tyre ishin të mbrojtura. Dokumentet e tyre historike ishin të ruajtura dhe hulumtimi i cultures së tyre ishte i inkurajuar në kuptim të plotë të fjalës.

Ngritja e zërit: Kurani ndalon ngritjen e zërit në takime dhe dialog. Ebu Bekri dhe Umeri një here ngritën zërin e tyre në një takim në praninë e Profetit, Kurani i këshilloi ata dhe të tjerët:

O ju që keni besuar! Mos e ngrini zërin tuaj mbi zërin e Profetit dhe mos i flisni atij me zë të lartë, siç bëni me njëri-tjetrin, në mënyrë që të mos ju humbin veprat tuaja pa e ndier ju fare. Vërtet, ata që ulin zërin në prani të të Dërguarit të Allahut janë njerëzit, zemrat e të cilëve Allahu i ka kalitur për besim e përkushtim. Për ata ka falje dhe shpërblim të madh. (49:2-3)

Të flisni me butësi: Kur Allahu i kërkoi Musait dhe Harunit ta thërrasin Faraonin në Islam, ai u tha atyre të përdorin një formë të butë dhe gjentile të të folurit: “Por, i flisni atij fjalë të buta, se ndoshta kujtohet a frikësohet!” (20:44)

Të jeni të sjellshëm dhe të butë dhe të shmangni vrazhdësinë:
⁴ Profeti Muhammed ishte i njohur për edukatën e tij: “Dhe ti ke virtyre të larta të karakterit” (68:4). Allahu lavdëroi edukatën dhe butësinë e tij: “Dhe në sajë të mëshirës së Allahut, u solle

butësisht me ta (o Profet). Sikur të ishe i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu do ata që mbështeten tek Ai.” (3:159)

Të mposhtni zemërimin dhe të jeni falës: Përdorimi i fjalëve fyese gjatë një dialogu shpeshherë rezulton me tension. Kurani i këshillon muslimanët të mos i kushtojnë vëmendje dhe të falin për hir të dobisë së përbashkët njerëzore: “Ata të cilët japin lëmoshë edhe kur janë në mirëqenie, edhe kur janë në vështirësi, e mposhtin zemërimin dhe ua falin fajet njerëzve. Allahu i do bamirësit.” (3:134)

Mos i shani të tjerët apo fetë e tyre: Kuranithotë: “Por mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t’i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë. (6:108) Flisni vetëpërfenë tuaj, duke iu shmangur në këtë kritikës së drejtpërdrejtë të njerëzve të tjerë ose feve të tyre: Kjo është thelbësore për të shmangur konfliktin. Dialogu nuk mund të ndodhë nëse pjesëmarrësit fillojnë të kritikojnë njëri-tjetrin, sepse një qasje e tillë gjithmonë bën të shfaqen emocione zemërimi, mbrojtëse dhe shpie në konflikt.

Të keni respekt për Shkrimet e Shenjta: Kurani shfaqë respekt të madh kur flet për Teuratin dhe Inxhilin: “Vërtetë, Ne të kemi zbritur Teuratin, në të cilin janë udhëzimet dhe dritat...” (5:44). Një ajet tjetër thotë: “Dhe Ne dërguam Isain, të birin e Merjemes, si vërtetues të Teuratis që kishte ardhur para tij. Dhe i dhamë atij Ungjillin, në të cilin ka udhëzim dhe dritë, si përmbushje të asaj që ishte shpallur para tij në Teurat dhe si udhërrëfyes e këshillë për ata që i frikësohen Allahut”. (5:46)

Të keni respekt për të gjithë Profetët dhe Themeluesit e besimit: Kurani kërkon prej besimtarëve që të respektojnë të gjithë

profetët. Kur përmendet emri i një Profeti, nga muslimani kërkohet të thotë: “Paqja qoftë mbi të”. Për Musain, Kurani thotë: “O Musa! Unë të kam zgjedhur ty mbi të tjerët me kumtet e Mia dhe të Folurin Tim (pa ndërmjetës, por të drejtpërdrejtë). Merre atë që ta kam dhënë dhe bëhu mirënjohës!”(7:144).

Të keni respekt për vendet e kultit: Kurani mbështet respektin dhe mbrojtjen e vendeve të adhurimit. Kurani thotë: “...Sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm”. (22:40)

Durimi: Durimi është një virtyt i madh, sepse “Allahu është me ata që janë të durueshëm” ndeshet shumë herë në Kuran. Dialogu ndërftetar nuk është i lehtë. Me një larmi të tillë të njerëzve që kanë mendime të ndryshme, njerëzit me siguri do të përballen me pikëpamje që ata nuk i pëlqejnë. Durimi është shumë i dobishëm në raste të tilla.

Trajtimi i barabartë dhe human: Kurani përkrah barazinë e racave dhe është i verbër për ngjyrën, sepse të gjithë njerëzit janë të barabartë në sytë e Zotit. Muslimanët që marrin pjesë në dialog ndërftetar duhet t’i trajtojnë të gjithë njerëzit me respekt dhe dinjitet të barabartë. Me fjalë të tjera, të trajtojë të tjerët ashtu siç do të donit t’iu trajtojnë juve. Profeti tha se një besimtar duhet të dëshirojë për një vëlla/motër tjetër atë që ai/ajo do të dëshironte për veten e tij/saj. Praktikimi i traditës profetike do të rezultonte me një ambient më të mirë.

Buzëqesh dhe qesh butësisht: Profeti buzëqeshte butësisht dhe shmangte qeshjen me zë të lartë.⁵ Gjatë një dialogu, shmang një shprehje të mërzitjes apo indiferencës; në vend të kësaj, rri i buzëqeshur. Profeti ka thënë: “T’i buzëqeshësh vëllait tënd është një vepër bamirësie”,⁶ dhe “Të sjellësh buzëqeshjen në fytyrën e tjetrit është sadaka.”⁷

Të jeni plotësisht të vëmendshëm ndaj personit që është duke folur: Dëgjimi i vëmendshëm, të qenit i vëmendshëm dhe të qenit vigjilent janë vendimtare për dialog të mirë, siç tregon hadithi në vijim: Një njeri erdhi te Profeti dhe filloi t'i flas atij drejtpërdrejtë kur ai po bëhej gati të udhëheq namazin. Profeti e dëgjoi me vëmendje, sikur ai po thoshte diçka shumë të rëndësishme, derisa ky njeri e përfundoi.⁸

Është me rëndësi po ashtu të kuptohen manifestimet kulturore për mënyrën se si njerëzit i kushtojnë vëmendje njëri-tjetrit. Për shembull, muslimanët mësohen të mbajnë shikimin e ulur (Kuran 24:30) kur flasin me pjesëtarët e gjinisë së kundërt, një praktikë që konsiderohet ofenduese në Perëndim. Për shembull, një herë një grua jomuslimane iu ankua një imami që muslimanët asnjëherë nuk e shikonin atë kur ajo fliste me ta. Ajo mendoi se ata ishin racistë, sepse kur njerëzit e tjerë flisnin me ta ata ose kthenin kokën anash ose ulnin shikimin. Ajo falënderoi imamin pasi që ai shpjegoi pse e bëjnë këtë. Në Perëndim, shikimi drejtpërdrejt dhe në mënyrë modeste anëtarët e gjinisë së kundërt është e këshillueshme për krijimin e marrëdhënieve më të mira të punës. Kjo çështje mund të interpretohet nën kategorinë e 'urf (vlerave kulturore), e cila është një element i Sheriatit.

Të jeni vigjilent në publik: Muslimanët që marrin pjesë në dialog ndërjetar, jo vetëm që duhet të duken vigjilent, por të shmangin po ashtu hipokrizinë duke qenë në të vërtetë vigjilent – një praktikë e vështirë por e domosdoshme shpirtërore. Është hipokrizi të shtireni që jeni duke dëgjuar kur, në të vërtetë, mendja juaj është diku gjetkë. Natyrisht, sjellja jashtë është e rëndësishme, por ajo duhet të reflektojë sinqeritet. Për shembull, Profeti nuk i pëlqente gogësima në publik dhe kështu ndrydhte nevojën për të gogësuar dhe kërkonte prej të tjerëve që të veprojnë njëjtë, apo së paku të mbulojnë gojën kur gogësinin dhe të ndrydhnin çfarëdo psherëtime apo zhurmë të tjera të gogësimës.⁹

Të ju jepni mundësinë të tjerëve të flasin : Të dilni në temë, të jeni të shkurtër dhe të kërkoni leje për të folur, sepse kështu ve-

pronte Profeti.¹⁰ Mos i ndërpreni ata që janë duke folur, sepse veprimi i tillë është mungesë respekti dhe shkel rregullat e angazhimit të sjellshëm.

Të jeni të gatshëm të ndihmoni dhe të jeni vullnetar për punë në komunitet: Paraqitja si vullnetar për të ndihmuar ata që janë në nevojë, të varfrit, të sëmurët apo pleqtë dhe njerëzit në përgjithësi janë të gjitha elemente bazë të mësimimit islam. Krijimi i rrjeteve dhe përfshirja në shoqëri civile është në dobi të Islamit dhe mundëson bashkëveprim të mëtejshëm për dialog. “Dhe adhuroni vetëm Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); silluni mirë me prindërit, të afërmit, jetimët, të varfrit, fqinjët e afërt dhe të largët, me atë që keni pranë, me udhëtarin...” (Kuran 4:36). Kjo përfshin çdo lloj pune vullnetare, kontributi me kohë dhe para dhe ndihma e dhënë të gjitha segmenteve të njerëzimit.

Të jeni të përpiktë: Përpikëria është pjesë e Islamit, ngase të gjitha *ibadetet* (aktet e adhurimit) duhet të kryhen në kohë të caktuara: “Pasi të kryeni namazin, përmendeni Allahun duke qëndruar në këmbë, ulur dhe të shtrirë. Kur të jeni jashtë rrezikut, atëherë faleni namazin të plotë, sepse namazi është detyrë e shenjtë për besimtarët në kohë të caktuar të ditës.” (4:103).

Vishuni me rroba të pastra dhe si duhet: Profeti tha se pastërtia dhe dëlirësia janë gjysma e besimit të muslimanit.¹¹ Allahu e urdhëroi Profetin të mbajë rrobat e tij të pastra: “O ti, i mbështjellë (o Muhamed)! Çohu dhe paralajmëro! Zotin tënd madhëroje, petkat e tua pastroji.” (74: 1-4)! Profeti mbante veten të pastër dhe të dëlirë dhe kërkonte prej të tjerëve që të vepnin kështu. Një herë ai tha: “Ata që kanë flokë le të kujdesen për to”.¹² Ai gjithashtu tha se pastërtia është gjysma e besimit.¹³ Në një hadith tjetër, ai i informoi Muslimanët se dhjetë sjelljet në vijim janë akte thelbësore të *fitrah* (natyrës njerëzore): prerja e mustaqeve, rritja e mjekrës, përdorimi i misvakut (furçës së dhëmbëve), pastrimi i hundës me ujë, prerja e thonjëve, larja e

nyjave të duarve dhe këmbëve, heqja e qimeve nën sqetulla dhe pastrimi i pjesëve private me ujë. Sipas transmetuesit, e dhjeta mund të jetë shpëlarja e gojës.¹⁴

Vendimtare për çdo gjë që u tha më lart është të kujtojmë se të tjerët mund të perceptojnë çdo musliman si një përfaqësues të Islamit dhe të mësimave të Profetit. Paraqitja e mirë, një qëndrim pozitiv i vëmendshëm dhe hiri reflektojnë parimet dhe vlerat islame.

Rregullat e duhura të mirësjelljes dhe sjellja e mirë janë themet thelbësore për dialogun ndërfaqet. Leonard Swidler (Universiteti Temple, Departamenti i Fesë) ka shkruar gjerësisht për parimet e dialogut ndërfaqet, të cilën ai e quan “urdhërimet.” Ato janë të përmbledhura më poshtë.¹⁵ Vini re se këto “urdhërimet” nuk janë në kundërshtim me mësimet islame, por përkundrazi përforcojnë thëniet që ndodhen në Kuran dhe Sunnet:

1. Qëllimi i dialogut është për të mësuar dhe për të rritur të kuptuarit e njeriut.
2. Pjesëmarrësit duhet të jenë të angazhuar në dialog në kuadër të çdo komuniteti fetar dhe me komunitetet e tjera fetare. Këto duhet të bëhen në të njëjtën kohë.
3. Pjesëmarrësit duhet të jenë të ndershëm, të sinqertë, dhe të dëshirojnë të mësojnë dhe të rriten së bashku me respekt.
4. Mos i krahasoni idealet tona me praktikën e partnerit tonë, por më tepër idealet tona me idealet e tjetrit dhe praktikën tonë me praktikën e tjetrit.
5. Secili partner dialogu ka të drejtë të përkufizojë fenë dhe besimet e tij ose të saj. Të tjerët vetëm mund të përshkruajnë se si ju duket atyre nga jashtë.
6. Pjesëmarrësit duhet të braktisin të gjitha paragjykimet e tyre në mënyrë që të dëgjojnë të tjerët me sinqeritet dhe çiltërsi.
7. Dialogu mund të zhvillohet vetëm midis të barabartëve. Prandaj, mos u përpiqni të dominoni ose të trajtoni të tjerët si inferior.

8. Dialogu duhet të zhvillohet në një atmosferë të besimit të ndërsjellë.
9. Pjesëmarrësit që hyjnë në dialog duhet të jenë të gatshëm të reflektojnë mbi veten e tyre dhe traditën e tyre fetare.
10. Pjesëmarrësit në dialog duhet të përpqien të përjetojnë se si traditat e të tjerëve ndikojnë në ta në mënyrë të plotë.

Nga një perspektivë islame, Ismail R. al-Faruqi¹⁶ theksoi se dialogu duhet të mbrojtë veten nga degjenerimi në propagandë, larje truri apo aktivitet misionar. Dialogu ndërftetar, dhe veçanërisht dialogu teologjik, duhet t'i përmbahet rregullave të mëposhtme të ketë sukses:

- Nuk ka deklarim fetar që qëndron mbi kritika: Like Sëidler, al-Faruqi theksoi se asnjë person nuk duhet të flas me autoritetin e heshtjes. Shpallja Hyjnore është autoritative, por jo autoritare. Të kuptuarit e shpalljes nga njerëzit duhet të bazohet në argumentin racional dhe të kuptuarit logjik. Ai nuk duhet të jetë i pakuptueshëm, irracional, ezoterikë apo sekret.
- Koherenca e brendshme duhet të ekzistojë: I gjithë ligjërimi duhet të jetë i kuptueshëm, jo paradoksal. Paradoksi është e ligjshëm kur nuk ofrohet si një e vërtetë përfundimtare. Përndryshe, një ligjërim i tillë do të ishte i pakuptueshëm.
- Perspektiva e duhur historike duhet ruajtur: Dialogu duhet të marrë në konsideratë historinë fetare të njeriut dhe kontekstin. Historia e kaluar nuk duhet të shihet si e tepërt, sepse të kuptuarit e saj të vërtetë çon në një dialog të suksesshëm.
- Duhet të ekzistojë përputhja me realitetin: Dialogu do të jetë më mirë në qoftë se ai merr në konsideratë ndjeshmëritë fizike, etike, dhe fetare të pjesëmarrësit si dhe realitetin e tyre. Çdo person duhet të jetë në gjendje të artikulojë realitetin e veçantë të tij ose të saj.
- Liria nga interpretimet absolute të shkrimeve të shenjta: Të gjitha fetë manifestojnë një diversitet të mendimeve

se si t'iu qasen teksteve fetare. Mosmarrëveshjet dhe grindjet pasuese kanë ekzistuar për shekuj me radhë. Një shkallë e konsiderueshme e lirisë është e nevojshme kur adresohen këto interpretime të shumta. Kjo liri mund të sigurojë tolerancën më të madhe të mundshme për shprehjen e çështjeve aktuale kontekstuale.

Dialogu duhet të realizohet në lëmi ku ka mundësi më të madhe të suksesit, siç janë detyrat etike: Pjesëmarrësit mund të theksojnë se mirëkuptimi i ndërsjellë mund të arrihet në lëmin e etikës, moralit, familjes dhe çështjeve të drejtësisë shoqërore në shërbim të njerëzve, pavarësisht nga dallimet teologjike që janë shfaqur në kuadër dhe në mes të Islamit dhe Krishterimit.¹⁷ Richard Landau rendit disa pika të tjera:¹⁸

- Përdorni imagjinatën tonë krijuese dhe Sensibilitetin tonë për njerëz,
- Të gjitha grupet pjesëmarrëse fetare duhet të përfshihen në planifikimin fillestar,
- Dallimet më të vështira nuk duhet të trajtohen së pari; në vend të kësaj, merruni së pari me ato që janë të përbashkëta për të ndërtuar besim dhe respekt të ndërsjellë,
- Kur krahasoni idealet, mësoni të mos jeni fitues, sepse dëshira për të fituar shkatërron qëllimin e dialogut, dhe
- Mbani dialogun si një rrugë me dy drejtime e komunikimit duke mos lënë asnjë individ apo grup të dominojë. Mund të shtojmë se pjesëmarrja në dialog ndërjetar është mënyra më e mirë për të njohur njerëz nga fetë e tjera dhe traditat e tyre. Megjithatë, duke pasur parasysh se dialogu ndërjetar nuk është i lehtë, njeriu duhet të ketë njohuri të madhe rreth feve të tjera para se të angazhohet në këtë aktivitet. Disa norma dhe parime udhëzuese shtesë për dialog duhet të mbahen në mend, siç janë:
- Praktikoni drejtësi: Kur flisni për ose në lidhje me një besim tjetër, flisni në atë mënyrë që njerëzit e atij religjioni të mund ta konfirmojnë si të saktë.

- Shprehni ndjeshmëri: Bëni përpjekje të sinqertë për të vlerësuar tërheqjen e fesë tjetër për ata që i tërheq ajo dhe për të kuptuar kuptimin dhe funksionet e saj për ta dhe se si ajo ka kuptim për ta.
- Shmangni keqpërdorimin e shkrimit të shenjtë: Askush nuk duhet të përpriqet të përdorë fenë e vet për të hedhur poshtë një fe tjetër si të pavlefshme.
- Qëndro i hapur për të ndryshuar dhe për të qenë i sfida: Çdo pjesëmarrës do të jetë i hapur ndaj të gjitha sugjerimeve dhe të jetë i gatshëm për të pranuar një mendim kolektiv që kundërshton besimin e ndonjë pjesëmarrësi.
- Largohu nga denoncimet apo debatet: Dialogu nuk është një debat dhe asnjë dialog nuk mund të ndodhë kur njëra anë kërkon të denoncojë tjetrën.
- Trego reciprocitet: Secila palë duhet të aplikojë të njëjtin standard për veten e saj që vlen për të tjerët.
- Shmangni parakushtet: Insistimi në parakushte zakonisht shkatërron qëllimin e dialogut.
- Të jeni të kujdesshëm për të mos bërë përgjithësime gjithëpërfshirëse: Përgjithësimet e gjera errësojnë dykuptimësitë brenda feve dhe dallimet në mes tyre.
- Përballuni me sferatë mospajtimit me sinqeritet: Të pasurit një lëkurë të trashë dhe mos rënia lehtë në ofendim janë disiplina të rëndësishme në trajtimin e mosmarrëveshjeve.
- Shmangni përdorimin e përzgjedhur të shkrimit të shenjtë, traditës dhe historisë: Një gabim i përbashkët është të nxirren ajete rreth dhunës nga një tekst fetar, pa e marrë parasysh një pamje të plotë.
- Shmangni supozimin e konsensusit: Pjesëmarrësit nuk duhet të supozojmë që çdo çështje mund të arrihet me konsensus. Çdo fe ka përparësitë e veta.
- Theksoni se dituria nuk i përket ndonjë besimtari të caktuar: Çdo fe është e bekuar me shumë pasues të urtë dhe të respektuar; asnjë fe nuk ka monopol në njerëz të tillë.¹⁹

NIVELET E DIALOGUT NDËRFETAR

Kur flasim për dialogun ndërfaqet, ne zakonisht nënkuptojmë dialogun në mes të komuniteteve fetare për të kuptuar fenë e njëri-tjetrit dhe për të ndërtuar ura drejt një shoqërie pluraliste dhe paqësore.

Megjithatë, ka nivele dhe forma të ndryshme të dialogut ndërfaqet. Një sqarimi i termave është thelbësor në fillim: dialogu bilateral është një dialog mes dy feve, ndërsa dialogu shumëpalësh përfshin tre ose më shumë religjione.

Niveli i dialogut ndërfaqet ndryshon në bazë të vendit në të cilin ndodh: në një kampus universitar si aktivitete të ndryshme studentore, brenda një institucioni zyrtar mes dijetarëve apo udhëheqësve fetarë, ose në një shkëmbim kulturor të shumë gjeneratave që përfshin një racion si një formë shoqërore bashkëbiseduese e ndërtimit të paqes ndërfaqetare. Shembuj të niveleve të ndryshme të dialogut janë diskutimi teologjik, shkëmbimi social (piknik ndërfaqet apo ngrënie ushqimi), veprimi social, shkëmbimi arsimor, shkëmbimet e partneritetit, shkëmbimet e kampuseve dhe shkëmbimet kulturore.

Është e rëndësishme të përcaktohet niveli i veçantë i dialogut që ndjek njeriu kur bën përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe të temave. Duke ngritur ndërgjegjësimin dhe sensibilitetin e pjesëmarrësve për llojin e dialogut të parashikuar, duke i përshtatur pritjet e tyre me nivelin e tyre të të kuptuarit, dhe duke sqaruar arsyen për hyrje në dialog, planifikuesit e dialogut mund të shmangin konfuzionin dhe zhgënjimin e panevojshëm dhe të inkurajojnë një rezultat më të suksesshëm.

Kush janë pjesëmarrësit potencialë në ngjarje të tilla? Njeriu duhet të marrë në konsideratë këtë pyetje me kujdes, veçanërisht kur është fjala për diversitetin e grupit. Një inxhinier i cili nuk është dijetar islam mund të ndjehet në siklet në një mjedis zyrtar duke diskutuar teologjinë dhe filozofinë me dijetarë musliman, të krishterë, apo hebrenj, veçanërisht në qoftë se dialogu kalon kualifikimin arsimor dhe përvojën e tij ose të saj. Megjithatë, njeriu nuk mund të jetë i ngurtë kur vjen puna

për kategorizim social. Për shembull, kur vendoset dialogu për pjesëmarrësit burra dhe gra, njeriu nuk duhet të supozojë se vetëm burrat mund të merren me shkëmbime teologjike ose se gratë janë më të mira për partneritet apo aktivizëm shoqëror. Mund të ketë ose të mos ketë ndonjë mbikalesë në mes të dhe ndër anëtarët e ndryshëm, në varësi të nivelit të aktivitetit bashkëbisedues dhe prirjeve të veçanta të pjesëmarrësve.

Grupi i pjesëmarrësve mund të jetë i madh: burrat vetëm, gratë vetëm, burrat edhe grate bashkë, si dhe kombinime të ndryshme të rinjve, studentëve, udhëheqësve fetarë, dijetarëve dhe njerëzve fetarë të gjitha besimeve. Rezultati pozitiv varet nga aftësia e tyre për të funksionuar në mënyrën që është e përshtatshme për nivelin e dialogut. Megjithatë, pavarësisht nga niveli, një fokus i karakterizon të gjithë ata: dialogu ndërfetar është për mirëkuptim reciprok dhe ndërtimin e paqes, jo për çdo lloj të debatit politik, social, apo teologjik. (Debati është një stil krejt tjetër i komunikimit).

Një dialog i feve: Kur njerëzit mendojnë për dialogun ndërfetar, ata zakonisht përfitojnë bashkëbisedime midis ose ndërmjet pasuesve laikë të feve të ndryshme. Bashkëbisedime të tilla zakonisht përqendrohen në organizimin dhe promovimin e aktiviteteve të ndryshme ndërfetare: shkëmbime të gjeneratave të shumta fetare-kulturore, demonstrime politike apo veprime të përqendruara në paqe dhe jo dhunë, diskutime për etikën globale apo në planifikime të takimeve për organizimin e ndihmës humanitare.

Ose, ata mund të marrin pjesë në atë që në shikim të parë mund të duket se janë përpjekje “më të thjeshta”, si aktivitetet fetare-shoqërore (p.sh., tubimet ndërfetare gjatë ushqimit apo një dialog në “dhomë të ndenjes”, duke përfshirë edhe vizita në faltoret e njëri-tjetrit për të kuptuar më mirë fetë e njëri-tjetrit). Fuqia e aktiviteteve të tilla nuk duhet të nënvlerësohet. Të huajt bëhen miq me anë të programeve të tilla të partneritetit. KMAI, SHIAV, ICNA, MAS, Misioni Musliman, dhe shumë organizata të tjera muslimane i marrin aktivitetet e tilla seriozisht. Ata sponsorizojnë dhe marrin pjesë në shtëpi të hapura, piknike dhe ak-

tivitete të tjera ku shkëmbimi shihet si hap i parë i nevojshëm për të kuptuar më mirë fetë e tjera.

Në Roçester, këto tubime, veçanërisht në mesin e anëtarëve të besimeve të Ibrahimit, janë quajtur “udhëtime shpirtërore.” Qendra Islamike e Roçester (QIR) zakonisht është nikoqire e një udhëtimit të tillë, duke siguruar ushqim dhe pije kur pjesëmarrësit jomuslimanë vijnë për të vizituar dhe për të mësuar për Islam. Në raste të tilla, qendra siguron që imami apo udhëheqësi i komunitetit me një njohuri të duhur të Islamit dhe një kuptim të qartë të dialogut ndërjetar udhëheq diskutimin.

Duhet pasur kujdes që t’iu ndihmohet muslimanëve të caktojnë të kuptojnë se çfarë po ndodhë në këto raste. Për shembull, një musliman njëherë i bërtiti një imami, duke e pyetur atë në mënyrë sfiduese se sa vizitorë kishte konvertuar ai. Imamit iu desh të shpjegojë me durim se qëllimi nuk ishte konvertimi, por ndërtimi i marrëdhënieve më të mira. Atij iu desh të sqarojë se dialogu ndërjetar largon stereotipat e rëndomtë të muslimanëve dhe u ofron jomuslimanëve një hapësirë për të reflektuar mbi të mirat e Islamit. Kjo nuk do të thotë se konvertimi është i pamundur; më shumë nënkupton se konvertimi nuk është pjesë e vetë dialogut. Në qoftë se një vizitor dëshiron të mësojë më shumë për Islam, ofrimi i udhëzimit të përshtatshëm do të ishte iduhur.

Dialogu ndërjetar në mes të udhëheqësve fetarë: Dialogu nëmes tëudhëheqësve fetarë po rritet me shpejtësi në mbarë botën, pasi që ata kërkojnë zgjidhje të reja për ndasitë në rritje ndërmjet njerëzve në tërësi dhe në mënyrë të veçantë në mes të dhe ndër pasuesit e të gjitha feve. Në varësi të angazhimit personal të liderit, pjesëmarrja dhe udhëzimet e tij ose të saj mund të inkurajojnë më shumë dialogun ndërjetar. Temat e dialogut do të ndryshojnë, por liderët zakonisht fokusohen në të kuptuarit fetar dhe shkëmbimin shoqëror.

Dialogu ndërjetar midis udhëheqësve dhe dijetarëve mund të ndodhë zyrtarisht, rastësisht apo spontanisht në varësi të formatit të përdorur. Formatet mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në, konferenca, seminare apo grupe të vogla (të dyja

të udhëhequra nga një lehtësues), simpoziume (takim i ekspertëve për të diskutuar mendime të ndryshme në lidhje me një temë të veçantë), seminare (ligjërata të pasuar nga një dialog interaktiv që u mundëson pjesëmarrësve të ndajnë përvojat), dhe forume (tubim për të diskutuar çështjet dhe shqetësimet e përbashkëta).

Forumi Ndërfetar i Roçester-it ofron një model të Dialogut Ndërfetar mes kolegëve. Udhëheqësit fetarë që përfaqësojnë fetë e tyre përkatëse janë anëtarë aktiv. (Laiqët zakonisht nuk janë të përfshirë në këto forume). Marrin pjesë afërsisht njëzet e dy grupe fetare. Dialogu Ndërfetar i vazhdueshëm gjithashtu ka themeluar komisione, siç është Komisioni për Marrëdhëniet e Krishtera-Muslimane (KMKM) dhe Komisioni për Mirëkuptimin hebre-musliman (KMHM). Një grup i afërm, Aleanca Muslimane - e Krishterë (AMK), është rezultat i një marrëveshjeje historike në mes të xhamive të qytetit dhe Dioqezës Katolike Romane të Roçester-it.

Përderisa më shumë të dhëna të këtij lloji të dialogut do të ofrohen në vijim, këtu duhet të theksojmë se sa sfiduese është kjo për komunitetin musliman. Zyrtarët fetarë të krishterë dhe hebrenj të cilët marrin pjesë në këtë lloj të dialogut janë me arsim të lartë. Në mungesë të imamëve të kualifikuar, muslimanët nuk mund të kenë ndikim serioz në një dialog të tillë. Edhe nëse mund të gjendet një imam plotësisht i kualifikuar për të marrë pjesë, prapë se prapë gjuha mund të paraqitet si pengesë. Nëse puna është kështu, atëherë zëvendësi më të ditur (mbi Islamin) i imamatit do të duhej të përfaqësonte komunitetin. Por mbi të gjitha, ky lloj dialogu kërkon një përgatitje gjithëpërfshirëse për një hulumtim më të thellë të mirëkuptimit ndërftetar. Pjesëmarrësit duhet të jenë në gjendje për të diskutuar çështjet shoqërore dhe veprimet me zgjuarsi, të jenë të njoftuar mirë me ngjarjet aktuale, dhe të çmojnë rëndësinë e rrjeteve dhe të ndërtimeve të marrëdhënive me komunitetin e gjerë. Imamët, si përfaqësues të komunitetit, kryejnë shërbim të madh ndaj Umetit duke u përfshirë si të barabartë në ngjarje të tilla jo-bashkëbiseduese si konferenca për shtyp, prezantime, dhe konferenca, në

veçanti ato që kanë të bëjnë me planifikim të komunitetit, përgjigje ndaj ngjarjeve aktuale dhe menaxhim të krizave.

Në një shkallë shumë më të gjerë dhe që përfshin një diversitet më të madh të pjesëmarrësve, Katedralja Kombëtare (Washington, DC) ndër vite ka organizuar shumë aktivitete ndërfaqetare në të cilat kanë marrë pjesë udhëheqësit e komunitetit Musliman, dijetarë dhe laikë. Organizatorët e ngjarjeve të tilla kanë qenë shumë të suksesshëm në integrimin e këtyre pjesëmarrësve me platforma të ndryshme, duke krijuar kështu hapësirë për bashkëbisedime formale dhe për ato të rastësishme.²⁰

SHIAV e ka bërë Dialogun Ndërfaqetare pjesë të deklaratës së misionit të tij dhe ka krijuar një forum të udhëheqjes që, ndër të tjera, trajnon imamë në punën ndërfaqetare. Ngjashëm, Instituti Salam, në bashkëpunim me SHIAV, ka marrë përsipër të organizojë një konferencë mbi Ndërtimin e Paqes Islame, Drejtësinë, dhe Dialogun Ndërfaqetare (shih për më shumë detaje mbi Rrjetin për Paqen Muslimane, Drejtësinë, dhe Dialogun ndërfaqetare në ueb sajtin e Institutit Salam).

*Bashkëbisedimet tjera të vlefshme ndërmjet udhëheqësve fetarë janë të dhëna si në vijim:*²¹

- Në Lindjen e Mesme, Klerikët për Paqe mbledhin së bashku rabinët, priftërinjtë, pastorët dhe imamët në Izrael dhe në Bregun Perëndimor për veprim të përbashkët dhe dëshmitar për paqe dhe drejtësi në rajon.
- Instituti Mbretëror për Studime Ndërfaqetare (Amman, Jordan) organizon bashkëbisedime dhe seminare për të promovuar marrëdhënie më të mira midis klerit dhe popullit të besimeve të Ibrahimit.
- Në Indinë Jugore, Këshilli i Grace i bashkon hindusët, të krishterët, muslimanët, sikët dhe jainët në përpjekje për të adresuar situata të konfliktit të komunitetit.
- Në rajonin e Paqësorit, Studimi Ndërfaqetare i bashkon përfaqësuesit e shumë religjioneve në Fixhi në mënyrë që të gjendet një mënyrë për të shmangur paragjykimet dhe për të promovuar respektin dhe vlerat e ndërsjella.

Dialogu Ndërfetar në Teologji: Ky lloj i dialogut bëhet në mes të anëtarëve e fakultetit. Për shembull, Dr. Isma'il R. al-Faruqi, një nismëtar kryesor i dialogut ndërftetar, ka marrë pjesë në përpjekjet e tilla gjatë fundit të viteve 1970-a dhe fillimit të viteve 1980-a.²² Ky aktivitet ka rezultuar me literaturë të vlefshme në çështjet ndërftetare. Rritja e interesit dhe angazhimi nga shumë kolegje dhe institute për studimet ndërftetare si një subjekt akademik i studimeve ka ringjallur dialogun në qarqet akademike. Për shembull, Kolegji Nazareth i Roçester-it kohët e fundit ka inauguruar Qendrën për Studime Ndërfetare dhe Dialog (QSND). Instituti Salam për Paqe dhe Drejtësi dhe Shkolla Fuller janë duke punuar së bashku për të ndërtuar struktura të përshtatshme. Universiteti i Notre Dam-it, Instituti i Kroc-it, dhe Qendra e Universitetit të Georgetoën për Mirëkuptimin Musliman – të Krishterë që të gjitha janë duke krijuar qendra për dialog teologjik ndërftetar.

Dialogu Shpirtëror: Dialogu shpirtëror, gjithashtu i quajtur “dialogu i përvojës fetare”, shpesh përfshinë një shumëllojshmëri të pjesëmarrësve. Ky dialog më shumë filozofik zbatohet përmes tregimeve dhe përvojave të njerëzve që njerëzit të cilët janë të sigurt në besimet dhe traditat e tyre fetare të cilët pranojnë të ndajnë përvojat e tyre shpirtërore me të tjerët (p.sh., përvojat e tyre të lutjes ose dialogu i tyre personal me Zotin). Me kalimin e kohës, kjo formë e dialogut është me gjasë më transformuesja për të gjithë pjesëmarrësit, pa marrë parasysh numrit të personave të përfshirë. Grupet e përqendruara në këtë lloj dialogu shpesh vizitojnë vendet e kultit për të rritur përvojën e tyre shpirtërore. Dialogu shpirtëror është i zakonshëm në gjithë Shtetet e Bashkuara.

NIVELET TJERA TË DIALOGUT NDËRFETAR DHE PJESËMARRËSIT

Çdo formë e dialogut duhet të përqendrohet, para së gjithash, në kontaktin dhe bashkëveprimin mes njerëzve që karakterizohet me dëgjim dhe kuptim të vëmendshëm.

Hapi i parë në një ndërmarrje të tillë është që t'i largojë mendimet apo opinionet e mëparshme të dikujt për "tjetrin". Në Çfarë Duhet të Dijë Bota në Lidhje me Dialogun Ndërfetar, Richard Landau përqendrohet në këtë temë dhe nxitë të gjithë pjesëmarrësit që të "shohin të tjerët si 'njerëz,' jo vetëm si simbole apo madje modele."²³

Për ta përmbledhur: nëse shtrohet pyetja se kush mund të marrë pjesë, natyrisht, përgjigja është se kushdo që dëshiron. Çelësi për dialog të suksesshëm ndërjetar është harmonizimi i nivelit të të kuptuarit të dikujt me pritjet e dialogut (për shembull, a dëshiron pjesëmarrësi të jetë i përfshirë në partneritet të bazuar në komunitet apo formë teologjike të dialogut). Përputhja e përshtatshme e individëve dhe llojet e bashkëbisedimeve ofrojnë simetri dhe ekuilibër të nevojshëm për dialog të suksesshëm. Veç kësaj, meqë dialogu i qëndrueshëm ndodhë gjatë një periudhe të gjatë kohore, është e rëndësishme për të përcaktuar nivelin e përkushtimit të pjesëmarrësve dhe përshtatjes së natyrës së dialogut në përputhje me rrethanat.

Aleanca Ndërfetare: Një aleancë ndërjetare është një grup i komuniteteve fetare që formojnë një aleancë për një qëllim të përbashkët shoqëror, politik, ekonomik ose arsimor. Këto aleanca përdorin forma të ndryshme të dialogut për tema apo çështje të ndryshme në përpjekjet e tyre për të sjellë ndryshime themelore për një politikë të caktuar publike. Aleanca Ndërfetare, një organizatë kombëtare me degë në të gjithë Shtetet e Bashkuara, është e përcaktuar në përpjekjet e tilla.²⁴ Aleanca Ndërfetare e Roçesterit (ANFR) dhe muslimanët janë të përfshirë në mënyrë aktive në aktivitetet e saj.

Habitati për Njerëzimin: Muslimanët në të gjithë vendin janë të përfshirë me jo-muslimanët në ndërtimin e shtëpive për Habitatin për Njerëzimin. Anëtarët punojnë së bashku për të ngritur fonde dhe rinovuar apo ndërtuar shtëpi të reja për njerë më të pafat. Komuniteti musliman i Roçesterit është aktivisht i përfshirë në këtë program, siç janë organizatat Muslimane në Illinois, Miçigan, Kaliforni, dhe në shtetet tjera.

Rrjeti mikpritës: Ky rrjet ndërftetar ofron mikpritje të përkohshme, zakonisht për një javë, për familjet e pastreha. Kishat, xhamitë dhe sinagogat i presin vullnetarisht familjet e tilla.

Komunitetet Studentore: Bashkëbisedimet e fokusuara në studentë janë në rritje të shpejtë në kampuset dhe kolegjet amerikane. Këto bashkëbisedime bashkojnë grupe të ndryshme të studentëve dhe ndihmojnë në aktivitete të përbashkëta. Komunitetet muslimane duhet të caktojnë imamë të trajnuar për të udhëzuar studentët muslimanë në çështjet fetare, këshillime dhe dialog ndërftetar. Shumë shoqata të studentëve muslimanë kanë nevojë për shërbime të tilla. Kur zhvillohet dialogu ndërftetar, vërehet se studentët të cilët kanë më shumë njohuri për Islam dhe kanë njëfarë kualifikimi në fetë krahasuese kanë tendencë të jenë më të ndjeshëm ndaj feve të tjera. Këtu, ne gjejmë se shoqatat e tilla janë Fëmijët e Institutit Ibrahim (FIA) në Universitetin e Virjini²⁵, Qendra për Mirëkuptimin Musliman – të Krishterë në Universitetin Georgetown²⁶, Këshilli Ndërftetar Studentor në Universitetin e Jutës (KNS-U)²⁷, Bunting Meyerhoff Interfaith dhe Qendra e Shërbimeve Komunitare e Universitetit John Hopkins²⁸, dhe Komunitetet Ndërftetare të Bashkuara për Drejtësi dhe Paqe (KNBDP) në Universitetin e Kalifornisë Jugore.²⁹

Dialogu ndërftetar i grave: Grupet e grave janë shumë të popullarizuara. Në shumë qytete, dhe në kampuset mbarëkombëtare, gratë muslimane formojnë grupe për t'u angazhuar si në bashkëbisedime teologjike ashtu edhe ato shoqërore. Sikurse me grupe të ngjashme, të gjithë pjesëmarrësit muslimanë duhet të kenë një njohuri të bazuar të Islamit dhe të feve të tjera, si dhe një këshilltar apo imam që mund t'i mbështes dhe t'i udhëzojë ata. Një model i mirë mund të gjendet në Katedralen Kombëtare grupi i së cilës gjithashtu mbështet një iniciativë me bazë gjinore për gratë e besimeve të ndryshme të njohur si "Rrethi i shenjtë." Një tjetër nismë është Grupi i Veprimtimit Ndërftetar i Grave i Universitetit të Bostonit.³⁰

Grupet Rinore: Janë duke u bërë përpjekje, veçanërisht në mesin e hebrenjëve, të krishterëve dhe muslimanëve të rinj, për të formuar grupe të tilla. QSND-ja ka një program vjetor veror të rinjve, pavarësisht nga feja e tyre, të interesuar për punë ndërjetare.³¹ NCCJ në Detroit sponsorizon një program të mirë të njohur si Bijtë e Ibrahimit. Bazuar në një kthim në vlerat tradicionale të familjes, Bijtë e Ibrahimit i ekspozojnë të rinjtë ndaj dialogut ndërjetar.³² Një tjetër shembull është Aleanca Rinore Ndërjetare e Ajdaho, e cila e përshkruan veten si vijon: Aleanca Ndërjetare Rinore është një projekt ndërjetar mbarështetëror për të bashkuar njerëz të ndryshëm të ri të besimit për: 1) t'u lidhur më thellë me pjestarët e traditës së tyre të besimit që frymëzon veprim shoqëror; 2) të mësojnë të kuptojnë, vlerësojnë dhe respektojnë traditat e tjera fetare; dhe 3) të bëjnë ndryshim në komunitetet tona, në shtet dhe në botë përmes veprimit ndërjetar social. IYA udhëhiqet nga të rinjtë e moshës 15-25 dhe aleatë të rritur që përfaqësojnë bashkësitë e ndryshme fetare të Ajdaho.³³ Dialogu nuk është i kufizuar për pjesëmarrësit e mësipërm. Të gjithë muslimanët duhet të marrin pjesë në dialogun ndërjetar për të siguruar një përfaqësim më të larmishëm të Islamit për komunitet. Ky angazhim i gjerë do të ndihmojë në heqjen e stereotipave dhe perceptimeve të gabuara dhe për të ndërtuar një shoqëri të fortë, produktive civile.

TEMAT E SUGJERUARA

Siç u tha më lart, dialogu ka forma të ndryshme dhe përfshin një shumëllojshmëri të njerëzve. Natyrisht, temat dhe subjektet e tij pasqyrojnë këtë diversitet. Dialogu ka të bëjë me komunikimin në mes të njerëzve me të gjithë kompleksitetin që përfshin një ndër marrje e tillë. Edhe pse dialogu mund të zhvillohet nga një diskutim apo një debat, ai megjithatë mbetet një komunikim unik që ka përkufizimet, udhëzimet, mundësitë dhe rezultatet e tij.

Dialogu ndërftetar mund të ketë tema të ndryshme në varësi të formës së tij, si dhe në varësi të nivelit të interesit, kuptimit dhe njohurive të pjesëmarrësve. Për shembull, veprimi social është një temë e zakonshme produktive dhe mund të përfshijnë tema lidhur me sistemin e drejtësisë penale, drejtësisë ekonomike, arsimin, drejtësinë e mjedisit, barazinë gjinore, shëndetin dhe çështjet kulturore, paqen globale, paqen dhe sigurinë, racën dhe përkatësinë etnike dhe pjesëmarrjen politike.³⁴ Më poshtë janë dhënë disa tema të sugjeruara.

Çështjet e bazuara në fe: Shumica e bashkëbisedimeve ndërftetare përqendrohen në prezantimin e realiteteve të një feje të njerëzve që itakojnë një feje tjetër. Udhëheqësit me njohuri të religjionit krahasues duhet të lehtësojnë prezantimin. Ka grupe që përdorin një film apo një libër për të informuar grupin për një fe të caktuar para se të angazhohen në ndonjë diskutim, dhe pastaj e vazhdojnë atë me një seancë pyetjesh dhe përgjigjesh, dhe, në fund, me dialog. Është dëshmuar që një qasje e tillë është e dobishme.

Shqetësimet ose çështjet e përbashkëta të bazuara në komunitet: Këto shqetësime mund të radhiten nga çështjet bërthamore, mjedisore, apo ekonomike në shkallë ndërkombëtare ose vendore deri te çështjet që kanë të bëjnë me arsimin, shërbimet qeveritare, apo transportin.

Drejtësia Shoqërore dhe të Drejtat Civile: Mbrojtja dhe përmirësimi i të drejtave civile është një tjetër shkak njerëzor dhe fetar. Muslimanët duhet të marrin pjesë aktive në të gjitha aktivitetet që lidhen me arsimin, aktivizmin, lobimin, reformimin e sistemit të drejtësisë penale, dhe ndalimin e përdorimit të torturës, profilizimit racor, si dhe formave të tjera të diskriminimit. KMAI është lider në këto fusha.

Feja dhe Raca: Barazia racore mund të jetë një temë për të cilën muslimanët mund të japin një kontribut veçanërisht të

madh duke theksuar se Islami përkrah barazinë e të gjitha racave dhe ndalon racizmin. Është e rëndësishme që muslimanët të punojnë si me grupe të pakicës ashtu edhe të shumicës për të parandaluar diskriminimin në arsim, në vendin e punës, dhe në jetën shoqërore.

Barazia gjinore: Kjo është një temë e rëndësishme, sepse shumë jomuslimanë në Perëndim, për të mos përmendur pjesën tjetër të botës, besojnë se Islami, si fe, shtyp gratë dhe i privon ato nga të drejtat e tyre. Ky keqkuptim duhet të ballafaqohet në kuadër të procesit të dialogut ndërjetar. Pjesëmarrësit muslimanë mund të theksojnë se Islami përkrah mbrojtjen e të drejtave si të burrave ashtu edhe të grave. Kurani dhe Suneti paraqesin rastin për këto të drejta në mënyrë të detajuar, duke theksuar të kuptuarit e Islamit të rolit plotësues të burrave dhe grave - por të barabartë. Është gjithashtu e rëndësishme të shpjegohet dallimi në mes të zakoneve kulturore dhe mësimëve autentike islame. Për shembull, njerëzit në Perëndim shpesh besojnë se vrasja për nder është një besim themelor islam, ndërsa ai është në fakt një praktikë e lokalizuar kulturore. Megjithatë, mbrojtja e barazisë gjinore mund të bien në vesh të shurdhër, nëse gratë muslimane nuk janë të përfaqësuara në mënyrë adekuate. Dialogu është një aktivitet i mundësisë së barabartë dhe duhet të kuptohet në këtë mënyrë nga të gjithë pjesëmarrësit.

Ndihma Humanitare: Shumë takime ndërjetare përqendrohen në sigurimin endihmave humanitare për viktimat e fatkeqësisë. Ndihma për të varfrit, të moshuarit dhe refugjatët është një temë Kuranore e përsëritur shpesh. Kurani udhëzon muslimanët të marrin pjesë aktive në programet ndërjetare që përqendrohen në ofrimin e ndihmës së tillë. Muslimanët që ndihmojnë në mensat për të varfrit, strehimoret, qendrat e trajnimit, shtëpitë në gjysmë të rrugës dhe klinikat shëndetësore përbushin urdhrin për të dhënë lëmoshë, një prej pesë shtyllave të Islamit.³⁵ Kështu, Shoqata e Studentëve Muslimanë në Universitetin Middle Tennessee State citon vargjet e mëposhtme

Kuranore dhe hadithet për të forcuar angazhimin e saj për veprimet bamirëse: Profeti tha: “Edhe ta takosh vëllain tënd me fytyrë të buzëqeshur është një akt bamirësie.” Profeti gjithashtu ka thënë: “Bamirësia është një domosdoshmëri për çdo musliman.” Ai u pyet: “Çfarë në qoftë se një person nuk ka asgjë?” Profeti u përgjigj: “Ai duhet të punojë me duart e veta për të mirën e tij dhe pastaj të jap diçka nga ato të ardhura për bamirësi.” Sahabët pastaj e pyetën: “Po në qoftë se ai nuk është në gjendje të punojë?” Profeti tha: “Ai duhet të ndihmojë të varfrit dhe nevojtarët.” Sahabët pyetën më tej: “Çfarë nëse ai nuk mund ta bëjë madje edhe këtë?” Profeti tha: “Ai duhet t’i nxisë të tjerët të bëjnë vepra të mira.” Sahabët thanë: “Po në qoftë se i mungon edhe kjo?” Profeti tha: “Duhet të ruhet për të mos bërë vepra të këqija. Kjo është gjithashtu një akt bamirësie.”³⁶

Të drejtat e kafshëve dhe mbrojtja e mjedisit: Shumë grupe të dialogut janë interesuar për të drejtat e kafshëve. Për fat të keq, shumë pjesëmarrës, duke përfshirë muslimanët, supozojnë se mësimet islame nuk mbështesin mbrojtjen e të drejtave të kafshëve dhe e konsiderojnë këtë temë si ‘të lehtë’ ose ‘jo aq serioze.’ Përkundrazi, Profeti ka theksuar mbrojtjen dhe kujdesin ndaj krijesave të Tokës, edhe Sheriati thotë se kafshët duhet të vriten në mënyrë të njerëzishme (jo kot) dhe vetëm për ushqim (jo për sport). Kjo ndalesë nuk imponon vegjetarianizmin ose mos therjen e kafshëve; përkundrazi, ai thjesht pohon se kafshët, kur vriten, duhet të trajtohen në mënyrë humane dhe me respekt.

Profeti e bëri të qartë se trajtimi human duhet të shtrihet tek kafshët që disa kultura i konsiderojnë të papastra: Profeti u rrëfeu shokëve të tij historinë e një njeriu i cili gjeti një qen që gulçonte nga etja. Ky njeri zbriti në një pus, mbushi këpucën e tij me ujë dhe ia ofroi atë qenin për të shuar etjen e tij. Profeti ka thënë: “Pastaj Allahu ishte mirënjohës për të dhe ia fali atij mëkatet.” Shokët pyetën: “O i Dërguar i Allahut, a ka një shpërblim për ne në lidhje me kafshët? “Ai u përgjigj: “Ekziston një shpërblim në lidhje me çdo krijesë të gjallë.”³⁷ Shumë ajete Kurane dhe hadithe mbështesin idenë se Islami bën thirrje për

mbrojtjen e mjedisit dhe për ruajtjen e burimeve natyrore. Muslimanëve u është thënë në mënyrë të përsëritur të ruajnë dhe të mbrojnë mjedisin e tyre – kurrë të mos abuzojnë me të. Edhe gjatë luftës, Islami ndalon shkatërrimin e pronës, burimeve natyrore dhe mjeteve të jetesës së njerëzve.

Shkollat dhe arsimi: Një mundësi e barabartë në arsim është e drejtë etë gjithë njerëzve. Për shkak të statusit të imigracionit të komuniteteve të emigrantëve të gjeneratës së parë, shumë muslimanë përballen me sfida të mëdha gjatë negociimit të sistemeve arsimore në të cilat ata regjistrojnë fëmijët e tyre. Kështu, edukimi bëhet një temë e ngutshme për diskutim në një ambient ndërjetar. Duke marrë pjesë më aktivisht në diskutime të tilla, muslimanët mund të luajnë një rol më të drejtpërdrejtë në përmirësimin e kushteve të shkollave dhe plan programin e tyre dhe në adresimin e çështjeve që janë të rëndësishme për të rinjtë.

Festimi i ritualeve fetare dhe festave: Duke pasur parasysh se Muslimanët janë një komunitet pakicë në Perëndim, ritualet e tyre fetare mund të nën përfaqësohen apo marginalizohen. Si rezultat, dialogu ndërjetar bëhet i rëndësishëm si një forum për të adresuar mënyrën se si institucionet publike (p.sh., shkolla) duhet të festojnë festat. Për shembull, anëtarët e grupit të dialogut ndërjetar të Roçesterit kanë arritur të bindin distriktet shkollore lokale për të shtuar sasinë e kohës të përkushtuar për mësim për festat e të gjitha feve dhe për të minimizuar shfaqjen e simboleve fetare të shumicës së krishterë.

Krimi, bixhozi dhe çështje të tjera: Grupet e dialogut ndërjetar mund të jenë të organizuar rreth këtyre temave dhe temave të ngjashme pasi që ato paraqesin shqetësim për të gjithë pa dallim feje. Muslimanët duhet të jenë në ballë të avokimit kundër pijes, kumarit dhe veseve të tjera.

Familja dhe Traditat: Islami ka tradita familjare joshëse dhe unike.

Kështu, muslimanët nuk duhet të hezitojnë që të kenë një seminar të përbashkët mbi jetën familjare dhe vlerat e përbashkëta. Për shkak të natyrës së saj arsimore dhe një natyre relativisht jo kundërshtuese, një diskutim i tillë duhet të tërheqë më shumë pjesëmarrës jomuslimanë.

Ekstremizmi dhe fundamentalizmi: Të gjetura në të gjitha besimet dhe shoqëritë, këto realitete ekzistuese janë tema të mira ndërftetare. Është e rëndësishme që njerëzit të mësojnë të bëjnë dallimin në mes të mësimëve autentike dhe atyre mësimëve të rreme 'islame' të përdorura nga 'muslimanët' për të justifikuar aktet e terrorizmit. Rëndësia e kësaj teme rrjedh nga niveli aktual dhe natyra e dhunës gjithëpërfshirëse në vendet muslimane dhe nga përgjigjja perëndimore ndaj saj. Grupet ndërftetare duhet të adresojnë këto çështje në mënyra që janë të lidhura me shqetësimet aktuale. Duhet të bëhet e qartë se terrorizmi i shqetëson muslimanët po aq sa edhe gjithë të tjerët.

Falja dhe Mëshira: Diskutimi i këtyre koncepteve nga një këndvështrim islam mund të jetë një nga mënyrat më të mira që një seminar ndërftetar të tejkalojë imazhin negativ të islamit. Shumë njerëz në Perëndim besojnë se Islami është një fe e hakmarrjes për shkak se ata nuk e dinë se mësimet e tij kryesore janë falja dhe mëshira.

Lista e temave të mundshme të dialogut ndërftetar dhe çështjet e paraqitura këtu sigurisht nuk janë shteruese. Pasi që pjesëmarrësit muslimanë duhet të jenë gjithmonë të përgatitur për të ofruar perspektivë Kuranore apo islame, ata duhet të vijin në çdo takim plotësisht të përgatitur. Pjesëmarrësit mund të kenë nevojë të konsultohen me imamin e tyre ose një autoritet fetar për çështje të caktuara. Kërkimi i këshillave të tilla është shumë më mirë sesa dhënia e informacionit të pasaktë, gjë e cila mund të kontribuojë në imazhin tashmë negativ të Islamit.

PLANIFIKIMI I PROGRAMEVE NDËRFETARE

Për të realizuar seminare të suksesshme ndërjetare dhe programe të tjera, duhet të merren në konsideratë elementet e mëposhtme:

Nën komitetet: Pasi të takohen pjesëmarrësit dhe të pajtohen për udhëzimet, ata do të ballafaqohen me shumë detyra të tjera. Së pari, ata do të duhet të vendosin për atë se çfarë nën komitete duhet të formojnë për të realizuar qëllimet e deklaratës së tyre të misionit. Mund të ketë nën komitete për media, arsim, aktivitete të drejtësisë shoqërore, për të ndihmuar viktimat e fatkeqësive natyrore dhe mbrojtjen e të drejtave civile. Këto komitete duhet të takohen kohë pas kohe dhe i paraqesin rekomandimet e tyre komisionit të përbashkët/grupit të dialogut ndërjetar.

Komitetet e Planifikimit: Pasi që një takim i efektshëm ndërjetar kërkon shumë përgatitje, një komision i planifikimit duhet të formohet. Anëtarët e saj ndoshta duhet të takohen disa herë për të përcaktuar datën, kohën dhe vendin e programit. Ndër detyrat e tij janë këto: përgatitja e një fletushke, publikimi i ngjarjes, arritja tek grupet potencialisht të interesuara, zgjedhja e një koordinatori, përgatitja e një formulari për vlerësim, garantimi i sigurisë dhe organizimi i pritjes dhe gjëra të tjera të domosdoshme të rëndësishme për sigurinë dhe rehatinë e pjesëmarrësve.

Kur vendosen normat e takimeve dhe rregullat bazë, udhëheqja duhet të pajtohet për parimet e mëposhtme:

1. *Shmangni proselitizmin:* Sigurohuni që folësit dhe të tjerët ndjekin “dëgjojnë të tjerët ashtu si ju do të donit që ata të ju dëgjojnë.”
2. *Shpërndani përgjegjësitë:* Ndani përgjegjësitë në mënyrë të barabartë. Mos kërkonit të dominoni, por konsultohuni me njëri-tjetrin.
3. *Respektoni zërin e secilit organizator:* Pavarësisht nga madhësia e tij, pjesëmarrja e secilit komunitet fetar du-

het të respektohet si e barabartë me të secilit komunitet tjetër. Në mënyrë të ngjashme, përfshirja më e madhe e një individi nuk duhet të përkthehet në dhënien më shumë peshë mendimit të tij ose të saj.

4. *Menaxho kohën e programit në vijimësi dhe në mënyrë të drejtë*: Programet duhet të fillojnë në kohë. Në çdo seminar ose forum që përfshin një prezantim, secilit grup duhet dhënë kohë të barabartë. Dispozita e kohës adekuate për një seancë të pyetjeve dhe përgjigjeve është thelbësore. Në përgjithësi, një e treta e kohës duhet të jetë e rezervuar për këtë seancë.
5. *Njihni tensionin apo kritikën*: Ankesat apo kritikën nga ndonjë burim duhet të dëgjohen dhe të vlerësohen pa qasje mbrojtëse. Vlerësimet e mbledhura pas programit duhet të analizohen në mënyrë kritike dhe sugjerimet e vlefshme duhet të zbatohen para ngjarjes së ardhshme.
6. *Realizoni programet në vende të ndryshme*: programet dhe takimet ndërftetare duhet t'i nënshtrohen rotacionit në mes të vendeve të adhurimit të pjesëmarrësve në mënyrë që të krijojnë një ndjenjë të pronësisë dhe për të forcuar lidhjen e partneritetit.
7. *Shmangni të gjitha format e dominimit*: Asnjë grup nuk duhet të lejohet të kryesojë grupin ndërftetar, nën komitetet, apo komitetet e planifikimit vazhdimisht. Rregullat duhet të sigurojnë rotacionin e udhëheqjes.³⁸
8. *Mësoni të luteni së bashku*: Takimet duhet të fillojnë dhe të përfundojnë me lutje të shkurtra të përshtatshme për grupet fetare që përfaqësohen. Çdo anëtar mund të lutet të recitojë ato lutje. Nëse një lutje e shkurtër për bekim lexohet në raste të tilla në emër të Zotit, Muslimanët nuk duhet të kenë asnjë kundërshtim. Lutjet ndërftetare mund të bëhen kur udhëheqësit ndërftetar takohen në një kohë fatkeqësie, lufte, krimi. Mund të lutet një anëtar i secilit grup të lexojë lutjet e paqes. Zakonisht muslimanët lexojnë kapitullin hyrës të Kuranit

apo ajetin Kuranor 2:63-64 me rastin e një fatkeqësie, ajetin Kuranor 49:11-13 në rastin e një shkeljeje të të drejtave civile, ose thjesht selami (lutjet për paqe) që recitohen në fund të pesë namazeve ditore.

Në përfundim, çdo grup i dialogut duhet të sigurojë që të gjitha palët të kenë një pjesë të barabartë, përgjegjësi të barabarta dhe respekt të barabartë. Përveç kësaj, anëtarët e saj duhet të sigurohen se nën komitetet janë duke punuar së bashku dhe se udhëheqësit janë të vetëdijshëm për atë që po ndodh në çdo nivel në mënyrë që të mund të parandalojnë problemet para se ato të ndodhin. Para se një grup dialogu të fillojë ndonjë program, ai duhet të sigurojë për të gjithë anëtarët një kopje të udhëzimeve të nevojshme, si dhe trajnim sensibilizues.

PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT

- Dialogu i brendshëm musliman është thelbësor për unitetin dhe mirëkuptimin musliman dhe dialogu ndërjetar është i nevojshëm për bashkëjetesën me respekt dhe paqësore.
- Kurani dhe Suneti kërkojnë prej muslimanëve të mos bërtasin, të mos flasin ashpër apo keq për të tjerët, apo të kritikojnë të tjerët në mënyrë të drejt-përdrejtë. Përkundrazi, ata duhet të jenë të sjellshëm dhe të butë, le të flasin të tjerët, të dëgjojnë me vëmendje dhe të sillen siç duhet.
- Dhjetë pikët e Dr. Sëidlerit dhe pesë pikët e Dr. al-Faruqi mund të merren si parime udhëzuese shtesë për një dialog të suksesshëm të bazuar në udhëzimet e Kuranit dhe Sunetit.
- Dialogu i brendshëm në mes të muslimanëve është pothuajse jo ekzistues, ose së paku sigurisht i rrallë. Dialogu ndërjetartani është duke u zhvilluar në shumë nivele dhe vazhdon të jetë shumë isuk-

sesshëm në shumë fusha të shërbyerit të tjerëve.

- Imamët në çdo qytet duhet të krijojnë dialog të brendshëm fetar dhe t'i bashkohen grupeve ekzistuese të dialogut ndërftetar për të shërbyer më mirë komunitetin musliman.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. Shumë jomuslimanë kanë shkruar udhëzime për dialog ndërftetar ndër muslimanë, Dr. al-Faruqi ka shkruar për këtë temë. A dini për muslimanë të tjerë që kanë shkruar për udhëzimet ndërftetare dhe/ose qëllimit dhe kufizimeve të tyre?
2. A mund të sugjeroni ajete Kuranore apo hadithe si udhëzime për dialog ndërftetar përveç atyre të dhëna më lart?
3. Nëse mendoni se muslimanët duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive në dialogun ndërftetar, a pajtoheni me udhëzimet e ofruara sipër? A mund të ofroni sugjerime shtesë për të përmirësuar dialogun? Shpjegoni.
4. Po të merrnit pjesë në një dialog, si do të përgatiteshit për të?

KAPITULLI III

PERSPEKTIVAT KURANORE TË DIALOGUT NDËRFETAR

QË NGA fillimi i tij, Islami (përmes Profetit) ka ndërvepruar me jomuslimanët. Gjatë periudhave të Medinës dhe Mekës, mësimet islame udhëzuan muslimanët e parë drejt mënyrave të duhura të adresimit dhe trajtimit të jomuslimanëve. Faqet e mëposhtme shqyrtojnë disa ajete Kuranore dhe hadithe që ofrojnë shembuj të ndërveprimit të tillë. Shumë imamë dhe dijetarët muslimanë citojnë ajete të tilla, veçanërisht në kontekstin e thirrjes për paqe dhe pajtim në mes të muslimanëve në situatë të konflikteve.¹

Edhe pse dialogu ndërfetar u zhvillua brenda një konteksti jomusliman, Islami ka shumë koncepte dhe terme të ngjashme, duke përfshirë gjuhën për vetë procesin e dialogut. Këto koncepte janë hartuar që prej kohës së Profetit si për dialog të brendshëm-musliman ashtu edhe për dialog ndërfetar. Studimi i Kuranit zbulon se ai përmban një proces të rrënjësor thellë të dialogut. Duke shqyrtuar listën e parimeve të përmendura në kapitullin e mëparshëm, ne mund të kuptojmë nevojën dhe të vlerësojmë mënyrën për ndërtimin e marrëdhënieve njerëzore dhe ndërfetare.

DISA TERME KURANORE

Ta'arafu: *Ta'arafu* është përkufizuar si njohje, mirëkuptim dhe ndërtim i marrëdhënieve. Një takim ndërfetar mund të quhej një *majlis li Ta'arafu* (një takim për ndërtim mirëkuptimi):

O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (49:13)

Supozimi kryesor i dialogut ndërftetar është se diversiteti fetar dhe shumëllojshmëria e rrugëve shpirtërore për të vërtetën është me origjinë hyjnore. Kurani mbështet këtë besim, duke deklaruar në mënyrë të qartë në ajetin e mësipërm se Allahu, në urtësinë e Tij dhe me qëllim të plotë, krijoi kombe dhe fise të ndryshme, secili me rrugën e vet shpirtërore. Por Kurani gjithashtu pohon se Allahu ka për qëllim që njerëzit të kërkojnë të njohin njëri-tjetrin dhe të mësojnë nga dallimet e njëri-tjetrit (*li Ta 'Arafu*).

Ta'Arafu është ilustruar në tregimin e mëposhtëm. Një herë një udhëtar musliman i cili hyri në një xhami nuk dinte se si të falej. Një musliman lokal e akuzoi atë në mënyrë të ashpër se ishte injorant për Islamin sa që këta të dy ishin gati të luftonin. Megjithatë, udhëtari i fyer shpejt u qetësua kur të tjerët iu afruan atij dhe me edukatë iu prezantuan atij. Kur muslimani që ofendoj ishte qetësuar, ai i kërkoi falje njeriut të porsaardhur.

Ta'Arafu ndihmon gjithashtu në marrëdhëniet ndërftetare. Për shembull, kur një grua e re jomuslimane u martua me një musliman, prindërit e saj e kundërshtuan, sepse ata kishin një imazh shumë të keq për Islamin. Ata i thanë asaj se ajo po marotohej me një "terrorist". *Ta'Arafu* ndryshoi mendësinë e gjithë familjes. Gruaja e re më vonë e pranoi Islamin, dhe prindërit e saj e pranuan martesën e saj.

Aktivitetet ndërftetare arsimore (p.sh., seminarët dhe ligjëratat për fetë botërore, tubimet shoqërore të muslimanëve me jomuslimanët), racionet ndërftetare, përpjekjet bashkëpunuese në programet e drejtësisë shoqërore (p.sh., Habitati për njerëzimin), dhe të gjitha aktivitetet e ngjashme që çojnë drejt ndihmës dhe ndërtimit të marrëdhënieve me njerëz janë shfaqje të *Ta'Arafu*. Detyra për të njohur të tjerët dhe për të vlerësuar

unikalitetin e tyre si shprehje e vullnetit të Allahut është funksion thelbësor i dialogut. Ky nuk është një koncept i huaj në Islam; më shumë, ai është pjesë integrale e tij.

I//lah: Një term tjetër Kuranor, *i//lah* (ndërtimi i urave, pajtimi, rivendosja e marrëdhënieve dhe zgjidhja e konflikteve) shfaqet në shumë forma kudo në Kuran. Për shembull, Kurani i thërret shpesh ndërtuesit e urave *mullihIn* (fjalë që rrjedh nga fjala *i//lah*). Është e qartë, ky term është i lidhur me kuptimin e hulumtimit të dialogut ndërjetar të bashkëjetesës paqësore dhe marrëdhënieve të mira. Derivatet tjera janë *ulh* (ndërtimi i paqes dhe zgjidhja e konfliktit) dhe *jalaha* (të dëshiruarit e më të mirës, ndërtimi i urave, dhe kërkimi i mirësisë). Shembujt e mëposhtëm nënvizojnë theksin Kuranor në të ndihmuarit e të tjerëve drejt mirësisë dhe pajtimit:

S'ka kurrfarë të mire në shumë prej bisedave të tyre të fshehta, përveç rastit kur ndokush kërkon që të jepet sadaka ose të kryhet një vepër e mirë apo paqësim ndërmjet njerëzve. Atij që e bën këtë për të fituar kënaqësinë e Allahut, Ne do t'i japim një shpërblim të madh. (4:114)

Ai u përgjigj:

"O populli im, mendoni pak! Nëse unë kam provë të qartë nga Zoti im, i Cili më ka furnizuar me begati të mira nga ana e Vet, a të mos ju udhëzoj në rrugën e drejtë?! Unë nuk dëshiroj të bëj atë, që ju ndaloj juve. Unë dëshiroj vetëm të përmirësoj atë që mundem. Ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem. (11:88)

Më tej, Kurani kërkon prej njerëzve që të veprojnë me drejtësi gjatë gjithë kohës:

Popullit të Medjenit Ne i dërguam vëllain e tyre, Shuajbin, i cili u tha: "O populli im! Adhuroni Allahun! Ju nuk keni zot tjetër përveç Tij. Me të vërtetë, ju ka ardhur provë e qartë nga Zoti juaj, prandaj matni dhe peshoni saktë, mos u hani hakun njerëzve dhe mos bëni ngatërresa në tokë, pasi të jetë vënë rregulli në të. Kjo është më mirë për ju, nëse jeni besimtarë! (7:85)

Dialogu ndërftetarnuk është asgjë më shumë se të punuarit për të sjellë *islah* (pajtimit dhe ndërtim të marrëdhënieve). *Islah* në mes të muslimanëve sjellë bashkim dhe përparim; në marrëdhëniet ndërftetare, ai kultivon marrëdhënie të mira dhe bashkëjetesë paqësore. Roli i imamit është të lehtësojë pajtimin dhe udhëzimi si Brenda komuniteteve muslimane ashtu edhe në marrëdhënie me komunitetet e tjera. Për shembull, imamët duhet të zgjedhin konfliktet familjare. Herë pas here, madje edhe qiftet jomuslimane kërkojnë ndërhyrjen e tyre. *Islah* është një rrugë profetike dhe bart me vete një përgjegjësi të madhe. Duke qenë e vështirë, puna në përmirësimin e marrëdhënieve familjare dhe shoqërore mund të realizohet më së miri nëpërmjet *islah*. Një pjesë e madhe e punës ndërftetare është në të vërtetë punë e *islah*, qoftë nëse përfshin pjesëmarrjen në mjedis për njerëzimin, ndërmjetësimin e konflikteve racore dhe etnike, ose, më e rëndësishmja, shërimin e përçarjeve brenda bashkësisë muslimane në botë.

Mujadalah: Ky term Kuranor përshkruan një periudhë të hershme historike në marrëdhëniet ndërftetare kur pasuesit e feve të ndryshme përpiqeshin të konvertonin njëri-tjetrin. Qarqe të veçanta ndërftetare të dedikuara fillimisht për diskutim logjik u përshkallëzuan në argumente armiqësore në të cilat dy ose më shumë pale garonin për të dëshmuar se cila ishte më e aftë për të dhënë përgjigje në pyetjet teologjike. Kështu, *mujadalah* i referohet çdo përpjekje për të konvertuar të tjerët. Ishte praktikuar, para Islamit, në mes të krishterëve, hebrenjëve dhe të tjerëve. Kurani reformoi këtë praktikë duke kërkuar nga muslimanët që të tregojnë respekt për të tjerët kur merren me veprimtari të tilla: "Diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mire..." (29:46). Kurdo që kishte dialog ndërftetar në mes të krishterëve dhe muslimanëve apo hebrenjëve dhe muslimanëve, muslimanët e hershëm tregonin respektin e tyre për të tjerët dhe, kur ata dallonin, e bënin këtë me dinjitet dhe shmangnin gjuhën e ashpër.

Të ndikuar nga ky precedent historik, muslimanët bashkëkohor shpesh kanë përdorur *mujadalah* me radhë me debatet

teologjike. Duhet të jetë e qartë nga ajo që u tha më lartë, megjithatë, se mujadaloh nuk është një sinonim për dialog, sepse të dy veprimtaritë kanë objektiva dhe struktura të ndryshme. E vetmja gjë që ata kanë të përbashkët është një angazhim për të shmangur ashpërsinë dhe forcën fizike.

Ihsan: *Ihsan* rrjedh nga rrënja e fjalës *hasan* (për të përmirësuar, për të bërë më të bukur, për t'u dukur më së miri). Kurani kërkon nga muslimanët që angazhohen në dialog ndërjetar të flasin dhe të veprojnë në mënyrë të civilizuar, madje edhe nëse partnerët e tyre nuk veprojnë kështu: "Por, pasi që nuk barazohet e mira me të keqen! Të keqen ktheje me të mirë e atëherë armiku yt do të bëhet menjëherë mik i ngushtë." (41:34)

Ja një shembull se si *Ihsan* mund të përdoret: Një herë një imam në Nju Jork iu përgjigj një thirrje telefonike nga një njeri i cili i tha atij: "Lësho këtë vend dhe shko në shtëpi, i krisur." Imami i kërkoj atij me mirësjellje që të vinte për të pirë çaj në mënyrë që ata të takoheshin dhe të bisedonin. Burri filloi të qetësohej dhe më vonë kërkoi falje.

Ihsan riparon dëmin dhe largon sëmundjen nga zemrat e njerëzve. Të gjithë profetët ishin *muhsinIn* (bëmirës). *Ihsan* është një mënyrë profetikepasi që ata që e praktikojnë atë fitojnë zemrat e njerëzve.

Al-hikmah ua al-Mau'i-ah al-hasanah: Kuptimi i kësaj fraze është "urtësi dhe këshilla të bukura." "Thirr në rrugën e Zotit tënd me mençuri dhe këshillë të bukur dhe diskuto me ata në mënyrën më të mirë! Me të vërtetë, Zoti yt i di më së miri ata që janë shmangur nga rruga e Tij, e di më së miri ata, që janë në rrugë të drejtë". (Kuran 16:125) Në vitet e fundit të jetës së Profetit në Mekë, kur ai dhe pasuesit e tij po përballëshin me shkallën më të rëndë të persekutimit, u shpall ky ajet. Për dallim nga mënyra e hakmarrjes së beduinëve një për një, Kurani u tha muslimanëve që t'ua kthejnë persekutimin mekasve me mjaltë të bletëve – me fjalë të tjera, me urtësi dhe duke dhënë këshilla

të mira. Kjo qasje ka gjithashtu një efekt të fuqishëm mbi marrëdhëniet ndër-muslimane, sepse sjell unitet dhe prosperitet për të gjithë komunitetin.

Ta'awun: Kjo fjalë tregon mandatin Kuranor për të punuar së bashku për të mirën e krijimit të Zotit. Ai ka për qëllim të zbatohet për njerëzit që përndryshe mund të shihen si armiq, siç shiheshin Mekasit në kohën e Profetit. Nëse do të zbatoheshin sinqerisht, mirëqenia e të gjithë njerëzve është e sigurt. *Ta'awun* është parim themelor në të kuptuarit e tanishëm të dialogut dhe zgjidhjen e konflikteve. Njerëzit bashkohen në dialog ndërftetar për të kuptuar njëri-tjetrin dhe për të punuar së bashku për përmirësimin e komunitetit:

O besimtarë! Mos e cenoni shenjtërinë e simboleve të Allahut, as të muajve të mëdhenj, as të kurbanit të Qabesë, as të kurbanëve të shënuar me gjerdan, as (mos i pengoni) ata që janë nisur të vizitohen Shtëpinë e Shenjtë, duke kërkuar mirësinë dhe kënaqësinë e Zotit të vet. Pas heqjes së Ihramit, gjuani. Dhe, të mos ju nxisë urrejta ndaj disa njerëzve, që ju penguan të vizitoni Qabënë, pra, kurrsesi të mos ju nxisë që t'i sulmoni! Ndihmoheni njëri-tjetrin në punë të mira dhe në të ruajturit nga të këqijat dhe jo në gjynahe dhe armiqësi! Frikësojuni Allahut, sepse Ai dënon ashpër! (5:2)

E kundërta e *ta'awun*, domethënë, ata që duan të shembin komunitetin njerëzor, është e ndaluar. Profeti ka thënë: “Ndihmo vëllain tënd kur ai është përndjekës dhe kur ai është i përndjekur.” Sahabët, të habitur nga deklarata e tij, e pyetën për sqarim. Ai u përgjigj se ata duhet të ndihmojnë njerëz të tillë duke i parandaluar ata që të mos bëhen pjesë e aktiviteteve të tilla.² Muslimanët që ndihmuan viktimat e Katrinës me ushqim dhe strehim dhe të cilët punojnë me jomuslimanët në këtë dhe në aktivitete të tjera shërbyese janë duke vepruar në përputhje me *ta'awun*. Përfitimet e një sjellje të tillë vijnë nga burime të papritura. Për shembull, komuniteti i muslimanëve të Hjustonit dhe të zonave përreth kanë ushqyer dhe kanë strehuar viktimat e Katrinës, një veprim bamirësie që ishte vlerësuar në mbarë vendin. Prova për këtë erdhi kur një jomusliman dërgoi një donacion në një xhami

për viktimat e tërmetit në Pakistan dhe mesazhin e mëposhtëm të bashkëngjitur: “Ju ndihmuat Katrinën dhe meritoni të ndihmoheni sot në fatkeqësinë tuaj.”

Istabiq al-Khayrat: I përkufizuar fjalë për fjalë si “të shquhen ose të garojnë në vepra të mira, “kjo i referohet mposhtjes së jomuslimanëve në bërjen e veprave të mira. Duke trajtuar çështjen e diversitetit fetar, Allahu u thotë muslimanëve:

Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetin, si përmëshës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t’ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t’ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t’ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti. (5:48)

Dialogu ndërjetar mishëron thirrjen për *Istabiq al-Khayrat* dhe për muslimanët vjen mandati që ata duhet t’ua kalojnë jomuslimanëve në shërbim të njerëzve. Me fjalë të tjera, nëse jomuslimanët zgjasin duart e tyre për bashkëpunim, ndërtimin e paqes, apo çdo lloj të mire dobiprurëse për komunitetin në përgjithësi, Muslimanët duhet të zgjasin duart e tyre edhe më larg. Në të vërtetë, ata duhet të qëndrojnë në vijën e parë dhe të jenë udhëheqës. Suneti, si gjithmonë, përcakton standardin. Kur Muhammedi ishte tridhjetë e pesë vjeç dhe nuk ishte ende profet, Mekasit ishin gati të luftojnë mes tyre lidhur me nderin e vendosjes së Gurit të Zi në vendin e vet të duhur në Qabenë e sapo ri-ndërtuar. Për të shmangur një luftë fisnore, ata vendosën që personi i parë që do të kalojë përmes portës al-ßafa do të jetë ndërmjetësues i tyre. Muhammedi, që ishte i pari që bëri këtë, me shumë mençuri i ndihmoi ata të shmangur një luftë dhe për të arritur një zgjidhje paqësore.³

Ky gjykim paqësor dhe kreativ ilustron mënyrën se si muslimanët mund të përvetësojnë një qasje paqësore për zgjidhjen e problemeve kur trajtojnë problemet e brendshme dhe të jashtme.

SHEMBUJT KURANOR TË PAJTIMIT FETAR DHE BASHKËKZISTENCËS PAQËSORE

Islami i pranon fetë tjera që ishin shpallur para shpalljes së Kuranit. Para dhe pas Islamit, fetë botërore kanë qenë në luftë me njëra-tjetrën; Hebrejët dhe të krishterët refuzuan dhunshëm njëri-tjetrin. Persekutimi i ndërsjellë i tyre është i dokumentuar në shumë libra për historinë hebreje-të krishterë. Kontributi unik i Islamit ndaj civilizimit është pranimi nga ana e tij i prezcencës së feve tjera dhe pranimi nga ana e tij i nevojës për të jetuar në paqe me këto religjione. Al-Faruqi, duke konfirmuar këtë fakt, thotë:

Respekti me të cilin Islami e trajton Judaizmin dhe Krishterimin, themeluesit dhe shkrimet e tyre, nuk është një mirësjellje, por një njohje e të vërtetës fetare. Islami i sheh ata në botë jo si 'pikëpamje të tjera' që ai duhet të tolerojë, por siç qëndrojnë de jure, si fetë e shpallura me të vërtetë nga Zoti. Për më tepër statusi i tyre i ligjshëm nuk është as socio-politik, jo kulturor, as qytetërues, por fetar.⁴

Pohimi për një Zot të mrekullueshëm: Një Zot i tillë, përtej gjinisë, ngjyrës, dhe personifikimit, mundëson krijimin e një komuniteti vërtetë universal. Kurani thekson se të gjithë njerëzit janë fëmijët e Ademit dhe Havës. Të gjithë njerëzit janë mëkëmbës të Zotit në Tokë dhe janë të barabartë me njëri-tjetrin para Tij. Vetë idealet e Islamit, ashtu siç janë të bazuara ato në adhurimin e një Zoti dhe urdhri për të kërkuar unitetin e bazuar në krijimin e tyre të përbashkët nga ana e atij Zoti që është Një dhe i vetëm, largojnë njerëzit nga koncepti i një 'race të zgjedhur 'dhe'pagane'. Kjo i ndihmon ata të shohin veten e tyre si krijime të respektuara në mënyrë të barabartë të Zotit:

O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri-tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshtëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (49:13)

Besëlidhja e parë e njerëzimit me Zotin: Uniteti ynë themelor u shpall në krijimin tonë. Pas krijimit të Ademit dhe Havës, Zoti nxori nga ijët e tyre të gjithë të fëmijët e tyre, nga njeriu i parë deri te i fundit, dhe u bëri thirrje atyre për të dëshmuar:

Dhe sa herë që Zoti yt nxori nga kurrizi i bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri të dëshmojnë kundër vetes së tyre, u tha: 'A nuk jam Unë Zoti juaj?' Ata u përgjigjën: 'Po, dëshmojmë se Ti je.' Kështu bëri Ai, në mënyrë që ju (o njerëz) të mos thoni në Ditën e Kiametit: 'Vërtet, ne këtë nuk e kishim ditur.'(7:172)

Kjo besëlidhje i obligon njerëzit që të njohin Zotin, të njohin njëri-tjetrin si një popull, dhe të ndërtojnë marrëdhënie miqësore të nevojshme për bashkëjetesën paqësore.

Din al-Fi~ rah: Çfarë al-Faruqi quajti religion ose religjio-naturalist është procesi me të cilin njerëzit e njohin Zotin si i mrekullueshëm dhe të shenjtë dhe, prandaj, që meriton të adhurohet. Njerëzit posedojnë këtë koncept të Din al-fi~ rah :

Pra, drejtohu me përkushtim në fenë e pastër [gjithnjë e vërtetë] monoteiste, duke u larguar nga çdo gjë që është e rreme, në pajtim me natyrën fillestare, në të cilën Zoti i ka krijuar njerëzit. S'ka ndryshim të krijimit të Allahut. Ky është [qëllimi] i fesë së drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.(30:30)

Profeti ka thënë lidhur me këtë ajet: "Çdo fëmijë është i lindur me këtë natyrë fillestare. Janë prindërit e njeriut që e bëjnë një njeri të krishterë, hebre apo besimtar të zjarrit."⁵

Din al-Fi~ rah dhe al-Din al-hanif: Koncepti i din al-hanif fokuson Konceptin e din al-fi~ rah. Hanif vlen për të gjithë njerëzit, që i përkushtohen dhe e adhurojnë një Zot të vërtetë të mrekullueshëm. Kurani shpall se Ibrahim i dhe të gjithë profetët Biblik, duke përfshirë Muhamedin, ishin hanifë, të cilët Muhamedi i quajti vëllezër të tij. Kurani i urdhëron njerëzit për idealin e hanifëve duke parashtruar pyetjen:

Dhe kush mund të jetë besimtar më i mirë se ai që i dorëzohet sinqerisht Allahut, duke qenë bamirës dhe zbatues i fesë së pastër të Ibrahimit, i cili u largua nga çdo gjë e rreme duke parë që Zoti e lartësoi atë me dashurinë e Tij?(4:125)

Ibrahimi nuk ka qenë as "hebre", as "i krishterë", por ishte ai i cili u largua nga çdo gjë e rreme, që ishte i nënshtruar ndaj Zotit dhe nuk ishte prej atyre të cilët adhurojnë të tjerët përveç Tij.(3:67)

Islami si vazhdimësi e besimeve të Ibrahimit: Kurani thotë: "Pastaj, Ne të frymëzuam ty [O Muhamed me këtë shpallje]: 'Paso me sinqeritet fenë e Ibrahimit, që nuk ka qenë prej idhujtarëve'".(16:123)

Duke konfirmuar që Islami është vazhdimësi e porosisë Biblike, Kurani thotë:

Në çështjet e fesë, Ai ka urdhëruar për ju atë Fe, të cilën ta zbuloi ty (o Muhamed) dhe që pati urdhëruar për Nuhun, Ibrahimin, Musain dhe Isain, duke thënë: "Qëndroni në fenë e drejtë dhe mos u përçani në të!" Por për idhujtarët është e rëndë ajo, në të cilën po i fton ti. Allahu zgjedh për këtë fe kë të dojë dhe udhëzon drejt saj këdo që kthehet tek Ai me pendim. (42:13)

Umeti: Koncepti i Umetit (komunitetit fetar) mbështet në masë të madhe bashkëveprimin ndërftetar. Së pari, ai paraqet njerëzimin si një familje të vetme fetare të vëllezërve dhe motrave, si fëmijët e Ademit dhe Havës. "Dhe [dije se] gjithë njerëzimi njëherë ishte vetëm një komunitet i vetëm, por u përçanë më vonë. Sikur të mos ishte thënë më parë fjala nga Zoti yt, atëherë do të gjykohej midis tyre, për atë që ata nuk u pajtuan [nga fillimi]". (10:19) Së dyti, Kurani e quan çdo komunitet fetar si një Umet. Zoti dërgoi profetët për të përkujtuar njerëzimin për premtimin fillestar të tij për t'iu bindur Zotit dhe për të jetuar së bashku në paqe. Këta profetë, edhe pse vinin nga pjesë të ndryshme të botës, u sollën njerëzve porosinë e njëjtë. Disa prej tyre iu besuan atyre dhe të tjerët i refuzuan ata:

Dhe vërtet, çdo populli Ne i çuam një të dërguar (që u thoshte): "Adhuroni Allahun dhe shmangni idhujt!" Dhe prej tyre [gjeneratat e kaluara] kishte të tillë që Allahu i shpuri në rrugë të drejtë, sikur që prej tyre kishte [shumë] që e merituan të mbeten në humbje. Andaj, udhëtoni nëpër botë dhe shihni se si ishte fundi i përgënjeshtresve! (16:36)

Ithtarët e Librit : Ky koncept zbulon dhe inkurajon zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të posaçme dhe të afërta në mes të muslimanëve, hebrenjëve dhe të krishterëve. Kurani përdor Ehlil Kitab (Ithtarët e Librit) në mënyrë specifike për hebrenjët dhe të krishterët. Qëllimi është për të përkujtuar jo vetëm hebrenjët dhe të krishterët, por edhe muslimanët, që trashëgimia e tyre fetare është e përbashkët dhe se rrënjët e tyre fetare janë të ngjashme. Kurani i drejtohet Profetit Muhamed:

Thuaj: "O ithtarët e shpalljes së mëparshme, ejani të biem në një fjalë të përbashkët mes nesh dhe jush: se do të adhurojmë vetëm Allahun, dhe se nuk do t'i shoqërojmë Atij asgjë (në adhurim) dhe se nuk do të marrim për zot njëri-tjetrin, në vend të Allahut!" Nëse ata nuk pranojnë, atëherë thuaju: "Dëshmoni se ne i jemi nënshtruar Allahut!"(3:64)

Trashëgimia e përbashkët këtu është koncepti i Një Zoti të mrekullueshëm dhe i obligimit për t'iu bindur disa rregullave të vendosura prej Tij.

Për t'u pajtuar për të ndërtuar marrëdhënie të mira me të krishterët dhe hebrenjët, Kurani i lejoi muslimanët të hanë ushqimin e tyre dhe i inkurajoi hebrenjët dhe të krishterët të hanë ushqimin e muslimanëve (5:5). Sot, shumë muslimanë ende hanë ushqim të pastër. Shpresa këtu është se një këmbim i tillë do të rezultojë me marrëdhënie miqësore, shkëmbime paqësore të ideve, dhe mirëkuptim të ndërsjellë. Kjo shpresë gjithashtu mbështetet në traditën historike të Lindjes së Mesme për të respektuar ata që hanë ushqimin tuaj dhe për t'i mbrojtur ata nëse kërkohet.

Kurani u tha burrave muslimanë mos të martohen me gra që adhurojnë idhujt dhe i inkurajoi ata që të martohen me gra të devotshme të Ithtarëve të Librit (5:5).

Martesa në Arabi ishte një shenjë e lidhjes, ndërtimit të aleancave dhe bashkëpunimit. Profeti Muhamed u martua me gra nga fise të ndryshme, si dhe me gra hebreje dhe të krishtera, për të ndërtuar një rrjet të mbështetjes dhe mbrojtjes.

Al-Ummah al-Uasa~ah: Kjo frazë, e definuar si një "komunitet i shquari rrugës së mesme," e vendos Islamin në pozitën e një

feje të pastruar dhe komunitetin muslimanë si modelin e adhurimit të pastër monoteist. Një komunitet i tillë i nderon besimet e tjera, pa kompromentuar të qenit unik dhe vërtetësinë e Islamit.

“Rruga e mesme” nënkupton një dallim në mes të këtyre feve dallimet e të cilave janë dhënë nga Zoti dhe për këtë arsye duhet të respektohen, dhe ato fe dallimet e të cilave pasqyrojnë largim nga monoteizmi i pastër dhe për këtë arsye janë subjekt i kritikave. Kujtojmë se Kurani së pari theksoi konceptet e njëshmërisë së Zotit dhe se të gjithë njerëzit ishin të barabartë para tij. Së dyti, ai deklaroi se të gjithë profetët mësuuan Njëshmërinë e Zotit dhe, së treti, shpjegon se si komunitetet fetare para Muhamedit shtrembëruan mësimin e vërtetë të monoteizmit të pastër (tahrif).

Për një kohë, Kurani pranoi Tevratin dhe Ungjijtë si shpallje të vërteta ndërsa njëkohësisht akuzonte komunitetet hebreike dhe të krishtera për, në një kohë të caktuar në të kaluarën, pengimin apo shtrembërimin e shpalljes së Zotit. Është në këtë kontekst që Kurani bëhet teksti i pastruar që rikthen konceptin profetik të monoteizmit të pastër. Në këtë kuptim, Islami bëhet rruga e vërtetë apo e pastruar dhe komuniteti musliman bëhet model i Umetit e të besuarit në një monoteizëm të pastër.

PËRDORIMI I KURANIT PËR TË ADRESUAR ÇËSHTJE SFIDUESE

Nuk mund të përsëritet shumë shpesh se dialogu ndërftetar nuk ka të bëjë me komprometimin e besimeve fetare të pjesëmarrësve, por për të kuptuarit dhe respektimin e besimeve të njëri-tjetrit përmes edukimit. Prandaj, kjo nuk kërkon krijimin e një sistemi të unifikuar të besimit, por më tepër për të pranuar besimet e ndryshme dhe për të krijuar një atmosferë miqësore të bashkëjetesës paqësore. Megjithatë, një atmosferë e tillë nuk mund të sigurohet gjithmonë. Ndonjëherë pjesëmarrësit muslimanë duhet të punojnë shumë në fazat e hershme të dialogut për të sqaruar gjuhën Kuranore për të cilën jo-muslimanët shpe-

sh kanë keqkuptime serioze. Në vijim paraqesim disa nga këto terma të keqkuptuara dhe disa sqarime.

KUFR

Kurani e përdor këtë fjalë, që zakonisht përkthehet si mosbesim, për të nënkuptuar gjëra të ndryshme. Kuptimi i saj themelor është të qenit mosmirënjohës, fshehja ose mbulimi i të vërtetës, mospranimi i të vërtetës dhe mosbesimi në Zot. Mund të nxirren edhe kuptime të tjera. Kuptimi i parë është i qartë në ajetin vijues:

Ai që ishte i pajisur me dijen e Librit, tha: "Unë do të ta sjell ty sa çel e mbyll sytë". Kur e pa të vendosur para tij, tha: "Kjo është nga dhuntitë e Zotit tim, për të më provuar a jam mirënjohës apo mohues. Kush falënderon, e bën për të mirën e vet e, kush mohon, (ta dijë se) Zoti im është i Vetëmjaftueshëm dhe Dhurues". (27:40)

Këtu fjala *kufir* është përdorur si e kundërta e fjalës *shukr* (mirënjohës). Kuptimi i fjalës *kufir* varet nga konteksti historik i përdorimit të saj. Vini re, për shembull, se në ajetin vijues ajo është përdorur për të përshkruar një situatë të veçantë, kur Allahu kërkon nga hebrenjtë që të besojnë në Kuran:

Besoni në atë që kam zbritur [tani] si vërtetues të Shkrimeve tuaja, e mos u bëni mohuesit e parë të tij; dhe mos i këmbeni shpalljet e Mia me një vlerë të vogël dhe ruhuni vetëm prej Meje! (2:41)

Këtu, *kafir* (një derivat i fjalës *kufir*) është përdorur për të paralajmëruar hebrenjtë të caktuar. Kjo nuk nënkupton që hebrenjtë në përgjithësi nuk besojnë Zotin, por vetëm hebrenjtë të caktuar të cilët nuk e pranonin Muhamedin dhe Kuranin në atëkohë. Kjo është gjithashtu e vërtetë edhe për ajete të tjera në të cilat fjala *kufir* është përdorur për t'iu referuar hebrenjëve dhe të krishterëve (p.sh., 2:41 dhe në ato ajete që përmbajnë një tjetër derivat: *kafara*). Ky interpretim nuk nënkupton që hebrenjtë dhe të krishterët nuk besojnë në Zot. Kurani e bën të qartë se Zoti i hebrenjëve, të krishterëve dhe muslimanëve është Një

dhe i njëjti Zot (29:46). Diku tjetër, Kurani thotë: Ndërsa atyre që besojnë, kryejnë vepra të mira dhe besojnë në atë që i është shpallur Muhamedit - dhe e cila është evërteta prej Zotit të tyre [do të arrijnë mëshirën e Zotit] - Ai do t'ua fshijë gjynahet dhe do t'ua përmirësojë gjendjen. (47:2)

Hebrenjët dhe të Krishterët nuk janë të pafe. Megjithatë, Kurani kërkon që ata të besojnë në Muhamedin dhe në Kuran, me besimin e tyre në profetët biblik dhe në shkrimet e shenjta që u ishin shpallur atyre. Për më tepër, Kurani i'u kërkon të krishterëve të braktisin konceptin e tyre të Trinisë dhe të miratojnë konceptin e vërtetë të Njëshmërisë së Zotit. Kurani përdor *kafara* (mbulim, fshehje e të vërtetës apo kryerje të një veprë të mosbesimit) për thirrjen e Jezuit të birin e Zotit apo për thënien që Allahu është një nga tre. Kurani kërkon prej të krishterëve që të hedhin poshtë këto koncepte të rreme. (5:72-73) ⁶

Kur al-Faruqi ishte pyetur nëse hebrenjët dhe të krishterët duhet të quhen të pafe, ai u përgjigj se kjo fjalë vlen vetëm për ata që fare nuk e njohin Zotin. Prandaj, ai tha, kushdo që beson në Zot, por nuk është musliman nuk mund të konsiderohet i pafe. Al-Faruqi më tej tha se asnjë hebre ose i krishterë nuk mund të quhet a priori i pafe. Megjithatë, në qoftë se ai ose ajo e mohon Zotin apo njëshmërinë dhe përsosmërinë e Tij, ai ose ajo mund të quhet i pafe.⁷

Diskutimet lidhur me pyetje të tilla mund – dhe duhet – të jenë paqësore. Për shembull, në një dialog të kohëve të fundit të titulluar: “Të krishterët dhe muslimanët për Trininë në Krishterim dhe Përsosmërinë dhe Njëshmërinë e Zotit në Islam,” dy folësit me ndershmëri i shpjeguan besimet e tyre një audience prej 150 muslimanëve dhe të krishterëve, duke përfshirë priftërinj dhe imamë. Më pas, u bënë shumë pyetje të menduara mirë, me frymë kërkuese. Në fund, publiku shprehu vlerësimin e tij për ndershmërinë dhe qartësinë e folësve.

I dërguari i Kuranit Muhamed Asad përmban një diskutim të mirë për kufr dhe derivatet e saj në lidhje me ajetet 2:6 dhe 74:10. Ai përkthen fjalën kafir si fjalë që përgjithësisht ka kuptimin e “mohimit të të vërtetës,” me përjashtim të ajetit 57:20, ku

kjo fjalë është përdorur për bujqit që mbulojnë farat. Ai mendon se përkthimi i zakonshëm i fjalës kuffarsi mosbesimtarë dhe në veçanti si të pafe është i përshtatshëm në përgjithësi. Fjalakafir (dhe fjalët që lidhen me të, siç është emri abstrakt kufr “mosbesim”) siç përmendet në Kuran mund të vihen së bashku në 14 kategori tëndryshme:

1. *Kufr al-Tauhid*: refuzim i besimit në Njëshmërinë e Zotit. Kurani thotë: “Sa për ata që mohojnë, njësoj është, i paralajmërove apo nuk i paralajmërove – ata nuk besojnë.” (2:6)
2. *Kufr al-Ni'mah*: të qenit mosmirënjohës ndaj Zotit ose njerëzve. Kurani thotë: “Prandaj, më kujtoni Mua (me namaz e lutje) që Unë t’ju kujtoj (me shpërblime) dhe falënderomëni Mua (duke M’ubindur)(la takfurin) dhe mos i mohoni dhuntitë e Mia (me mosbindje)!(2:152) [Faraoni i tha Musait]”Vallë, a nuk të kemi rritur në gjirin tonë si fëmijë?! A nuk ke qëndruar midis nesh shumë vjet të jetës sate?! E pastaj bëre veprën që ti e di, duke qenë mosmirënjohës?! (kafirin)”(26:19)
3. *Kufr al-Tabarri*: mohim/pastrim i vetes. Kurani thotë: “Vërtet, shembull i mrekullueshëm për ju është Ibrahim i dhe ata që kanë qenë me të, kur i thanë popullit të vet [idhujtar]: ‘Me të vërtetë, ne shkëputemi nga ju (kafarna bikum) dhe nga ato që ju i adhuronin në vend të Allahut’...” (60:4)
4. *Kufr al-Tagh~iyah*: të fshihet/fus diçka në dhe, sikur mbjellja e farës në dhe. Kurani thotë: “Ajo i shëmbëllen bimës, e cila pas shiut [jetëdhënës] rritet dhe i gëzon bujqit (kuffar).” (57:20)
5. *Kufr al-Inad*: Mosbesim nga kryeneçësia. Kjo vlen për atë - që e di të vërtetën dhe pranon që ka njohuri për të vërtetën, por nuk pranon ta pranojë atë dhe përmbahet nga deklarimi. Kurani thotë: [Do t’u thuhet:] “Hidhni në zjarr çdo njeri jobesimtar, kryeneç.” (50:24)
6. *Kufr al-Inkar*: Mosbesim si rezultat i mohimit. Kjo vlen për dikë që mohon si me zemër ashtu edhe me gjuhë.

- Kurani shpall: “Ata [të cilët largohen prej saj] i dinë dhuntitë e Allahut, por pastaj i mohojnë ato, se shumica e tyre janë mohues të të vërtetës.” (16:83)
7. *Kufr al-Kibr*: Mosbesim nga arroganca dhe krenaria. Mosbesimi i shprehur nga ana e djallit (iblisit) është një shembull i këtij lloji të kufrit.
 8. *Kufr al-Juhid*: Mosbesim nga refuzimi. Kjo vlen për dikë që pranon të vërtetën në zemrën e tij, por e refuzon atë me gjuhën e tij. Ky lloj kufri vlen për ata të cilët e quajnë veten e tyre muslimanë por të cilët refuzojnë çdo normë të nevojshme dhe të pranuar të Islam, siç është namazi dhe zekati. Kurani shpall: “[Dhe] në ligësinë dhe vetë-ekzaltimin e tyre, ata i mohuan ato padrejtësisht dhe me mendjemadhësi, edhe pse shpirti i tyre i besonte për të vërteta. Pa shiko, cili ka qenë fundi i shkatërrimtarëve!” (27:14)
 9. *Kufr al-Nifaq*: Mosbesim nga hipokrizia. Kjo vlen për atë që shtiret të jetë besimtar, por fsheh mosbesimin e tij. Personi i tillëquhet munafik (hipokrit). Kurani thotë: “Pa dyshim që hipokritët do të jenë në thellësinë më të madhe të Xhehenemit dhe ti kurrësi nuk do t’u gjesht atyre ndihmës.” (4:145)
 10. *Kufr al-Istihlal*: Mosbesim për shkak të përpjekjes për të bërë haramin hallall. Kjo vlen për atë që pranon si të lejuar (hallall) atë të cilën Allahu e ka bërë të paligjshme (haram) si alkoolin apotradhtinë bashkëshortore. Vetëm Allahu ka të drejtë t’i bëjë gjërat hallall dhe haram dhe ata që kërkojnë të ndërhyjnë në të drejtën e Tij janë sikur rivalë të Tij dhe për këtë arsye dalin jashtë kufijve të besimit.
 11. *Kufr al-Kurh*: Mosbesim nga urrejtja e urdhrave të Allahut. Kurani thotë: “Ndërsa ata që nuk besojnë, do të shkatërrohen! Ai do t’ua humbë të gjitha veprat e tyre [të mira]. Kjo për shkak se ata e urrejnë [edhe vetë mendimin për] atë që ka shpallur Allahu, andaj Ai i ka zhvlerësuar veprat e tyre.” (47:8-9)

12. *Kufr al-Istihza'*: Mosbesimi për shkak të talljes dhe përqeshjes. Kurani shpall: "E megjithatë, nëse i pyet, ata do të të përgjigjen: "Ne vetëm po bënim shaka dhe po luanim [me fjalë]. Thuaj: 'A mos vallë me Allahun, shpalljet dhe të Dërguarin e Tij po talleni?' Mos u shfajësoni! Ju në të vërtetë e keni mohuar të vërtetën pasi patët besuar (9:6-66)
13. *Kufr al-I'ra*: Mosbesim për shkak të shmangies. Kjo vlen për ata që u larguan dhe iu shmangën të vërtetës. Kurani thotë: "Kush është më i padrejtë se ai që, kur ia kujtojnë shpalljet e Zotit të vet, largohet nga ato dhe harron se çfarë kanë bërë duart e tij më parë?! Ne kemi vënë perde në zemrat e tyre, që të mos e kuptojnë atë (Kuranin), dhe ua kemi rënduar veshët. Edhe sikur ti t'i thërrasësh ata në rrugën e drejtë, ata kurrë nuk do të udhëzohen.(18:57)
14. *Kufr al-Istibdal*: Mosbesim për shkak të përpjekjes për të zëvendësuar Ligjet e Allahut. Kjo mund të marrë formën e: (a) refuzimit të ligjit të Allahut (Sheriatit) pa e mohuar atë, (b) mohimit të ligjit të Allahut dhe për këtë arsye refuzimin e tij, ose (c) zëvendësimin e ligjeve të Allahut me ligje 'artificiale' (d.m.th. jomuslimane). Kurani thotë: "Sikur të donte Allahu, do t'i kishte bërë të gjithë të një besimi të vetëm, por Ai pranon në mëshirën e Vet kë të dojë [të pranohet], kurse mohuesit nuk kanë as mbrojtës, as ndihmës [në Ditën e Gjykimit]". (42:8) Kurani thotë gjithashtu: "Vërtet, Allahu është me ata që e kanë frikë dhe që janë punëmirë!" (16:128)

Fjala *kufir* gjithashtu mund të vlej për një musliman kur ai është duke bërë diçka të gabuar, por jo domosdoshmërisht diçka që do të vendoste atë jashtë gjendjes së besimit në Islam. Për shembull, një musliman i cili është në gjendje të kryejë haxhin por nuk shkon në haxh, pa mohuar nevojën për të shkuar, do të kryente një akt të kufirit në kuptim të mosmirënjohjes ndaj Zotit:

Me të vërtetë, Faltorja e parë e ngritur për njerëzit, është ajo në Bekë (Mekë), e bekuar dhe udhërrëfyese për popujt. Në të ka shenja

të qarta (që janë): vendi i Ibrahimit (mekami Ibrahim); (fakti që) kush hyn në të është i sigurt; dhe vizita (për haxh) e kësaj Faltoreje (e cila është detyrë) për këdo që ka mundësi ta përballojë rrugën. E kush nuk beson, Allahu nuk ka nevojë për askënd.(3:96-97) ⁸

Në realitet, Kurani dallon me kujdes besnikërinë e njerëzve ndaj Zotit dhe mund të bëjmë një ndarje të njerëzve në pesë kategori fetare, si vijon:

1. *Al-Muslimin*: ata të cilët besojnë në Një Zot, në të gjithë profetët biblik, Muhamedin si vulën e profetëve, të gjitha shpalljet, Kuranin si shpalljen e fundit të Zotit për njerëzimin, dhe në Ditën e Gjykimit (2:2-5).
2. *Al-Mulhidin*: Ata që nuk e besojnë Zotin, ata të cilët nuk e pranojnë ekzistencën e tij. Kurani përdor fjalën Mulhid për njerëzit e tillë që refuzojnë emrin e Tij. Për shembull, Kurani thotë: “Allahut i përkasin emrat më të bukur, andaj thirreni Atë (lutjuni Atij) me to dhe largohuni nga ata që i shtrembërojnë emrat e Tij (Yulhidin). Ata do të ndëshkohen për çfarë kanë vepruar. (7:180)
3. *Al-Munafikin*: Hipokritët, “Ka disa njerëz që thonë: ‘Ne besojmë në Allahun dhe në Ditën e Gjykimit, por [në të vërtetë]ata nuk besojnë...”(2:8-18). Kur Muhamedi dhe pasuesit e tij u shpërngulën në Medine, personat e tillë vetëm u shtirën të jenë muslimanë. Kurani bën fjalë për ta gati në të gjitha suret (kapitujt) e shpallur në Medine.
4. *Al-Mushrikin*: Ata që i shoqërojnë njerëz dhe gjëra të tjera Zotit, ata që i adhurojnë idhujt. Në lidhje me idhujtarinë e tyre, Kurani thotë: “Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm. (4:48,116)
5. *Ehlil Kitab*: Ithtarët e Librit, domethënë, hebrejët dhe të krishterët,ata të cilët besojnë në Zot, por nuk e besojnë Muhamedin dhe Kuranin (2:105; 3:64). Kjo frazë është shumë e zakonshme në Kuran. Fjala Kufr mund të përdoret në një kuptim apo tjetër për të gjithë njerëzitduke përfshirë muslimanët në dritën e këtyre kategorive.

VALI

Jomuslimanët shpesh pyesin muslimanët përse Kurani duket armiqësor ndaj tyre. “Përse”, ata pyesin, “a i paralajmëron ai muslimanët të mos i marrin hebrenjët dhe të krishterët si miq të tyre?” Megjithatë, ky paralajmërim i supozuar është i bazuar në një ide e gabuar: ai është nxjerrë nga disa përkthime ku *vali* është përkthyer si “mik”, pa ndonjë shpjegim të kompleksitetit të vërtetë të tij. Kur njerëzit të cilët nuk e njohin gjuhën arabe lexojnë përkthimin, ata kuptojnë që kuptimi ‘mik’ është kuptimi i vetëm dhe, nga ky supozimi i gabuar, pretendojnë se Kurani i ndalon muslimanët të shoqërohen me të krishterët dhe hebrenjët.

Në të vërtetë, *vali* do të thotë kujdestar, mbrojtës dhe furnizues. Zoti është *vali* i besimtarëve (kujdestar); për ata që i binden Shejtanit, Shejtani është kujdestari i tyre. Ky përdorim ndodh shpesh në Kuran: “All-llahu është mbrojtës i atyre që kanë besim. Nga thellësitë e errësirës Ai do t’i çojë përpara në dritë. Nga ata që nuk besuan, mbrojtësit e tyre janë të ligë (~aghit). Nga drita ata do t’i çojnë drejt thellësive të errësirës.” (2: 257) Madje edhe në kontekst të marrëdhënieve njerëzore, *vali*

i referohet një raporti të përkujdesjes dhe mbrojtjes, posaçërisht në situata kur është thelbësore të bëhet dallimi në mes të përkrahësve të vërtetë dhe të rremë të njeriut. Merrni parasysh ajetin në vijim:

“O besimtarë! Mos i pranoni për mbrojtës baballarët dhe vëllezërit tuaj, nëse ata e duan mosbesimin më shumë se sa besimin. Kushdo prej jush që i merr ata për mbrojtës, është keqbërës. (9:23)

Ky ajet i referohet betejës së Bedrit, kur Mekasit sulmuan muslimanët në periferi të Medinës. Vëllai u ngrit kundër vëllait, dhe babai kundër djalit. Në këtë kontekst Kurani kërkoi solidaritetin musliman, ashtu që ata të mos tradhtonin shokët e tyre muslimanë, kur u përballën me luftën kundër të afërmeve të tyre. Sipas mendimit të sotëm politik, një tradhti e tillë do të konsiderohej tradhti dhe do të mund të dënohej me vdekje ose burgim të përjetshëm. Shtetet moderne kërkojnë besnikëri ndaj shtetit

mbi të gjitha besnikëritë personale. Megjithatë, në situata që nuk bien ndesh me besnikërinë ndaj besimtarëve të tjerë, Kura-ni urdhëron respekt për besnikëritë personale, sidomos ato që u detyrohen prindërve:

Dhe [Zoti thotë:] “Ne e kemi urdhëruar njeriun që t’i nderojë prindërit e vet. Nena e ka mbartur atë, duke duruar mundim pas mundimi, e ndarja e tij (nga gjiri) është brenda dy vitesh. Ne i thamë atij: “Bëhu falënderues ndaj Meje dhe prindërve të tu [dhe kujtoni se] tek Unë do të ktheheni të gjithë. [Nderoni prindërit Tuaj;] megjithatë, nëse ata orvaten, që të më shoqërosh Mua (në adhurim) diçka, për të cilën ti nuk ke dijeni, mos i dëgjo, por sillu mirë me ata në këtë jetë dhe ndiq rrugën e atij që drejtohet tek Unë me devotshmëri; pastaj, tek Unë do të ktheheni dhe Unë do t’ju lajmëroj për atë që keni bërë. (31:14-15)

Tani vijmë tek ajeti që duket që thotë se muslimanët nuk duhet të bëjnë miq hebrenjët dhe të krishterët. “O besimtarë! Mos i bëni miq e mbrojtës hebrenjët dhe të krishterët...” (5:51)

Ky përkthim është tipik në përdorimin e tij të fjalës “miq” për evlia ‘, shumësit të fjalës vali. Megjithatë, ne e dimë se fjala evlia’ do të thotë mbrojtës dhe padron. Pra, çfarë është duke thënë ky ajet në të vërtetë? Njeriu duhet të kuptojë “arsyen e shpalljes” ose kontekstin historik për të kuptuar përdorimin e fjalësevliat këtu. Ky ajet i referohet një situatë të veçantë: një nga fiset hebreje të Medinës e tradhtoi komunitetin musliman, i cili ishte duke luftuar për jetë a vdekje kundër paganëve mekas. I njohur si Beteja e hendekut, si dhe Aleanca e Fiseve Mekase, ajo përbëhej nga ngjarja në vijim. Fisi i Beni Kurejsh ishte zotuar, si në një traktat ashtu dhe në kushtetutën e Medinës, për të ndihmuar komunitetin musliman për të luftuar kundër armiqve të tij. Në vend të kësaj, ata u bashkuan fshehurazi me mekasit gjatë luftës. Pas përfundimit të betejës, Profeti thirri shira (një takim të parlamentit në kuptimin modern) për të vendosur se çfarë të bëjë në lidhje me këtë akt të tradhtisë. Por tradhtia ushqen tradhti, sepse hipokritët mbështetën Beni Kurejshët. Ky ajet i diskutueshëm i cituar më lart ishte shpallur në mes të këtij vargu të tradhtive.⁹

Ajetet e tilla nuk ndalojnë marrëdhëniet politike, ekonomike, dhe shoqërore me jomuslimanët. Në këtë, si në çdo gjë, vetë Profeti jep shembullin më të mirë. Ai i ka besuar 'Abd Aliah ibn al-'Urayqi ~, një jomuslimani, si udhërrëfyes gjatë migrimit të tij (Hixhretit) nga Meka në Medine, edhe pse Mekasit kishin ofruar një shpërblim të madh për zënien rob të tij.¹⁰ Në një rast tjetër, Profeti zgjodhi ibn Abihadrad, një jomusliman, për të spiunuar për ushtrinë Thaqafi – një mision shumë i ndjeshëm në një situatë kritike.¹¹

Shembuj të tjerë të pranimit të tij të mbrojtjes së ofruar nga jomuslimanët janë me bollëk. Ndoshta më i famshmi prej tyre është jeta e tij nën mbrojtjen e Abi Talib (xhaxhait të tij jomusliman) deri në vdekjen e këtij të fundit.

Gjatë misionit të Muhamedit në Taif, ai u plagos dhe u kthye në Mekë me ndihmën e jomuslimanit Ma~'am ibn 'Adi dhe bijve të tij. Profeti ishte aq mirënjohës sa që ai tha, pas Bedrit, se nëse Ma~'am ishte gjallë dhe do t'i kërkonte atij që të lironte të burgosurit, ai do ta bënte këtë.¹² Përveç kësaj, ai nënshkroi një marrëveshje të bashkëpunimit me fiset hebreje të Medinës shpejt pas migrimit të tij, lidhi traktatin e hudaybiyyah me paganët mekas dhe pranoi një aleancë me fisin jomusliman Beni Khuza'ah. Në fakt, ky fis mori pjesë në pushtimin e Mekës.¹³

Por marrëdhëniet e mira me jomuslimanët nuk u formuan thjesht për hir të dobisë; por më shumë, duke vepruar kështu me të gjithë njerëzit, në veçanti me hebrejët dhe të krishterët, inkurajohet fuqimisht nga Islami si një praktikë universale. Jusuf al-Kardavi citon shembuj nga *sirah* e Profetit dhe shokëve të tij se si të trajtojnë fqinjët jomusliman dhe njerëzit në përgjithësi. Disa shembuj janë:¹⁴

- Profeti dërgoi dhurata që ato t'u shpërndahen mekasve të varfër përkundër armiqësisë së tyre, u dërgoi dhurata mbretërve dhe pranoi dhurata prej tyre dhe caktoi një lëmoshë vjetore për një familje hebreje në Medine.
- Kur një dele u ther në shtëpinë e një Shoku, ai i dërgoi një pjesë të mishit fqinjit të tij hebre.
- Kur një grua e krishterë e quajtur Umm al-harith ibn Rebi'ah, disa prej Sahabëve morën pjesë në varrimin e saj.

- Duke ndjekur rrugën e Profetit, ‘Umar ibn al-Kha ~~ab i dërgoi një vëllait të tij jo-musliman një copë rrobe si dhuratë.
- Profeti huazoi para nga jomuslimanët.¹⁵
- Ai respektoi jomuslimanët, të gjallë apo të vdekur. Një herë, kur një procesion funeral po kalonte, ai u ngrit në këmbë në shenjë respekti. Shokët e tij i thanë atij se ishte funerali i një hebrej. Profeti pyeti: “A nuk është ai shpirt njeriu?”¹⁶

Kuptimi i këtyre shembujve është se Kurani, hadithet, dhe Suneti theksojnë respektin e Islamit për të drejtat e njerëzve dhe humanizmit të tyre. Të gjithë, nga një shok e deri te një udhëtar, ka të drejtë të respektohen, të trajtohen në mënyrë të drejtë, dhe të mbrohen nga dëmi dhe keqtrajtimi (4:36).

A DO TË HYJNË TË KRISHTERËT DHE HEBRENJËT NË PARAJSË SIPAS ISLAMIT?

Një tjetër temë e ndjeshme është nëse muslimanët besojnë se hebrejët dhe të krishterët do të përfundojnë në ferr në mënyrë të pashmangshme. Për shembull, në një dialog publik të kohëve të fundit ne mes të krishterëve dhe muslimanëve, pyetja e parë ishte se si është e mundur që të krishterët të bëjnë dialog me muslimanët duke qenë se muslimanët besojnë se të krishterët janë të dënuar. Në përgjigje të kësaj pyetje, folësi musliman pyeti personin e krishterë që bëri pyetjen se çfarë besonte në lidhje me gjasat e muslimanëve për t’iu shmangur ferrit dhe e pyeti: “A nuk besojnë të krishterët se rruga për në parajsë shkon vetëm nëpërmjet Jezuit? Ne nuk jemi këtu për të dërguar njerëzit në parajsë ose në ferr, por për të gjetur mënyra për të ndërtuar marrëdhënie të mira me njëri-tjetrin dhe për të paraqitur shkakun e vuajtjes së njerëzimit.”

Megjithatë kjo çështje është një çështje vendimtare në dialogun ndërftetar. Çdo fe beson se Zoti i tyre, do t’i fus ata në parajsë

përpara të tjerëve. Hebrenjët dhe të krishterët gjithashtu besojnë në këtë. Asnjë fe nuk është e gatshme të ndajë të njëjtin vend në parajsë me një tjetër. Gjatë një sesioni ndërfeetar në Qendrën Islame të Roçesterit, një musliman dhe një folës katolik përcaktuan kuptimet përkatëse të feve të tyre për parajsën dhe ferrin. Në sesionin e pyetjeve dhe përgjigjeve, dikush e pyeti folësin katolik nëse ai besonte se jo-katolikët do të shkojnë në parajsë. Në përgjigje të kësaj, folësi rrëfeu një histori me humor nga tradita e tij duke thënë se katolikët kishin mbushur tashmë hapësirat bosh në parajsë para se të tjerët, duke përfshirë muslimanët dhe të krishterët jo-katolikë, të kishin mbërritur madje te porta e saj! Që do të thotë se Katolicizmi kishte pasur përparësi në kohë ndaj të tjerëve. Shakaja e folësit ndihmoi në krijimin e një atmosfere të relaksuar, sepse ajo sugjeroi se askush prej nesh nuk duhet të luftojë për shkak të një çështje për të cilën “Vetëm Zoti e di më së miri.”

Megjithatë, në të njëjtën kohë, ndjenja e çdo feje për ekskluzivitet për sa i përket të kuptuarit e saj për parajsën dhe ferrin u jep besimtarëve energjinë dhe motivimin për të bërë më të mirën e tyre brenda sistemit të tyre të besimit. Kjo rezulton në atë që Kurani e quan vendim të Zotit “për t’ju provuar [dhe kështu për të treguar] se kush prej jush do të veprojë më mirë” (67:2). Ky besim i ngjan konceptit të nacionalizmit, por pa dhunën e tij, sepse ashtu si çdo komb-shtet që shpall veten superior ndaj të gjithë të tjerëve, secila fe kërkon të mposht të tjerët në të konvertuarit dhe të bëhet dominuese, jo vetëm në Tokë, por edhe në parajsë. Megjithatë, koncepti Kuranor i Istabiq i al-Khayr a t (dallohu dhe garo në bamirësi) zbulon se kjo garë duhet të jetë në fushën e bërjes së veprave të paqes, jo të luftës. Kështu, ndonëse nuk ka asgjë të gabuar me këtë frymë garuese, gjëja më e rëndësishme është gjetja e mënyrave për të jetuar në paqe me të tjerët. Nuk është se kush fiton apo humbet, por se si luhet kjo lojë. Islami i udhëzon besimtarët e tij që të përvetësojnë adab, dhembshuri dhe respekt ndaj të gjithë atyre fetë e të cilëve u kanë thënë atyre gjithashtu që të përpiqen për të bërë mirë.

Dialogu ndërfeetar nuk kërkon të dërgojë të gjithë njerëzit në parajsë; në vend të kësaj, preokupimi i tij qëndron në inkurajimin

e tyre për të shmangur dhunën dhe urrejtjen dhe për të kultivuar paqen dhe solidaritetin mes tyre. Dialogu ndërftetar thotë se pretendimet pozitive të pohuara nga çdo fe duhet bërë haptazi dhe pa mbështetje në krahasime të papëlqyeshme. Konsideroni dallimin në mes të dy qasjeve të mëposhtme. Nga njëra anë, një imam përmendi gjatë hutbes së tij të Xhumasë që hebrenjtë dhe të krishterët janë duke shkuar drejt ferrit nëse ata nuk e pranojnë Islamin. Në anën tjetër, një tjetër imam tha se Islami është rruga e zgjedhur e Allahut dhe se ata që besojnë në Të, në engjëjt, profetët biblik, Profetin Muhamed si vulën e profetëve, të gjitha shkrimet e shenjta duke përfshirë edhe Kuranin, Botën tjetër, në Ringjallje , dhe në Ditën e Gjykimit - Ai, me mëshirën e Tij, do t'i bekojë njerëzit e tillë në parajsë. Dallimi në qasje në mes të këtyre dy imamëve duhet të jetë i qartë. Cili nga këta imamë përfaqëson më sinqerisht frymën e dialogu ndërftetar?

Muslimanët me siguri do të kundërshtonin dhe nuk do të pranoinin ata që thonë se muslimanët duke shkuar drejt ferrit apo se Islami është një fe e keqe; anasjelltas, muslimanët duhet të shmangen nga thënia se hebrenjtë, të krishterët, hindusët, budistët, apo të tjerët do të përfundojë në ferr. Allahu ka njerëz të talentuar me intelekt; ata e kuptojnë se çfarë nënkupton thënia se Zoti do të shpërblejë muslimanët. Kritikat e drejtpërdrejta të praktikave dhe besimeve tjera fetare nuk janë të shëndosha në çdo mjedis, veçanërisht në një kontekst dialogu dhe lehtë mund të përshkallëzohen në armiqësi të mëtejshme dhe madje edhe në urrejtje. Mendoni se çfarë ka ndodhur në një dialog të kohëve të fundit kur një imam paraqiti qëndrimin e muslimanëve për jetën e pëртеjme në mënyrë të qartë, siç përshkruhet më sipër. Në fund, një musliman ngriti zërin e tij për të thënë se ndërsa imami i kishte folur siç duhet, ai e kishte lënë pas dore t'iu tregojë jomuslimanëve se ata të gjithë ishin duke shkuar drejt ferrit, përveç nëse e pranojnë Islamin menjëherë. Kjo mënyrë e shprehjes dhe kjo qasje krijon një atmosferë armiqësore dhe duhet të shmanget.

Megjithatë, muslimanët janë të ndarë përsa u përket kriteve për të gjykuar nëse një person do të shkojë në parajsë ose në ferr. Disa pohojnë se kriteret për hyrjen në parajsë janë mjaft

përfshirëse, ngase përbëhen nga besimi në një Zot dhe në Ditën e Gjykimit, bërjen e veprave të mira, dhe besimin në profetët dhe në shkrimet e shenjta që ishin dërguar për të udhëzuar njerëzit drejt këtij qëllimi. Veprat autoritative që mbështetin këtë pikëpamje të gjerë përfshijnë Tafsir Tarjuman al-Kuran të Abul Kalam Azad, Al-Manar të Rashid Rida, Al-Mizan fi al-Tafsir el-Kuran të Muhamed Hassan al-Tabataba'i, si edhe disa shkrime të ndikuar nga autorë sufist. Në Temat Kryesore të Kuranit, Fazlur Rahman shpjegon për këtë të kuptuar të kritereve për hyrjen në parajsë në Shtojcën II.¹⁷ Në librin e tij Kurani: Çlirimi dhe Pluralizmi,¹⁸ Farid Esack zhvillon tezën e Rahmanit, duke bazuar përfundimet e tij në një studim të hollësishëm të qasjes së Kuranit ndaj besimeve të tjera.

Por shumica e tafasir (komentim i Kuranit), si nëperiudhën klasike ashtu edhe atë moderne argumentojnë për kritere më ekskluzive. Ndërsa radhitin besimin në Zot, Ditën e Gjykimit, veprat e mira, të gjithë profetët dhe të gjitha shkrimet e shenjta si thelbësore, ato gjithashtu përfshijnë besimin në Muhamedin si vula e profetëve dhe Kuranin si mesazhin e fundit dhe të mbrojtur të Zotit për njerëzimin. Shumica e muslimanëve vërtetojnë këtë interpretim.

I njëjti ajet Kuranor nganjëherë mund të mbështes të dyja palët e debatit. Ata dijetarë muslimanë të cilët e përdorin pozitën përfshirëse në mbështetje të pluralizmit dhe universalitetit të vlerave islame, por theksojnë besimin e tyre që një numër i hebrenjëve dhe të krishterëve do të shkojnë në parajsë në ajete të tilla si në vijim:

Vërtet, ata që besojnë (në këtë shkrim të shenjtë), si dhe ata që pasojnë hebrenjë, të krishterët dhe sabi'inët – kushdo prej tyre që beson Allahun dhe jetën tjetër dhe bëjnë vepra të mira, do të shpërblehen nga Zoti i tyre; ata nuk do të kenë pse të frikësohen apo të pikëllohen! (2:62)

Kundërshtarët argumentojnë se ajetet e tilla u referohen vetëm atyre hebrenjëve dhe të krishterëve që ishin gjallë gjatë kohës së profetëve të tyre përkatësdhe para caktimit të Muhamedit si profet të fundit të Zotit. Ata tregojnë se kur ai u pyet për

fatin e atyre që vdiqën para profetësisë së tij, Muhamedi u përgjigj se ata do të trajtoheshin sipas standardeve të vetë besimit të tyre.¹⁹

Lidhur me grupin e nevojshëm të besimeve, kundërshtarët argumentojnë se shumë ajete të tjera konfirmojnë se besimi në Muhamedin dhe në Kuran është thelbësor për njerëzit për të hyrë në parajsë.²⁰

Megjithatë, në lidhje me dialogun ndërftetar, marrja parasysht në masë të madhe e këtyre pyetjeve është joproduktive. Në fund të fundit, shumë muslimanë nuk i mendojnë aq shumë kriteret se kush do të hyjë në parajsë apo në ferr. Ata thonë se një vendim i tillë i takon vetëm Allahut. Siç është shpjeguar më lart, çështja e vërtetë e dialogut ndërftetar është se si shprehet njeriu dhe ndërton marrëdhënie paqësore ndërsa merr pjesë në dialog. Islami është një fe tokësore dhe kështu është shumë i shqetësuar për paqen në Tokë. Ndërsa besimi në botën tjetër është një pjesë shumë e rëndësishme e Islamit, kjo nuk duhet të shëmtohet me një gjuhë të ashpër, provokuese. Përkundrazi, duhet të shpjegohet me butësi dhe me modesti, sepse e vërteta është se vetëm Allahu e di se kush do të hyjë në parajsë. Më së miri është të thuhet se “Unë nuk e di se çfarë do të jetë fati im në botën tjetër. Allahu e di më së miri kush do të përfundojë në parajsë dhe në ferr. “Kurani, duke e përshkruar Ditën e Gjykimit gjallërisht, e bën të qartë se vetëm Allahu mund ta marr këtë vendim.:

Dhe [në atë Ditë], do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; dhe pastaj do t'i fryhet për të dytën herë dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin [para Vendqëndrimit të Gjykimit]. Dhe Toka do të shndrisë me dritën e Zotit të vet dhe do të vendoset Libri (i veprave të secilit). Pastaj do të sillen profetët dhe dëshmitarët e ata do të gjykojnë me drejtësi, e nuk do t'u bëhet asnjë padrejtësi. Secilit do t'i jepet shpërblimi për atë që ka bërë, sepse Ai e di më së miri se çfarë kanë punuar. (39: 68-70)

Megjithatë, ndërsa ndonjëherë është e rëndësishme të përvetësohet një qëndrim më përfshirës ndaj feve të tjera, do të

ishte një gabim i rëndë që të përvetësohet ky qëndrim në të gjitha rastet. Është çorientues për dijetarët muslimanë në kontekst të dialogut të pohohet se një grup universal i besimeve vlen për të gjitha fetë ose të pretendohet se Islami përfshin të gjitha fetë. Një supozim i tillë i përfshirjes mohon Islamin, mesazhin e tij unik, si dhe traditat e veçanta historike dhe fetare që e dallojnë Islamin dhe e bëjnë atë tërheqës.

Sigurisht, muslimanët të cilët besojnë se dialogu ndërfaqet është i ndaluar pohojnë me zë të lartë se të gjithë jomuslimanët janë të dënuar. Pjesëmarrja muslimane në dialogun ndërfaqet u bën thirrje atyre në ekstreme të përvetësojnë një rrugë të mesme për të shmangur ndarjet e ashpra në mes të muslimanëve dhe në këtë mënyrë të ruajnë unitetin e Umetit. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për komunitetet muslimane në Perëndim, sepse ata janë duke përjetuar kohë të vështira.

Imamet dhe dijetarët muslimanë të Islamit duhet të bëjnë përpjekje të përbashkëta për të udhëzuar komunitetin drejt përmbajtjes. Duke e lehtësuar presionin mbi muslimanët, kjo fushatë do t'ju mundësojë individëve që të pasojnë traditën e Profetit më besnikërisht.

DAR AL-ISLAM

Kjo fjalë do të thotë vendbanimi apo shtëpia e Islamit dhe përdoret si antonim për fjalën *Dar al-harb* (vendbanimi i luftës). Ekziston huti në përdorimin e këtyre fjalëve. Për disa Dar al-Islam i referohet atyrevendeve ose komuniteteve ku muslimanët janë të lirë për të praktikuar fenë e tyre. Për të tjerët, do të thotë një shtet që administrohet nga muslimanët sipas Sheriatit pa marrë parasysh a janë muslimanët shumicë apo pakicë.

Fjala *Dar al-Islam* dhe *Dar al-harb* nuk janë përdorur në Kuran.

Megjithatë, fjala *Dar al-Salam* është përdorur në Kuran: “Ata do të kenë Shtëpinë e shpëtimit (Dar al-Salam) te Zoti i tyre. Ai do të jetë Mbrotjtësi i tyre, si shpërblim për veprat që kanë bërë.

(6:127) Në një vend tjetër, Kurani thotë: Dhe [dije se] Allahu i thërret njerëzit për në Shtëpinë e Shpëtimit dhe Ai udhëzon kë të dojë Ai në rrugën e drejtë. (10:25) Megjithatë, këto ajete i referohen jetës së përtejme sipas komentuesve.

Ka disa referenca të tjera si në Kuran ashtu edhe në hadithe që më vonë në histori e mbështesin teologjinë e termeve *Dar al-Islam* dhe *Dar al-harb*. Për shembull, Kurani thotë:

“Kur engjëjt ua marrin shpirtrat atyre që e kanë ngarkuar veten me fajë, u thonë: “Ku ishit?” Ata përgjigjen: “Ishim të pafuqishëm në Tokë”. (Engjëjt) do t’u thonë: “A nuk qe Toka e Allahut e gjerë që të mërgonit në të?”

Këta janë ata (njerëz), vendbanimi i të cilëve është Xhehenimi; eh, sa i keq është ai vendbanim!” (4:97) Apo ky ajet: “Vërtet, ata që besuan,dhe mërguan (për hir të besimit), e më pas luftuan me pasurinë dhe jetën e tyre në rrugën e Allahut dhe ata që u dhanë strehim e i ndihmuan, janë miq e mbrojtës [të vërtetë] për njëri-tjetrin. Por, ata që besojnë e që nuk kanë mërguar, nuk të kërkohet t’i mbrosh, derisa të mërgojnë. E, nëse ju luten që t’i ndihmoni për çështjen e fesë, atëherë jeni të detyruar t’u dilni në ndihmë, përveçse (kur ju duhet të luftoni) kundër një populli me të cilin keni marrëveshje. Allahu e sheh mirë atë që vepron. (8:72). Imam Shejbani i Shkollës Hanefi të Mendimit i referohet këtij vargu që zbatimi i tij për të migruar nga Meka në Medine, u shfuqizua gjatë jetës së Profetit pasi që muslimanët u lejuan të qëndrojnë në Mekë.²¹

Një vështrim i afërt i këtyre termave zbulon se ata ishin sajuar gjatë hegjemonisë politike të Khulafa (Kalifatit) periudhës së Emevive dhe Abaside. Juristët muslimanë besuan se Islami kishte ardhur për të sunduar botën dhe nuk kishin asnjë dyshim se një kalifat universal mund të ishte realitet. Duke e parë atë si urdhër të Zotit, ata besonin se e gjithë botaduhej të jetonte nën Islam (Dar al-Islam) për paqe dhe siguri. Prandaj, ata që rezistuan të jetonin nën kalifat u quajtën Dar al-harbdhe duhej pushtuar. Ithtarët e librit duhej të paguanin xhizjen siç i referohej Kura-

ni asaj në 9:29, dhe politeistët duhej të konvertoheshin.

Megjithatë, hebrenjët dhe të krishterët, janë përmendur silthtarët e Librit (Ehlil Kitab) në Kuran, dhe si të tillë, më vonëkur India u pushtua nga muslimanët, ata nuk u konvertuan, por iu dha statusi i Ithtarëve të Librit. Studimi i thelluar i fjalës *Dar al-Islam* i referohet në mënyrë të qartë dominimit politik të Islamit, duke injoruar ata juristë të hershëm që ishin shprehur ndryshe. Për konfirmimin e këtij pretendimi, rasti i Indisë Britanike është i rëndësishëm për t'u studiuar. Kur muslimanët humbën pushtetin nga britanikët, reagimi i parë ishte emocional si në aspektin politik ashtu edhe në aspektin fetar. Shah Abdul Aziz shpalli Indinë si Dar al-harb në vitin 1803. Në këtë kohë, Sayyid Ahmad filloi një lëvizje për Xhihad nga Krahina në Kufirin Veri Perëndim duke u bërë thirrje fiseve Pushtun për të çliruar Indinë. Pasi që muslimanët janë të detyruar të migrojnë për në Dar al-Islam për të nisur Xhihadin kundër Dar al-harb, një pjesë e muslimanëve migruan nga India, megjithëse shumica e tyre, duke përfshirë Shah Abdul Aziz qëndruan. Më vonë duke e pranuar realitetin e kësaj gjendje, Juristët muslimanë të Indisë debatuan nëse India nën britanikët ishte Dar al-harb ose Dar al-Islam. Duke iu kthyer Fikhut hanefi (jurisprudencë), shumë sosh erdhën në përfundim, duke përfshirë disa në Seminarin Deoband, se për aq kohë sa ekziston liria fetare për muslimanët, një vend mund të konsiderohet si Dar al-Islam.²²

Për të kuptuar këtë çështje në zbatimin e saj bashkëkohor, Vendi i Muslimanëve në Sheshin Publik Amerikan është një libër i mirë për të lexuar. Në kapitullin e parë të këtij libri, "Drejt një Fikhu për Minoritetet: Disa Reflektime," Taha Xhabir Al-Alvani vjen në përfundim se Dar al-Islam është çdo vend ku një musliman mund të jetojë në paqe dhe siguri, edhe në qoftë se ai/ajo jeton në një shumicë jo-muslimane. Al-Alvani shpjegon se Dar al-harb ose Dar al-Kufr është një vend ku një musliman jeton nën kërcënim. Edhe në qoftë se shumica atje i përmbahet Islamit dhe kulturës islame, një musliman është i obliguar të migrojnë në një vend të lirisë. Ai citon mendimin e Al-Marvardi që thotë se në qoftë se një musliman është në gjendje të praktikojë fenë e tij

hapur në një vend jo-musliman, ai vendbëhet Dar al-Islam duke u mbështetur në vendosjen e tij atje. Vendosja në një vend të tillështë e pëlqyer pasi që ka gjasa që njerëzit e tjerë të konvertohen në Islam. Al- Alvani gjithashtu citon Imam al-Razin duke përmendur mendimin e al-Shashi që sipas tij do të ishte më mirë të thirret Dar al-harb ose Dar al-Kufr si Dar al-Da'uah dhe Dar al-Islam si Dar al-ijabah. Ai i quan jo-muslimanësi Umaah al-Da'uah dhe muslimanët si Ummah al-ijabah.²³

Në kohët e fundit, Dar al-'Ulim Deoband quajti Indinë nën sundimin Hindu si Dar Al-Aman (vend të mbrojtjes dhe paqes). Zëvendës Rektori i Seminarit, Mevlana Abdul Khaleque u citua në Hindustan Times më 22 shkurt 2009 duke thënë se muslimanët në Indi janë të lirë për të praktikuar fenë e tyre në liri kështu që është Dar Al-Aman për të gjithë muslimanët.

Kushtet politike, ekonomike dhe shoqërore të botës moderne kanë ndryshuar në mënyrë drastike. Ne jemi duke jetuar, me sa duket dhe deri në një masë, në një botë demokratike (të paktën kjo promovohet si ideal, nëse praktikohet gjithkund është një çështje tjetër) ku të gjithë qytetarët zotohen për besnikëri ndaj kushtetutës së vendit, një kushtetutë e nënvizuar nga liria e mendimit, fesë dhe pronës. Ne të gjithë jetojmë së bashku, si muslimanët ashtu edhe jomuslimanët, në Dar al-'Ahd (në një botë të besëlidhjes), duke u zotuar për kushtetutën dhe në këmbim pranimin e sigurisë dhe lirisë.

DHIMMI

Termi *dhimmi*, nga *dhima*, do të thotë një premtim (al-'Ahd), një garanci (Al-aman) dhe siguri (Al-Aman). Fjala dhimmi nënkupton premtimin e mbrojtjes nga Allahu, i Dërguari i Tij dhe besimtarët për të gjithë jo-muslimanët që jetojnë nën sundimin musliman. Termi nuk ka të bëjë fare me shtetësinë. Të gjithë njerëzit, muslimanët dhe jo-muslimanët janë qytetarë të barabartë në Shtetin Islam (Al-Jinsiyyah al Islamiyyah).²⁴

Përse termi *dhimmi* u përvetësua për jomuslimanët? Gjatë gjithë historisë, grupi në pushtet, zakonisht përfaqësues të një kombësie apo grupimi social, i ka shkelur të drejtat e të tjerëve që jetojnë në atë vend. Në kohët e vjetra, fiset e mëdha do të vënin nën kontroll fiset e vogla që jetonin në atë zonë. Praktika e përndjekjes dhe përruljes së grupeve të nënshtruara në mënyrë që elita e fuqishme të dominojë nuk është e pazakontë pasi që kjo është një metodë e zgjatjes së pushtetit dhe kontrollit të burimeve ekonomike. Për të shpëtuar jomuslimanët nga frika e tillë edominimit dhe persekutimit, u përvetësua termi *dhimmi* duke u dhënë atyre mbrojtje politike, fetare, shoqërore dhe ekonomike. Nëse të drejtat e një *dhimmi* shkeleshin, muslimanët kishin frikë nga zemërimi pasues i Zotit.

Termi *Dhimmi* ishte i rrënjosur fuqishëm në traditën arabe. Arabët praktikonin zakonin e *Jiuar* (mbrojtjes) ose *dhimmah* në sistemin e tyrepolitik. Pasi që arrihej pajtimi për kushtet, fisi më i fortë do të mbronte atë më të vogël nga çdo agresion apo persekutim. Kjo mbrojtje ishte çështje nderi për fisin më të fortë i cili siguronte që *dhimmah* ishte në fuqi. Kur arabët pranuan Islam, atëherë njëti koncept i *dhimmah* u aplikua për jomuslimanët për të siguruar për ata mbrojtje të plotë dhe siguri. Është thotë, të krishterët ishin mbase më mirë si *dhimmi* nën sundimet arab muslimanë atëherë se sa kishin qenë nën grekët bizantin. E njëjta gjë është përsëritur nga Thomas Arnold në Predikimin e Islamit të tij.²⁵

Termi *dhimmi* u përdor për të nxitur tolerancë plot respekt dhe liri ndaj jomuslimanëve në një kohë kur ka pasur pak ose aspak tolerancë. Ka shumë hadithe që inkurajojnë këtë mbrojtje. Nuk ka asgjë negative në këtë term. Megjithatë, peizazhi politik i botës, duke përfshirë edhe botën muslimane, ka ndryshuar shumë. Edhe në qoftë se një Shtet Islam është duke u themeluar në botën moderne, fjala *dhimmi* do të konsiderohej si zbatim i papërshtatshëm në kontekstin bashkëkohor.²⁶

XHIZJA

Xhizje, kuptimi i rrënjës kompensim, ishte një taksë lokale ndaj *dhimmi-ve* që jetonin në një shtet musliman. Kjo në të vërtetë është një taksë përkatëse e zekatit. Ashtu si zekati për muslimanët, ata jomuslimanë të cilët mund të përballojnë atë, prej tyre kërkohej tëpagojnë *xhizjen* ndaj shtetit. Më tej, ndryshe nga zekati, shumica e *xhizjes* ishte fikse dhe minimale. Fillimisht vetëm ata që mund t'i bashkoheshin ushtrisë ishin të detyruar të paguanin *xhizjen*. Doi shpjegon se *xhizja* i lironte jomuslimanët nga pagesa e zekatit, edhe pse atyre u jepej zekati nëse ishin të varfër.²⁷

Justifikimi i *xhizjes* buron nga Kurani: “[Dhe] luftojini ata që nuk besojnë në Allahun e as në Ditën e Kiametit, që nuk e marrin për të ndaluar atë që e ka ndaluar Allahu dhe i Dërguari i Tij, dhe ata, midis atyre që u është dhënë Libri, që nuk e pranojnë fenë e vërtetë, derisa të japin *xhizjen* (taksën) me dorën e tyre, duke qenë të përlur [në luftë]” (9:29). Kjo sure u shpall në vitin 9 të Hixhretit, migrimi i Profetit në Medine. Islami u përhap në të gjithë Arabinë dhe një numër i hebrenjëve dhe të krishterëve ranë nën sundimin musliman. Ishte gjatë kësaj kohe që vetë Profeti zbatoi konceptin e *xhizjes* për Ithtarët e Librit dhe ai vazhdoi gjatë Kalifatit në historinë muslimane. Shumica e komentuesve të Kuranit pajtohen se ai ishte i detyrueshëm vetëm për ata burra hebrenjë dhe të krishterë të cilët mund të shërbenin në forcat e armatosura, por ishin të liruar dhe në vend të kësaj kërkohej që të paguanin një shumë të caktuar në këmbim. Ata që nuk kishin mundësi ta përballojnë atë liroheshin.

Xhizja ishte simbolike dhe përjashtimet ishin të shumta.²⁸ Muhammad Asad përkthen fjalën *xhizje* si lirim nga tatimi. Ai thotë se jomuslimanët të cilët ishin lejuar t'i bashkoheshin muslimane në historinë e mëvonshme ishin të liruar nga *xhizja*.²⁹ Myftiu Muhammad Shafi në shpjegimin e tij për këtë ajet thotë se fillimisht ajo ishte aplikuar për Ithtarët e Librit dhe pastaj për Majis (besimtarët e zjarrit) të cilët ishin përfshinë gjithashtu në kohën e Profetit. Megjithatë, Mushrikët e Mekës nuk ishin përfshirë. Prej tyre u kërkuar të pranojnë Islamin ose të largohen nga

ai rajon. Sipas Abu Hanifah prej të gjithë jo-muslimanëve duke përfshirë hindusët, budistët dhe të tjerët u kërkua të paguajnë xhizjen ata të cilët ishin në gjendje të paguajnë atë.³⁰

Zekati është shtyllë e Islamit dhe nga ai nuk mund të lirohet askush. Xhizja është ndryshe. Është transmetuar se Profeti ka thënë gjatë vdekjes së djalit të tij Ibrahim se ai do të kishte liruar të gjithë koptët nga Pagesa e xhizjes nëse Ibrahim do të jetonte si shenjë nderimi për të. Nëna e Ibrahimit ishte kopte.³¹ Raportohet gjithashtu se Banu Taghlib një fis jomusliman iu afrua 'Umarin, Kalifit për t'i liruar ata ngaxhizja pasi që ata u ndien të poshtëruar dhe se ata do të paguajnë zekatin në këmbim. Thuhet se 'Umar i lejoi ata.³²

Siç u tha më parë për *dhimmi*-t, e njëjta gjë është e vërtetë për *xhizjen*. Realitetet politike dhe ekonomike, duke përfshirë edhe sistemin e taksave, të botës moderne kanë ndryshuar shumë. Rrethanat që ndryshojnë kërkojnë një vështrim të ri të Kuranit dhe Sunetit në zbatimin e tij të marrëdhënieve të muslimanëve me jomuslimanët.

BASHKËJETESA PAQËSORE DHE TË DREJTAT FETARE DHE NJERËZORE

Islami bazon emrin e vet në angazhimin e tij për paqen (*salam*), dhe një nga Emrat e Zotit është *al-Salam* (Paqësor). Në këtë mënyrë, jeta e qetë dhe bashkëjetesa janë në qendër të asaj që Islami i urdhëron të gjithë muslimanët. Duke pasur parasysh këtë realitet, Kurani është shumë i shqetësuar për t'i dhënë fund grindjeve fisnore, etnike, dhe fetare dhe për promovimin e bashkëjetesës paqësore. Pra, është e vërtetë se një pjesë e muslimanëve besojnë se 'Deklarata e të Drejtave të Njeriut e Kombeve të Bashkuara dhe Ligji i të Drejtave të Shteteve të Bashkuara u ndikuan nga Kurani.³³ Më poshtë janë disa koncepte të veçanta Kuranore që bëjnë thirrje për ruajtjen e dinjitetit njerëzor, duke ushtruar respekt, dhe arritjen e bashkëjetesës paqësore në këtë botë.

E drejta për jetën: Kurani mbështet shenjtërinë dhe vlerën absolute të jetës njerëzore:

Prandaj Ne i urdhëruam bijtë e Izraelit se kush vret ndokënd, që s'ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.

Dhe vërtet, të dërguarit tanë u sollën shenja të qarta, por shumë nga ata, edhe pas kësaj, i kaluan tërë kufijtë me të këqija në Tokë. (5:32)

Thuaju: "Ejani t'ju lexoj çfarë ju ka urdhëruar [vërtet] Allahu: që të mos i shoqëroni Atij asgjë (në adhurim); që të silleni mirë me prindërit; që të mos vrisni fëmijët tuaj për shkak të varfërisë, sepse Ne ju ushqejmë ju dhe ata; që të mos i afroheni veprave të turpshme, qofshin ato të hapëta apo të fshehta dhe që të mos ia merrni tjetrit jetën, të cilën Allahu e ka shenjtëruar, përveçse kur e kërkon drejtësia (e ligji). Këto ju porosit Ai, me qëllim që të kuptoni." (6:151)

I njëjti mesazh gjendet në pjesë të tjera të Kuranit.

Liria fetare: Kurani mbështet pluralizmin fetar si diçka të denjë për respekt:

Dhe [kështu është:] sikur të donte Zoti yt, do të besonin të gjithë ata që gjenden në tokë. Vallë, ti do t'i detyrosh njerëzit të bëhen besimtarë?! (10:99)

Ne të kemi zbritur ty (o Muhamed) Librin me të vërtetën, si përm-bushës të shkrimeve të mëparshme dhe mbrojtës të tyre. Prandaj gjykoji ata sipas asaj që të ka zbritur Allahu dhe mos ndiq dëshirat e tyre, duke u shmangur kështu nga e Vërteta që të është shpallur. Ne për secilin nga ju kemi sjellë një ligj dhe një rrugë të qartë. Sikur të donte Allahu, do t'ju kishte bërë një popull të vetëm, por Ai kërkon që t'ju provojë në atë që ju ka dhënë, andaj bëni gara për punë të mira! Të gjithë do të ktheheni te Allahu e Ai do t'ju lajmërojë për çështjet, rreth të cilave kishit kundërshti. (5:48)

Dhe thuaj: "E vërteta është nga Zoti juaj. Kush të dojë, le të besojë e kush të dojë, le të mohojë" Ne kemi përgatitur për mohuesit keq-bërës një zjarr, që do t'i rrethojë nga të gjitha anët (si çadra). Nëse do të kërkojnë ndihmë, do t'u jepet një ujë si xehja e shkrirë, që do t'ua përcëllojë fytyrat. Sa pije e tmerrshme është ajo e sa strehim i keq është ai (zjarri)! (18:29)

Nuk ka detyrim në fe: Kurani ndalon konvertimin me force dhe çfarëdo pengimi të lirisë fetare: “Nuk ka detyrim në çështjet e besimit...” (2:256). Allahu i tha Muhamedit, i cili ishte shumë i brengosur që Mekasit të pranojnë Islam: “Sikur të donte Allahu, ata nuk do të ishin idhujtarë. Ne nuk të kemi bërë ty rojtar të tyre e as që je përgjegjës për ta” (6:107).

Respekt për fetë dhe komunitetet tjera fetare: Kurani ndalon muslimanët nga përdorimi i gjuhës ofenduese për fetë tjera: “Por mos i shani idhujt që ata i adhurojnë në vend të Allahut, në mënyrë që ata të mos e shajnë Allahun armiqësisht nga padija. Kështu, Ne ia paraqesim të bukura çdo populli veprat e veta. Pastaj, ata do të kthehen te Zoti i tyre, i Cili do t'i lajmërojë për gjithçka që kanë bërë.” (6:108) Në këtë ajet, Umeti (komuniteti fetar) dhe zayyana (joshës dhetërheqës) janë përdorur së bashku për të treguar se Allahu i bëri urdhrat fetar - Sheriatin (ligjin e shenjtë) dhe minhaj (vlerat kulturore) të çdo komuniteti tërheqëse dhe joshëse për pasuesit e tyre. Prandaj, Kurani kërkon nga muslimanët që të tregojnë respekt ndajsherateve dhe manahij të tjerë dhe të shmangen nga ofendimi i tyre. Ky lloj urdhri, që gjendet në të gjithë Kuranin, kërkon që të sigurojë që pluralizmi fetar të respektohet dhe që veprimet dhe bindjet e secilit komunitet fetar janë të mbrojtura dhe të vlerësuara.

Respekti për fjalim të ndershëm për Profetët dhe Themeluesit dhe Figurat e Feve tjera:

Paqja qoftë mbi Ibrahimin! Ja, kështu, Ne i shpërblejmë punëmirët. Ai ka qenë vërtet një nga robërit Tanë besimtarë. (37:109-11)

Sepse, vërtet, Ne i dhamë Musait Librin dhe pas tij çuam të dërguarit njërin pas tjetrit [70]. Ne i dhamë Isait, të birit të Merjemes, mrekulli të qarta dhe e mbështetëm atë me Shpirtin e Shenjtërisë. (2:87)

...Allahu të jep lajmin e mirë për Jahjain, i cili do të vërtetojë Fjalën e Allahut (Isain a.s.), do të jetë një fisnik, i dëlirë dhe profet, një prej të mirëve.” (3:39)

(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të ka zgjedhur, të ka pastruar dhe të ka parapëlqyer ty mbi të gjitha gratë e botës. O Merjeme! Bindju Zotit tënd! Bëj sexhde dhe përkulu në ruku bashkë me ata që përkulen (para Tij)!” (3:42-43)

(Kujto) kur engjëjt thanë: “O Merjeme! Allahu të jep lajmin e mirë për një djalë që do të lindë me një fjalë prej Tij: emrin do ta ketë Mesih - Isa i biri i Merjemes, do të jetë i nderuar në këtë botë dhe në tjetrën dhe një nga të afërmit e Allahut”. (3:45)

Mbrojtje dhe respekt për të gjitha vendet e kultit :

...Sepse, sikur Allahu të mos u kishte dhënë njerëzve mundësinë për t’u mbrojtur nga njëri-tjetri, do të shkatërroheshin manastiret, kishat, sinagogat dhe xhamitë, në të cilat përmendet shumë emri i Allahut. Vërtet, Allahu e ndihmon këdo që e ndihmon Atë. Allahu është vërtet i Fortë dhe i Plotfuqishëm. (22:40)

Respekt për njerëzit, pavarësisht nga feja e tyre :

Vërtet, si ata që kanë besuar, ashtu dhe hebrenjët, sabi’inët, të krishterët, dhe mexhusitë [në njërën anë] dhe idhujtarët [në anën tjetër], vërtet Allahu do t’i gjykojë drejt të gjithë Ditën e Kiametit. Nuk ka dyshim, se Allahu është dëshmitar për çdo gjë. (22:17)

O njerëz! Në të vërtetë, Ne ju krijuam ju prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë popuj e fise, për ta njohur njëri tjetrin. Më i nderuari prej jush tek Allahu është ai që i frikësohet më shumë Atij. Vërtet, Allahu është i Gjithëdijshëm dhe për Atë asgjë nuk është e fshehtë. (49:13)

Në një hadith të mirënjohur, Profeti Muhamed ka thënë: “O njerëz, Zoti juaj është Një dhe babai juaj [Ademi] është një. Nuk ka epërsi një arab ndaj një jo-arabi apo anasjelltas, ose një i bardhë ndaj një të ziu apo anasjelltas, por vetëm në çështjet e drejtësisë.”³⁴

Liria e Fjalës dhe Shoqatës: Kurani përdor shira (konsultim) për të dekurajuar autoritarizmin dhe absolutizmin dhe për të inkurajuar njerëzit për të shprehur mospajtimin e tyre në mënyrë të civilizuar. Në fakt, kapitulli 42quhet sura el-Shira në mënyrë që të nxjerrë në pah rëndësinë e nderimit të dallimeve të mendimit, lirinë e fjalës dhe lirinë e shoqërimit. Kurani flet me një ton shumë aprovues për ata që adhurojnë Zotin dhe janë të vetëdijshëm për Të: “...dhe që rregullisht [për të gjitha punët] këshillohen me njëri-tjetrin...” (42:38).

Kurani i thotë Muhamedit të respektojë mendimin e sinqertë të kundërshtarëve të tij dhe të konsultohet me ta:

Dhe në sajë të mëshirës së Allahut, u solle butësisht me ta [O Profet]. Sikur të ishte i ashpër dhe i vrazhdë, ata do të largoheshin prej teje. Prandaj falua atyre gabimin, kërkoi falje Allahut për ata dhe këshillohu me ata për çështje të ndryshme. Kur të vendosësh për diçka, mbështetu tek Allahu. Vërtet, Allahu i do ata që mbështeten tek Ai. (3:159)

Ky ajet është shpallur në kohën kur hipokritët tradhtuan Muhamedin dhe muslimanët pak para betejës së Uhudit. Muhamed, që thirri një shira, kuptoi se disa nga njerëzit ishin në favor të mbrojtjes së Medines nga brenda portave të saj. Por shumica kërkonin të luftonin sulmuesit në terren të hapur. Muhamedi pasoi mendimin e shumicës. Kur 1.000 ushtarët dolën për t'u përballur me armikun, 300 prej tyre u larguan, duke thënë se mendimi i tyre nuk ishte respektuar. Kjo tradhti erdhi në një moment krize. Edhe pse muslimanët besnikë pësuan humbje të rënda gjatë betejës që pasoi, ata ishin në gjendje të mbijetojnë. Muhamedi u plagos dhe xhaxhai i tij Hamza u martirizua. Edhe pas kësaj ngjarjeje, Muhamedi nuk i dëbojë atadradhtarë nga takimet e tij të shira-s.³⁵

Dialogu dhe Komunikimi duhet të mbahen në një atmosferë plot respekt: Kurani u thotë njerëzve që të flasin në mënyrë të civilizuar me njëri-tjetrin në të gjitha rastet, veçanërisht gjatë momenteve të tensionit apo mospajtimit:

“Dhe diskutoni me ithtarët e Librit vetëm me mënyrën më të mirë” (29:46). E njëjta porosi është përsëritur shpesh. Në përgjithësi, Allahu urdhëron mirësjellje, madje deri në pikën e të qenit më i suksesshëm se fqinji i njeriut në këtë drejtim: “Kur ju përshëndet dikush me respekt, kthejani me një përshëndetje më të mirë ose në të njëjtën mënyrë! Pa dyshim, Allahu llogarit çdo gjë” (4:86). Profeti nuk ishte “njeri që shante të tjerët, fliste fjalë të këqija, apo mallkonte të tjerët. Nëse donte të qortonte dikë prej nesh, ai do të thoshte: ‘Çfarë ka ai? Le të pluhuroset balli i tij.’”³⁶ Fjala *turab* është përdorur këtu. Kur një musliman bie në sexhde, balli i tij apo i saj pluhuroset pak. Ndoshta kur Profeti nuk ishte i kënaqur me dikë, ai do të thoshte këto fjalë, që mund të nënkuptoj edhe “Qofshi të nënshtruar ndaj Zotit.”

PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT

- Kurani përdor Ta'arafi, i||lah, ihsan, mujadalah, al-hikmah ua al- mau'i
- ah al-hasanah, Ta'aun, dhe Istabiqi al-Khayrat, dhe terme të ngjashme për të promovuar mirëkuptimin ndërftetar dhe bashkëjetesën paqësore.
- Kurani e pranon ekzistencën e feve të tjera që u ngritën përpara Islamit dhe nënvizon bashkëjetesën paqësore me ta përmes koncepteve të tilla si dIn al-fi~ rah , al-dIn al-hanIf , dhe Ehlil Kitab.
- Derisa nënvizon ndërtimin e urave dhe tolerancën plot respekt, Kurani thekson pozicionin unik të Islamit në mesin e të gjitha feve të tjera dhe veçantinë e bashkësisë muslimane.
- Fjala *kafir* ka përdorime të shumta. The Ehlil Kitab janë besimtarë nëkuptimin e besimit në Një Zot. Kur zbatohet fjala kafir për ta, kjo nënkupton se ata mohojnë Kuranin dhe profetësinë e Muhamedit.
- Fjala *Vali* do të thotë një kujdestar ose mbrojtës; ai nuk përkthehet thjeshtë si "mik." Muslimanët duhet të kenë miqësi me jomuslimanët, të këmbëjnë dhurata me ta, t'i vizitojnë ata kur ata janë të sëmurë dhe të respektojnë fqinjët e tyre jomusliman.
- Koncepti i Kuranit i të drejtave dhe detyrimeve njerëzore është i ngjashëm me atë që gjendet në Ligjin e të Drejtave të Shteteve të Bashkuara dhe Kartën e të Drejtave të Njeriut të Kombeve të Bashkuara.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. Gjeni ajetin tuaj Kuranor që mbështet dialogun ndërftetar, ashtu siç e kuptoni ju.

2. A mund të mendoni për ajete që nuk e mbështesin dialogun ndërfaqetarak?
3. Cila do të ishte mënyra më e përshtatshme për të përcjellë mesazhin e Islamit tek jo-muslimanët?
4. Bazuar në përvojën tuaj, me çfarë sfida të tjera mund të përballen muslimanët të cilët janë të interesuar për dialog ndërfaqetarak?

KAPITULLI IV

TRAJTIMI I JOMUSLIMANËVE NË DRITËN E SIRAH TË PROFETIT DHE HISTORIA MUSLIMANE

Kurani, hadithet, tradita islame, dhe historia na japin vetë shumë shembuj të marrëdhënieve paqësore ndërfetare. Edhe nëse ata ishin komunitet pakicë apo shumicë, kanë arritur gjithmonë tek grupet e tjera fetare. Kjo pjesë shqyrton një numër të përzgjedhur të rasteve për të ilustruar pasurinë dhe thellësinë e thirrjes së Islamit për dialog ndërfetar dhe marrëdhënie paqësore. Jeta e Profetit është përplot me shembuj të tolerancës dhe mënyra jo të dhunshme të komunikimit me edukatë të fjalës së Allahut jo-besimtarëve, madje edhe kur Islami ishte në fazat e hershme. Natyrisht, një pjesë e shkurtër mund të jap vetëm disa nga këta shumë shembuj.

Para së gjithash, është e rëndësishme të theksohet fuqia e vet shembullit të Profetit si një person që gjithmonë ka favorizuar dialogun. Kjo fuqi rrjedh nga autoriteti i tij i pashembullt. Rrëfimi në vijim dëshmon për atë autoritet. Aishah, njëra nga gratë e tij, u pyet një herë për gjendjen shpirtërore dhe morale të burrit të saj. Ajo pyeti: “A nuk e keni lexuar Kuranin?” Ata u përgjigjën: “Po.” Ajo pastaj tha: “Profeti është Kuran i gjallë”¹ Me fjalë të tjera, ai është një mishërim i përsosur i mësimëve të Kuranit.

Kurani lavdëron Profetin si një të dërguar të mëshirës dhe bekimit për të gjitha botët (21: 107) dhe një llambë që përhap dritë (33:46). Ai kërkon nga njerëzit që të përdorin rrugën e tij

të jetës si modelin e tyre (33:21). Kur Aishah u pyet në lidhje me sjelljen e tij morale, ajo u përgjigj: “Ai nuk ishte një njeri e pshor as i zhurmshtëm në treg. Ai nuk kthente të keqen me të keqe; përkundrazi, ai me respekt do të toleronte dhe falte.”² Shumë nga cilësitë e tij të tjera janë transmetuar në të njëjtin hadith.

Mekasit, indiferent për të ose ndoshta të frikësuar nga cilësitë e tij shembullore personale, përndoqën atë dhe pasuesit e tij dhe përfundimisht vendosën një bojkot të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik mbi ta, duke i detyruar ata të jetojnë në izolim dhe varfëri. Por më vonë, kur një zi e madhe buke preku Mekasit dhe shumë prej tyre po vdisnin nga uria, armiku i tij i patundur Abi Sufyan iu afrua atij duke i thënë: “ Muhamed, lutu për mekasit. Ata janë duke vdekur.” Muhamedi ngriti duart e tij në lutje dhe Allahu dërgoi një shi të madh, me anë të mëshirës së Tij, për t’i dhënë fund urisë.³ Nga fillimi i misionit të tij, Profeti bëri më të mirën e tij për të mbajtur një bashkëjetesë paqësore me armiqtë e tij dhe respekto fetë dhe besimet e tyre. Ai promovoi lirinë e mendimit dhe shprehjen e lirë në predikim.⁴ Kështu, jeta e tij është një model madhështor për muslimanët, imamët, dhe gjithë të tjerët për ta ndjekur në përpjekjet e tyre për zhvillimin e marrëdhënieve të ndërsjella të mira në mes vete dhe me jomuslimanët. Duke i shëmbëllyer Muhamedit, muslimanët bëhen një popull i vetëpërmbytjes, urtësisë, kujdesit dhe drejtësisë. Muslimanët qëndrojnë përkrah njerëzve që vuajnë, për drejtësinë dhe për mirëqenien e të gjithëve, pa marrë parasysh racën, gjininë, ngjyrën dhe fenë. Kjo është dahva e vërtetë dhe rruga e Profetit dhe e të gjithë profetëve. Ajo duhet të jetë edhe rruga e të gjithë muslimanëve.

BASHKËVEPRIMET E PROFETIT MUHAMED ME MEKASIT

Persekutimi dhe përgjigja e Muhamedit: Persekutimi Mekasit i muslimanëve u ngriti deri në atë masë sa që muslimanët u përballën me një bojkot të përgjithshëm shoqëror dhe ekonomik në

formën e një pakti të padrejtë të projektuar për t'i izoluar ata nga çdo ndihmë dhe komoditet. Muslimanët dhe përkrahësit e tyre u detyruan të marrin strehim te Abi Talib për arsye sigurie. Pakti mbeti në fuqi për tre vjet, gjatë të cilave ata u detyruan të hanë gjethe të pemëve dhe lëkurat e kafshëve të ngordhura. Klimat e fëmijëve të uritur mund të dëgjoheshin edhe në largësi. Shumë gra dhe fëmijë muslimanë vdiqën nga uria. Përkundër një trajtimi të tillë barbar, megjithatë, Muhamedi kurrë nuk u lut për shkatërrimin e Mekasve.⁵

Në një rast tjetër gjatë kësaj periudhe, Muhamedi shkoi në Taif, një qytet i begatë në afërsi të Mekës dhe ftoi popullin e tij në Islam. Pori kundërshtim me shpresat dhe pritjet e tij, ai hasi në armiqësi të madhe. Ai arriti të takohej me disa nga të afërmit e tij dhe miqtë e tyre dhe t'u paraqes atyre Islamin, por edhe pas disa ditësh armiqësia fillestare e njerëzve nuk kishte rënë. Kështu ai vendosi të largohej. Për të përshpejtuar largimin e tij, populli i Taifit e dëbuan atë nëpër rrugica, e sulmuan me gurë dhe e ndoqën atë dy apo tre milja. I përgjakur nga plagët në kokë, Profeti u dobësua shumë dhe u strehua tek muri i një vreshti. Ai iu lut Zotit të vet, duke i treguar Atij se çfarë i kishte ndodhur dhe kërkoi mëshirën e Tij. Si përgjigje në këtë, Allahu dërgoi engjëllin Gabriel së bashku me engjëllin e maleve. Ata i kërkuan leje Profetit të shkatërrojnë të dyja, Taifin dhe Mekën. Ai iu lut atyre të mos e bëjnë këtë, duke thënë: "Unë më parë do të doja dikë nga ijët e tyre që do të adhurojë Allahun, të Plotfuqishmin, i cili nuk ka shok."⁶

Pasi që Islami kishte krijuar rrënjë të tij në Medine, 'Abd Ya'lil, udhëheqës i Taifit i cili kishte nxitur fëmijët që të hedhin gurë mbi të, erdhi atje për adhurim. Duke e parë atë të hyjë në Xhaminë e Profetit, Profeti u ngrit në këmbë për ta mirëpritur atë dhe kërkoi nga ai të ulet pranë tij në mënyrë që ta nderojë atë. Profeti nuk tha asgjë në lidhje me trajtimin e keq që kishte përjetuar në Taif. Megjithatë, kur Aishah më vonë e pyeti Profetin cili incident e kishte prekur atë më së shumti, ai iu referua Taifit. Ky nivel i lartë i faljes dhe bujarisë ndaj një armiku të mëparshëm dhe shumë të tjerëve që e kanë bërë atë të vuajë është vështirë për t'u gjetur sot, madje edhe në mesin e muslimanëve shumë fetar.⁷

MUHAMEDI FALET PËR FITOREN BIZANTINE NDAJ PERSIANËVE

Në konfliktin politik ndërmjet Perandorisë Bizantine dhe asaj Perse, komuniteti i ri musliman anonte kah Bizantinët e krishterë, derisa mekasit luteshin për fitoren e Persianëve Zoroastrianë. Pasi persianët mundën bizantinët, të cilët humbën Sirinë dhe Palestinën, që përfaqësonin pjesën më të madhe të territoreve të tyre të Lindjes së Mesme, mekasit përqeshën Muhamedin dhe pasuesit e tij: “Duhet të të përzëmë, si persianët që përzunë bizantinët”. I palodhur e i parreshtur, Muhamedi lutej për fitoren e bizantinëve. Allahu pastaj zbuloi këto vargje: U mundën bizantinët, brenda disa vjetëve. Me të vërtetë, është vendimi i Allahut, si për të parën dhe për të dytën. Dhe, atë ditë, do të gëzohen besimtarët» (30:2-4). Ky zbulim i vërtetua disa vite më vonë, kur bizantinët rifituan kontrollin e territoreve të tyre të humbura. Ky incident tregon se si Profeti gjithmonë mendohej të gjente ato besime që ishin më të afërta me Islamin dhe pastaj të fillonte marrëdhënie më të mira me to. Derisa është thelbësore të ndërtohen marrëdhënie të mira me secilin, është sigurisht më e lehtë të ndërtohen me disa, e më vështirë me disa të tjerë. Muslimanët që jetojnë në perëndim mund të shfrytëzojnë më së miri metodologjinë e Profetit në ndërtimin e marrëdhënieve ndërftetare.

MBRETI I KRISHTERË E ETIOPISË MIRËPRET REFUGJATËT MUSLIMANË

Ky është një shembull tjetër i iniciativave të Profetit Muhamed për ndërtimin e urave me të krishterët. Në reagimin e tij ndaj kushteve të përkeqësuar në Mekë, ai kërkonte mënyra për të zbutur vuajtjet e pasuesve të tij. Kur Profeti mësoi që mbreti i Etiopisë ishte i krishterë i drejtë, ai i lejoi pasuesit e tij të kërkojnë strehë tek ai, duke shpresuar që do t'i mbronte.

Një grup prej gjashtëmbëdhjetë muslimanësh iku nga Meka gjatë natës. Kur paganët zbuluan ikjen e tyre, u zemëruan shumë, sepse nuk donin që muslimanët të gjenin strehë të sigurt. Kështu, dërguan një grup të rinjsh që t'i zinin rrugën muslimanëve para se të arrinin në Etiopi. Megjithatë, muslimanët arritën mirë. Pastaj, mekasit dërguan një delegacion tek Mbreti, me dhurata të çmueshme, si dhe kërkuan që ai t'i kthente këta “rebelë” prapa në Mekë. Ata i thanë atij që këta “rebelë”, të fryrë me krenarinë e Islamit, kishin fyer jo vetëm besimet e paraardhësve të vetë mekasve, por edhe besimet e të krishterëve.

Mbreti, njeri i drejtë, i thirri muslimanët në pallatin e tij si dhe iu kërkoi të shpjegoheshin. Ja'far ibn Abu Talib u ngrit për të dëshmuar besimin e tij. Kur iu kërkua të recitonte nga Kurani, ai recitoi suren *Maryam*. Sundimtari etiopian, duke dëgjuar recitimin, qau aq shumë saqë lagu edhe mjekrën e tij. Kur u qetësua, i tha mekasve që ky zbulim, si dhe ai që i ishte zbuluar Jezusit, kishin ardhë nga i njëjti burim. Kështu, ai nuk pranoi të dorëzonte muslimanët, si dhe i ktheu mekasve dhuratat. Si masë e fundit, mekasit i thanë që këta muslimanë e konsideronin Jezusin të ishte vetëm shërbyes i Zotit, e jo si i Biri i tij, si dhe që muslimanët e hedhin poshtë Trininë e Shenjtë. Kur u pyet për këtë gjë, Ja'far recitoi prapë: “Ai është i Dërguari i Allahut; fryma dhe fjala e Zotit që i dërgoi Merjemes.” [Ai e thotë këtë duke iu referuar Kuranit 19:16-36]. Pasi dëgjoi këtë, Mbreti tha: “Prapë këtë e besojmë! I bekuar qofsh ti dhe Zoti yt”. Ai i kërkoi delegacionit të ikte si dhe i tha muslimanëve që mund të jetojnë në vendin e tij në siguri të plotë për aq sa duan vetë.⁸

Këta shembuj tregojnë se si marrëdhëniet e fuqishme ndër-fetare i mundësojnë të krishterëve dhe muslimanëve të ndihmojnë njëri-tjetrin në nevojë. Muslimanët e hershëm vajtonin bashkë me të krishterët për humbjet e tyre nga Zoroastrianët dhe luteshin për fitoren e tyre. Pastaj, kur muslimanët e vjetër patën nevojë për strehim, sunduesi i krishterë i Etiopisë iu ofroi atë. Në përgjithësi, marrëdhëniet e shëndosha ndër-fetare jo vetëm që mundësojnë mirëkuptimin, por edhe ushqejnë lidhjet e komunitetit si dhe përkrahjen në kohë krizash. Shumë musli-

manë të perëndimit pas 11 shtatorit patën kënaqësinë të gjenin përkrahjen e tillë. Nuk ishte as befasuese që e gjetën, sepse përkushtimi i tyre paraprak ndaj dialogut ndërftetar kishte krijuar ura të forta, të cilat pastaj i kishin shërbyer mirë atyre gjatë kohës kur kishin nevojë për to.

MUHAMEDI NË MEDINË

Kur Muhamedi dhe pasuesit e tij migruan në Medinë, ai bëri ç'mundi që ta bëjë Medinën qytet model të bashkëjetesës paqësore. Kjo nuk qe edhe aq e lehtë, sepse iu desh të pajtonte tri grupe të ndryshme e shpesh edhe armiqësore mes vete:

- Muslimanët: Kurani i quan këta migrues muslimanë Muhajirun (migrues), si dhe ata që kishin pranuar Islam dhe i kishin pranuar këta të parët, Ansar (përkrahësit). Por, fiset Ansar ishin armiqësuar mes vete. Profetit iu desh të krijonte paqen mes tyre, derisa mundohej të vendoste edhe Muhajirun brenda tyre.
- Fiset politeiste: 'Aw dhe Khazraj ishin ndër fiset e shumta që iu faleshin shumë zotave, që jetonin brenda dhe rreth Medinës. Disa ishin miqësorë, e të tjerët ishin shumë armiqësorë ndaj udhëtarëve. Muhamedit iu desh të ndërtonte marrëdhënie me ta për të sjellur paqen në Medinë.
- Fiset hebreike: disa fise hebreike kishin migruar në Medinë, kryesisht nga Siria pas fushatave persekutuese bizantine. Ata kishin marrë veshjet arabe, flisnin arabishten si gjuhë amtare, si dhe kishin mësuar zakonet tjera lokale. Megjithatë, ata kishin ruajtur karakterin e tyre dallues duke mbetur të përkushtuar ndaj trashëgimisë së tyre hebreike. Këto fise ishin të pasur, si dhe kishin ndikim të madh ekonomik në Medinë. I njohur me gjendjen e rrezikuar dhe të pasigurt të muslimanëve në Medinë, Muhamedi më së pari krijoi unitet ndërmjet tyre. Pastaj, me takime me udhëheqësit e fiseve të

ndryshme hebreike e politeiste, i bindi të nënshkruajnë një marrëveshje të përkrahjes dhe mbrojtjes së ndër-sjellë. Disa prej pikave të atij pakti me hebrenjët ishin:

- Të gjithë hebrenjët janë një Umma me muslimanët. Hebrenjët do të ushtrojnë fenë e tyre, ndërsa muslimanët të tyren.
- Hebrenjët do të përgjigjen për shpenzimet e tyre, muslimanët do të përgjigjen për shpenzimet e veta.
- Nëse sulmohen nga një i tretë, secili do të ndihmojë tjetrin,
- Secila palë do të konsultojë palën tjetër, ndërsa marrëdhëniet mes fiseve do të bazohen në drejtësi, si dhe çdo keqbërje përjashtohet plotësisht.
- Asnjëra palë nuk do të bëjë keq në dëm të tjetrës.
- Pala e dëmtuar do të ndihmohet.
- Hebrenjët do të kontribuojnë në shpenzimet e luftës për aq sa luftojnë bashkërisht me muslimanët.
- Medina do të mbetet e sigurt dhe e paprekshme për të gjitha palët nënshkruese të kësaj marrëveshjeje.
- Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve nënshkruese do të zgjidhet nga Allahu, Të Lartit dhe i Dërguari i tij.
- Palët nënshkruese nuk do të bëjnë tregti me Kurejshët dhe nuk do të ndihmojnë fisin në asnjë mënyrë.
- Secila palë do të kontribuojë në mbrojtje të Medinës në rast agresioni nga jashtë, secila në zonën e vet.
- Kjo marrëveshje nuk pengon asnjërën palë nga hak-marrja e ligjshme.⁹

Abd al-Rahman Azzam, Sekretari i parë i Përgjithshëm i Ligës Arabe, i quajtur nga Nju Jork Times si “një prej burrështetaseve të mëdhenj të Islamit bashkëkohor”, shkruante që:

Pakti [ndërmjet muslimanëve dhe hebrenjëve] përbënte marrëveshje për bashkëjetesë paqësore, aleancë mbrojtëse për bashkëpunim kundër agresioneve që kërkonin të mbronin një grup shtetesh të vogla, ku secila palë në bazë të paktit kontrollonte popullin e vet dhe lirinë e ushtrimit të fesë së vet. Nënshkruesit garantonin ndihmën për njëri-tjetrin si dhe mbrojtjen e besimit të tjetrit kundrejt cilitdo

person që kërkonte të dëmtonte tokat dhe njerëzit e tyre. Kështu, ata garantonin lirinë e besimit, por edhe lirinë e fesë së anëtarëve të Paktit, përkundër dallimeve në besimin e tyre.¹⁰

Profeti Muhamed preferonte ndërtimin e marrëdhënieve me hebrej, për shkak të mësimave fetare që lidhin të dy fetë. Kjo është arsyeja pse Kurani i quan hebrejët, por edhe të krishterët, “Njerëz të Librit”. Mes shumë gjërave që të tri fetë kanë të përbashkët, është edhe besimi në Një Zot. Derisa muslimanët duhet të veprojnë për ndërtimin e marrëdhënieve ndërftare me të gjitha grupet fetare, marrëdhëniet fetare me hebrej e të krishterë duhet të kenë përparësi.

DELEGACIONI I KRISHTERË NGA NAJRAN

Populli i Najran, që shtrihej në jug të Mekës në rrugën për Jemen, ishte kryesisht i krishterë. Një ditë, një delegacion prej gjashtëdhjetë udhëheqësish politikë e fetarë nga Najrani kishin shkuar në Medinë për t’u takuar me Profetin Muhamed. Ai dhe pasuesit e tij i mirëpritën, si dhe i lanë të qëndronin në Xhaminë e Profetit. Të trajtuar si mysafirë të veçantë, disa tregime thonë që atyre iu ishte lejuar të faleshin në xhami. Ata folën me Profetin në lidhje me Jezusin që ishte i Biri i Zotit. Si përgjigje, ai recitoi Kuranin, 3:36-64. Biseda miqësore vazhdoi në ditën e dytë, ku palët paraqisnin argumentet e tyre. Pasi që të dyja palët mbetën në pozitat e tyre fillestare, kërkuan nga Zoti të dërgonte mallkimin (mubahilah) mbi palën që ishte gabuar.

Kjo ishte praktikë e zakonshme ndërmjet grupeve apo figurave fetare në atë periudhë; në fakt, ishte mënyra ku Zoti do të “gjykonte” zënkën. Kështu, të dyja palët vendosën që udhëheqësit e të dy grupeve do të dilnin bashkë me familjet e tyre në ditën e nesërme dhe të mallkonin grupin tjetër. Profeti doli me vajzën e tij Fatimah, dhëndrrin e tij ‘Ali, dhe dy nipat al-Hasan dhe al-Husayn. Delegacioni nga Najrani nuk u paraqit, por u tërhoq nga kjo ngjarje, si dhe nënshkroi paktin e paqes.¹¹ Njëra prej shtyllave në Xhaminë e Pro-

fetit, ku grupet ishin mbledhur dhe kishin biseduar, njihet që nga atëherë si as ustana al-vvafud (shtylla e delegatëve). Derisa shumë kujtime janë shlyer nga xhamia, kjo shenjë ende qëndron.

PAKTI I HUDAYBIYYAH

Pas Betejës së Hendekut, jeta politike e Medinës përfundimisht u bë stabile. Fiset arabe, të frikësuara nga kërcënimet e Mekës, bënë pakte të përkrahjes dhe bashkëpunimit me muslimanët. Vitin vijues, Muhamedi donte të bënte 'umrah (haxhin e vogël) në paqe të plotë. Shpejt, ai shpalli qëllimin e tij dhe i kërkoi njerëzve t'i bashkohen. Ai iu tha që pasi që nuk do të kishte luftime, secili do të mbante shpatën në këllëf. Veshur me ihram (rrobet e udhëtarit), rreth 1,400 muslimanë filluan lëvizjen drejt Mekës. Por, kur arritën në Hdaybiyyah, iu thanë që Mekasit nuk do t'i linin të hynin në qytet. Profeti këshilloi njerëzit e tij të përdornin diplomacinë e të zgjidhnin çështjen paqësisht.

Dy palët qëndronin në skaje të kundërta. Mekasit donin të luftonin, e Muhamedi kërkonte paqe. Mekasit u munduan të impononin betejën, duke bërë propozime shumë të rënda. Muhamedi ishte i gatshëm t'i pranonte, për aq sa të shihte një shenjë shprese. Muslimanët ishin të tërbuar kur ai nënshkroi një marrëveshje që ata e shihnin si turpëruese.¹² Megjithatë, kjo marrëveshje është dëshmi e Islamit dhe dëshirës së Profetit për bashkëjetesë paqësore me njerëzit, pa marrë parasysh fenë apo përkatësinë e tyre kulturore. Suhayl ibn 'Amru e nënshkroi marrëveshjen në emër të Mekasve, ndërsa Profeti në emër të muslimanëve. Nenet e saj ishin si në vijim:

1. Nuk do të ketë luftë ndërmjet palëve për dhjetë vjet.
2. Gjatë kësaj periudhe, secili person që i përket dy palëve do të jetë i sigurt dhe i shëndoshë, si dhe asnjëri nuk do ngrrejë shpatën kundër tjetrit.
3. Cilido Kurejsh që shkon në Medinë do të kthehet; nëse ndonjë musliman shkon në Mekë, ai apo ajo nuk do të dërgohet prapa.

4. Fiset e Arabisë janë të lira të hyjnë në marrëveshje me cilëndo palë.
5. Muslimanët do të kthehen në Medinë pa kryer ‘umrah. Vitin e ardhshëm, ata mund të kryejnë ‘umrah si dhe të qëndrojnë në Mekë për tri ditë.
6. Muslimanët nuk do të shkojnë me armë, shpatat do të qëndrojnë në këllëf, ndërsa këllëfet do të qëndrojnë në thasë.¹³

Kjo marrëveshje tregon që Profeti preferonte paqen, edhe me çmimin e mërzitjes së pasuesve të tij të afërt. Ai e dinte që jeta paqësore do t'i mundësonte muslimanëve të dialogonin me ata që nuk ishin muslimanë, të lëviznin lirisht, si dhe të ndërtonin marrëdhënie me fiset tjera. Kjo marrëveshje është shembull i shkëlqyeshëm i një hapi mëtej me të tjerët për të arritur paqen.

PERIUDHA ABASIDË DHE PROMOVIMI I DIALOGUT NDËRFETAR

Edhe pse tashmë i njollosur me gjak, Bagdadi dikur ishte selia e civilizimit të madh. Gjatë pjesës më të madhe të periudhës Abaside (750-1258), popullata e tij ishte etnikisht dhe fetarisht e ndryshme, ndërsa liria e mendimit dhe e shprehjes ishin të zakonshme. Në parathënien e tij të librit “Të krishterët në zemër të sundimit islamik, David Thomas shkruan:

Bagdadi u bë qendër e shoqërisë civile, ku pasuesit e besimeve të ndryshme përziheshin me mirëbesim e liri, ndikimet intelektuale e fetare shtriheshin gjithkrah, ndërsa marrëdhëniet ndërmjet studiuesve, profesionistëve dhe popullatës së gjerë lulëzonin në mënyra që kufizojnë atë paraqitjen e tejtjeshëtuar të mënyrës në të cilën muslimanët i shikonin Zoroastrianët, hebrenjtë e të krishterët.¹⁴

Shpjegimi i Thomasit tregon që gjatë kësaj periudhe, të krishterët ndjeheshin të lirë të debatonin dhe të shoqëroheshin me bashkëbanorët muslimanë në publik. Dëshmi e kësaj mund të jetë edhe tregimi në vijim në të cilin një udhëheqës i krishterë i

quajtur Bariha, bashkë me priftërinjtë tjerë, shkuan të vizitonin teologun musliman Hisham ibn al-Hakim. Hisham raporton këtë ngjarje në njërën prej letrave të tij:

Derisa qëndroja ulur në dyqanin tim në Portën Karakh, ndërsa të tjerët recitonin Kuranin për mua, papritmas u paraqit një turmë të krishterësh, priftërinj e të tjerë, rreth njëqind burra, krejt në të zeza, e me pelerina me kapuç. Mes tyre ishte edhe kryetari Patriark Bariha. Ata ndalën tek dyqani im, ndërsa ulësja ime iu ofrua Barihas. Ai u ul, ndërsa peshkopi dhe murgjit tjerë qëndruan përreth duke u mbështetur në bastunët e tyre, me kapuçat e pelerinës mbi kokat e tyre.¹⁵

Ky incident është me rëndësi, sepse tregon respektin që muslimanët dhe të krishterët kishin për njëri-tjetrin. Të krishterët ishin të lirë të lëviznin, e edhe të hynin në polemika pa frikë. Edhe disa kalifë kishin fituar interes për këto debate teologjike, sepse këto ngjarje bëheshin haptas dhe baras, pa hipokrizi e arrogancë, si dhe kërkonin vetëm të vërtetën. “Të krishterëve iu lejohej liri e plotë për paraqitjen e argumenteve të tyre dhe për të thënë çfarëdo që donin, gjë që e bënin pa dashur të fyejnë këdo në çfarëdo mënyre, siç bëjnë të rëndomtit, injorantët, të pacipët e fesë sonë në diskutimet e tyre.”¹⁶ Autoritetet caktonin një ditë dhe ftonin teologë nga fe të ndryshme për të diskutuar lirisht çështje teologjike. Fryma e këtyre veprimeve ofron një fushë të pasur me informata se si hebrenjët, të krishterët dhe muslimanët ndikonin tek njëri-tjetri gjatë zhvillimit të hershëm të teologjisë.

Kur Bagdadi u vu nën pushtimin musliman, udhëheqësit muslimanë dhe të krishterë shpejt i bashkuan forcat, si dhe si rezultat, përfituan nga aftësitë dhe arritjet e njëri-tjetrit. Peshkopët e krishterë dhe liderët e feve të tjera gëzonin respektin e kalifit. Patriarku nestorian Timothy deklaronte: “Unë pata qasje të drejtpërdrejtë në prani të kalifit.”¹⁷ Vlerësimi i muslimanëve për të krishterët gjatë periudhës abasidë shihet në ngritjen e studiuesve të krishterë si Hunayn ibn Ishaq, i biri i tij Ishaq, si dhe kolegu i tyre Qusta ibn Luqa, që të tre të njohur për përkthimet e teksteve antike në arabisht, për dobi të kalifit dhe fi-

snikëve. Ata dhe shumë të tjerë më pak të famshëm si përkthyes të krishterë gëzonin respektin e duhur dhe kompensimin e drejtë për punën e tyre. Ngjashëm, filozofët muslimanë shpesh qëndronin si nxënës të shkollarëve të krishterë, si në rastin e al-Farabi Yahanna ibn Haylan, dhe Abu Bishr Matti ibn Yunus. Edhe teologët muslimanë njiheshin për konsultimet e tyre me të krishterë kohë pas kohe, si në rastin e 'Abdullah ibn Sa'id ibn Kullab si dhe njëri i quajtur Pethion, i cili takohej në hajatin e kishës në lagjen e Bagdadit Daral-Rum.¹⁸ Gjenerata e parë e të krishterëve arabo-folës, si Theodore Abu Qurrah, 'Ammar al-Basri, dhe Habib ibn Khidmah Abu Ra'ita, ishte thellësisht e angazhuar në qarqet e atëhershme të teologjisë islamike. Në fakt, ata kishin huazuar teknika e koncepte për t'i ndihmuar atyre të artikulonin të kuptuarit e tyre mbi Trininë dhe Mishërimin. Këta teologë njiheshin për argumentimin e tyre inovativ, fryt ky i trajnimit të tyre me homologët e tyre muslimanë. Në anën tjetër, shumë teologë muslimanë studionin Krishterimin dhe Biblën. Megjithatë, në disa vende, studimi i tillë çoi tek mosbesimi dhe kundërtëhëniet, ndërsa "dialogu" mori formën e "demaskimit". Edhe pse marrëdhëniet ndërmjet teologëve në të dyja anët merrnin këtë formë polemike, ndërveprimi në përgjithësi ishte paqësor.¹⁹

Përgjatë gjithë epokës abasidë, të krishterët gëzonin siguri e liri. Këta ishin fizikanë, financierë e sekretarë të krishterë në pallatet e kalifëve dhe guvernatorëve. Ata vishnin të njëjtat rroba, luanin të njëjtat lojëra, e gëzonin shumë nga komoditetet që kishin muslimanët. Ashtu si muslimanët që jetojnë në perëndim përditë e më shumë bëhen perëndimorë në stilin e jetesës, edhe duke i pagëzuar fëmijët e tyre në formë perëndimore, të krishterët që jetonin në kohën e Abasëve ndikoheshin nga kultura dominuese muslimane. Ndikimi u shtri edhe tek kultura artistike. Në studimin e saj të artit abasid, Lucy-Anne Hunt tregon se si artet islamike mund të kenë ndikuar tek mënyrat se si të krishterët dekoronin kishat e tyre. Gjithmonë do të kishte, siç edhe mund të pritët, një pakicë njerëzish që ankoheshin për ndikimin e krishterë mbi kalifatin; megjithatë, ankesat e tilla nuk ndryshonin politikën sunduese.²⁰

Ky ndërveprim mes teologëve dhe fisnikëve të krishterë dhe muslimanë nuk kufizohej tek çështjet fetare. Ata shoqëroheshin, darkonin e këmbenin dhurata mes tyre. Ishte e zakonshme që në Bagdad, teologët dhe fisnikët muslimanë të vizitonin manastiret e krishtera në ditët e festave të krishtera, të merrnin pjesë në shërbesat e krishtera, si dhe të uleshin në tryezë së bashku. Homologët e tyre të krishterë do të bënin vizita të ngjashme në xhami në ditët e festave muslimane. Disa kalifë bile do të vizitonin manastire e të shoqëroheshin me murgj. Kalifët Ma'mun dhe al-Mutawakkil kalonin shumë kohë në manastire, ndërsa Ma'mun admironte liturgjitë e krishtera që ofroheshin aty.²¹

David Thomas, në veprën Polemika e Hershme Muslimane ndaj Krishterimit, shpjegon ndërveprimin mes të krishterëve dhe muslimanëve:

Të krishterët merrnin pjesë në shoqërinë islame për aq sa kishin dobi, si dhe shfrytëzonin të mirat e saj për aq sa mund të arrinin. Ata pasuruan shoqërinë me trashëgiminë intelektuale dhe talentet që sillnin me vete, si dhe idetë që mund të huazonin e mënyra të menduari në të cilat shihnin dobi i pasuronin. Ekzistonte një masë e madhe e diskutimeve e polemikave mbi çështjet e fesë, si dhe lulëzonte literatura polemike në të cilat qëndrimet e ndërsjella paraqiteshin e zhvilloheshin në hollësi e sofistikim.²²

ANDALUZIA DHE DIALOGU NDËRFETAR

Muslimanët dhe hebrenjtë e quajnë Andaluzinë (Spanjën Islami-ke) “epokë të artë” të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërfetar. Spanja ishte bërë pjesë e botës muslimane në fillim të shekullit të tetë. Muslimanët shpejt e kthyen në qendër të civilizimit ndërfetar dhe ndërkulturor. Rezultati ishte lindja e kulturës së parë evropiane vërtet kozmopolitane. Studentët hebrenjë, të krishterë e muslimanë studionin e shoqëroheshin bashkë. Të diplomuarit e shkollave në Kordoba dhe qytete tjera përkthenin veprat klasike greke e romake në arabisht e spanjisht. Për shembull, ata përkthyen veprën e Aristotelit për fizikën dhe historinë e natyrës nga greqishtja në arabisht.

Andaluzia krijoi tri tradita të ndryshme letrare gjatë Mesjetës evropiane. Filozofët dhe shkencëtarët muslimanë zhvilluan njohuritë në mjekësi, optikë, algjebër, kimi dhe shkenca tjera. Studiuesit hebrenjë i dhanë formë traditës së Talmudit, ndërsa Evropa e krishterë dërgonte teologët e saj për të studiuar filozofinë e shkencat tek shkollarët muslimanë e hebrenjë në Andaluzi. Shekulli i njëmbëdhjetë solli Ibn Rushd (Averroes) dhe Maimonides si figura vigane filozofike që kërkonin zgjidhjen për gjoja kundërthënien ndërmjet të vërtetës fetare dhe asaj shkencore.

Akbar S. Ahmed, në veprën “Islami Sot”, citon Uashington Irving, një diplomat dhe shkrimtar të njohur amerikan të shekullit të XIX, për Andaluzinë:

Si pasojë, heroizmi i tyre arrihet vetëm nga moderimi, si dhe që në lindje, për një kohë, ata shquan kombet me të cilat kundërshtoheshin. Të ndarë nga shtëpitë e tyre, ata e donin tokën që iu ishte dhënë, siç thonin ata nga Allahu, si dhe përpiqeshin ta stolisnin me çdo gjë që mund të arrinin për lumturinë e njeriut. Me shtrimin e themelit të pushtetit në një sistem ligjesh të mençura e të barabarta, me kultivimin e kujdesshëm të arteve e shkencave, si dhe me promovimin e bujqësisë, prodhimit e tregtisë, gradualisht ndërjuan një perandori të pakrahasueshme për prosperitetin me perandoritë e krishterimit... Qytetet e Spanjës Arabe u bënë strehë e artizanëve të krishterë, ku ata mësonin zanatet e dobishme. Universitetet në Toledo, Cordova, Seville dhe Granada, kërkoreshin nga gjithë studentët e bardhë nga vendet tjera për t'u njoftuar me shkencat e Arabëve dhe thesarin e njohurive të antikitetit.²³

Shumë studiues evropianë kanë vërtetuar letërsinë e pasur të Andaluzisë dhe ndikimin e saj të gjerë. Njerëzit e Afrikës e quanin “Kopshti i humbur i Edenit”, siç thekson Roger Boase. “Kjo nuk është aspak befasuese”, thotë Boase, spese në Spanjën Muslimane, civilizimi arab kishte arritur një nivel rafinimi artistik e intelektual që nuk ishte arritur tjetërkund. Ky rafinim shprehej më së miri në poezi, arti që qysh para kohës së Islamit ishte shkëlqimi i arabëve. Stili i kësaj poezie do të mund të përshkruhej si Barok dhe eliptik, e nganjëherë edhe i çmueshëm, sepse bazohej në përdorimin e krahasimeve, metaforave e men-

dimeve brenda një sistemi bashkëkohor e strikt, si dhe kornizë tradicionale temash. Poeti ishte artar me fjalët, kërkues i mjeteve folëse për të përshkruar, e kështu edhe përjetësuar, një përshlyetje të rrufeshme të trishtimit apo ëndjes estetike, duke kërkuar gjithashtu që t'i kushtohej nderimi dikujt, të satirizonin një kundërshtar, apo të bënin një vërejtje me shaka.²⁴

Si përfundim, shoqëritë moderne perëndimore duhet të rivedinojnë veten si bashkësi të shoqërisë civile. Periudhat e mëhershme të civilizimit janë në kundërthënie të hatashme me dhunën dhe klientelizmin e kohës moderne. Sot, shoqëritë perëndimore përballesh me probleme të shumta, shumë sosh të krijuara vetë. Në luftën e tyre ndaj terrorizmit të jashtëm dhe kërcënimeve të tij, ata krijojnë vetë disa sfida në mënyrat që thjesht cenojnë vetë themelin e shoqërisë civile. Për shembull, a shohin këto shoqëri me kujdes të mjaftueshëm se si i mbrojnë të drejtat dhe liritë e pakicave të tyre etnike e fetare, e sidomos muslimanët e tyre? E përmbushin ata përgjegjësinë e ruajtjes së lirisë së besimit dhe respektimit të pluralizmit fetar? Cila do të jetë e ardhmja e migrantëve të cilët, duke kërkuar jetë më të mirë, shkojnë në Perëndim? Shumë prej tyre jetojnë në ankth e frikë. A mundet që nocioni humanist i Evropës të qëndrojë kundrejt popullatave që as nuk janë evropiane e as të bardha?

Akbar S. Ahmed ka ngritur këto dhe pyetje të tjera ashtu që të tërheqë vëmendjen e studiuesve perëndimorë tek shembulli i Andaluzisë, ashtu që ata të mund të ripërkufizojnë konceptin e shoqërisë civile. Rreth një milenium më parë, Andaluzia përbënte një shoqëri të civilizuar që inkurajonte dhe përkrahte pluralizmin fetar e etnik, si dhe debatin e lirë. Bibliotekat e shkollat ishin të hapura për të gjithë, arsimimi i lirë lidhej me stimujt e shkëlqimit, banjot e parqet publike ishin të shumta, poezia e arkitektura lulëzonin, e mbi të gjitha, ekzistonte respekti për njerëzimin dhe përpjekjet njerëzore.²⁵ Si përfundoi ky civilizim? Kur Mbreti Ferdinand dhe Mbretëresha Isabella pushtuan Andaluzinë në fillim të 1492-ës, menjëherë urdhëruan hebrenjtë të konvertoheshin apo të braktisnin vendin. Këta urdhra u zbatuan deri në gusht të atij viti, duke përfunduar kështu kulturën he-

breje të Andaluzisë. I njëjti rregull vlente edhe për muslimanët, me rezultate të ngjashme. Një citat vjen nga Thomas Arnold në lidhje me statusin kundërthënës të arabëve të krishterë nën sundimin musliman, duke theksuar, nga këndvështrimi islamik, mesazhin e dialogut ndërftetar dhe domosdoshmërinë e tij:

Po të ishin bërë përpjekje për të konvertuar të krishterët me forcë, atëherë kur u vunë nën sundimin muhamedan, nuk do të ishte e mundur që të krishterët të mbijetonin mes tyre deri në kohën e kalifëve abasidë. Nga ... tolerimi shtrihej drejt arabëve të krishterë nga muslimanët fitimtarë të shekullit të parë të Hixhras, si dhe vazhdonte me gjenerata të njëpasnjëshme, dhe mund të konkludojmë me siguri që ato fise të krishtera që kishin përqafuar islamin e kishin bërë këtë me zgjedhjen dhe dëshirën e tyre të lirë. Arabët e krishterë të ditës së sotme, që jetojnë mu në mes të popullatës muhamedane, janë dëshmia e gjallë e kësaj tolerance. Të krishterët autoktonë sigurisht preferonin sundimin muhamedan kundrejt atij të kryqëzatave, si dhe kur Jerusalemi përfundimisht ra në duart e muslimanëve, popullata e krishterë e Palestinës duket të ketë mirëpritur të zotët e tyre të rinj, si dhe të jenë nënshtruar pa zhurmë e armiqësi ndaj sundimit të tyre.²⁶

KRYQËZATAT DHE SULLTAN SALAH AL DIN AL AYYUBI (SALADIN)

Kryqëzatat, që zgjatën nga viti 1095 deri më 1291, kërkonin të lironin Tokën e Shenjtë të Jerusalemit nga muslimanët. Kryqëzatat brutale e të përgjakshme në të vërtetë “liruan” Tokën e Shenjtë, por duke kryer këtë, ato njollosën rrugët e qyteteve të tyre me gjakun e banorëve të tij muslimanë, hebrenjë e të krishterë. Kjo zgjedhë e tmerrshme nxiti Sulltan Salah al Din al Ayyubin të çlironte Jerusalemin. Por, pasi mundi kryqëtarët, ai u siguria që ata të trajtohen me mirësi. Një tregim thotë që ai e vonoi sulmin mbi një kala ashtu që së pari të kryhej një martesë e planifikuar brenda mureve të saj, para se të binte nën pushtimin e muslimanëve. Si shpërblim për këtë konsideratë e respekt, nëna e nu-

ses i dërgoi ushqim e lule ushtrisë muslimane që kishte rrethuar kështjellën, si racion i tyre në festimin e martesës.²⁷

Edhe pse Kryqëzatat ishin të dhunshme e të përgjakshme, ndërsa marrëdhëniet muslimane-krishtere u përkeqësuan si rezultat i tyre, muslimanët dhe të krishterët, duke qenë të zotuar për bashkëjetesë paqësore, nuk i ndalën përpjekjet e tyre. Edhe gjatë këtyre kohërave të vështira, Sulltani al-Nasir (1062-88), sundues musliman në Afrikën Veriore, dërgoi një prift nga vendi i tij që të vendosej si peshkop, ashtu që nevojat e të krishterëve nën sundimin e tij të plotësoheshin. Papa Gregor VII (1020-85) u impresionua shumë nga kjo vepër bujare, si dhe shkroi një letër me habi, falënderime e vlerësim.²⁸

PERIUDHA OSMANE

Pas periudhës së Mamlukëve, Perandoria Osmane kontrollonte pjesë të mëdha të Lindjes së Mesme, Evropës Lindore dhe disa pjesë të Azisë qendrore, si dhe shtrinte sundimin e saj mbi shumë bashkësi etnike, fetare e kulturore. Administrata e sulltanatit kishte hartuar një sistem të ndërlikuar të udhëheqjes dhe sundimit të këtyre grupeve fetare të ndryshme (e shpesh edhe konfliktuoze). Osmanët e vazhduan traditën e tolerancës së respektit dhe autonomisë fetare të quajtur sistemi i Miletit, si vazhdimësi e konceptit të ahl al-Dhimmah, në traditën muslimane gjatë sundimit të Muhamed Pushtuesit (1451-81) e pas tij. Tri komunitetet fetare jo-muslimane kryesore – hebrejët, Kisha Ortodokse Greke, si dhe Kisha Armene – u vendosën si komunitete (milete) të njohura dhimmi.

Milet është term osman për një pakicë fetare që jetonte në Perandorinë Osmane. Fillimisht, rrjedha nga fjala arabe millah (bashkësi fetare). Secili millet udhëhiqej nga udhëheqësi i vet fetar: Kryerabini për hebrej, si dhe patriarku për komunitetin Ortodoks Grek dhe atë Armen. Secila bashkësi ishte përgjegjëse për mbledhjen dhe ndarjen e tatimeve të veta, rregullimin e arsimit, si

dhe përpunimin e çështjeve ligjore të brendshme për statusin personal, si martesat, divorcet e trashëgimia. Në Lindjen e Mesme para-moderne, identiteti bazohej kryesisht tek feja. Ky sistem funksionoi derisa konceptet evropiane të nacionalizmit dhe etnicitetit depërtuan në Perandorinë Osmane gjatë gjysmës së dytë të shekullit të nëntëmbëdhjetë. Në atë kohë, për shkak të Reformave të Tanzimatit, termi filloi t'i referohej një grupi pakicë etnike dhe fetare të mbrojtur me ligj, ndryshe nga bashkësia sunduese Sunni. Autonomia e tillë nuk ekzistonte në perëndim në atë kohë.

PERIUDHA BASHKËKOHORE

Në kohën tonë, dialogu ndërftetar është rritur, bashkë edhe me rritjen e kontakteve ndërmjet feve të ndryshme. Bota po ndryshon shpejt. Globalizimi e ka bërë të mundur që besimtarët e një feje të jenë indiferentë ndaj besimtarëve të një feje tjetër. I ashtuquajturit “Rend i Ri Botëror” i bën kontaktet ndërftetare e ndërkulturore praktikisht të pashmangshme, sepse televizioni, radioja, librat dhe interneti vazhdojnë të ngushtojnë humnerat që dikur ndanin fetë e kulturat. Po bëhet përditë e më vështirë që grupet fetare, etnike apo racore të jenë të paditur për mësimet dhe praktikat e feve e kulturave të tjera.

Përkundër konflikteve e dhunës së vazhdueshme, shumë bashkësi e individë muslimanë jetojnë në paqe e bashkëpunim me jo-muslimanë. Mediat priren të injorojnë këto storie, ndërsa koncentrohen diku tjetër, tek luftrat e ngjarjet e dhunshme. Megjithatë, kjo indiferencë nuk duhet të frenojë ata që janë të përkushtuar ndaj dialogut ndërftetar. Dialogu ndërftetar është mjedis i përkryer jo vetëm për ushqimin e marrëdhënieve pozitive e konstruktive mes muslimanëve e të tjerëve, por edhe për zgjerimin e tyre jashtë vendit, duke mundësuar që marrëdhëniet e tilla të jenë modeli i ndërveprimit.²⁹

Një model i tillë bazohet në një ngjarje të jetës së Shën Francis të Assisit. Kur Shën Francis arriti në Damietta (Egipt) gjatë

Kryqëzatës së Pestë, ai pa me agoni shkatërrimin e bërë nga Kryqëtarët. Kur u takua më vonë me Sulltanin al-Kamil, sundimtar lokal musliman, u habit që sulltani e priti me njerëzi dhe e trajtoi mirë. Ricoldo de Monte Croce nga Rendi Assisi kaloi rreth njëzet vjet udhëtime përgjatë gjithë Lindjes së Mesme, si dhe shkroi një tregim mjaft impresiv të marrëdhënieve të tij të mira si dhe takimeve miqësore me muslimanë.³⁰

Pak pas fitimit të pavarësisë nga sunduesit e tyre kolonial, shumë vende muslimane kërkonin marrëdhënie më të mira me të krishterët që jetonin mes tyre. Përfaqësuesit e secilës fe të vendit takoheshin në konferenca të dialogut ndërfeetar. Një konferencë e tillë e krishterë-muslimane u mbajt në Tripoli (Libi) më 1-5 shkurt 1976. Kjo ngjarje u organizua në bashkëpunim me qeverinë libiane dhe u bashkë-organizua me Vatikanin. Delegatë të krishterë e muslimanë nga e gjithë bota morën pjesë në konferencë, e në fund, nxorën nja deklaratë të përbashkët me 24 pika. Si shenjë e vullnetit të mirë, Kisha Katolike në Bengazi u rihap më 8 dhjetor 1977. Studiues muslimanë e të krishterë nga Afrika, Lindja e Mesme, e vende të tjera ishin ftuar në ceremoni. Kjo konferencë shënoi një hapje të madhe të marrëdhënieve muslimano-kristiane. Ministrat e punëve të jashtme nga Organizatave e Shteteve Muslimane (OIC) miratuan deklaratën në takimin e tyre në Stamboll më 12-15 maj 1976.³¹

Në vijim është dhënë një listë e pjesshme e studiuesve muslimanë që luajtën role kryesore në promovimin e dialogut ndërfeetar gjatë shekullit të njëzetë: Isma'il R. al-Faruqi, Jamal Barzinji, Iqbal J. Unus, Muhammad Abdul Raouf, Naim Akbar (Shtetet e Bashkuara); Sheikh Ahmad M. Zabara (Jemen); Ali Arslan Edin dhe Youssef Daa (Turqi); Mahmoud Albaji (Tunizi); Sheikh Hasan Khattab (Siri); Soulainman Aboubakr (Afrika e Jugut); Othman Shahin dhe Husein Muhammad Karibulla (Sudan); Ali Ahmad Hasan (Somali); Ibrahim Kazem (Katar); Khurshid Ahmad dhe Zafar Ishaq Ansari (Pakistan); Ahmad Shahati (Libi), Vvahid Iddin Khan dhe Izziddin Ibrahim (Emiratet e Bashkuara Arabe); Muhammad Ahmad Khalafalla dhe Mustafa Mahmoud (Egjipt); Sibgatallah al-Mujaddidi (Afganistan); Naquib al-Attas

(Malajzi); si dhe Jamal Badavvi (Kanada). Organizata e studiuës muslimanë përgjatë historisë gjithmonë kanë përkrahur dialogun ndërftetar. Të gjitha organizatat e mëdha muslimane në Perëndim e bëjnë këtë, përfshirë këtu Shoqërinë Islamike të Amerikës Veriore (ISNA), Qarku Islamik i Amerikës Veriore (ICNA), Misioni Musliman i Amerikës (MMA), Shoqëria Muslimane e Amerikës (MAS), si dhe Këshilli për Marrëdhënie Amerikano-Muslimane (CAIR).

Shekulli 21 paraqet sfida të reja e të vështira për muslimanë. Në njërën anë, shumë forca brenda mediave perëndimore janë përkushtuar ndaj etiketimit të muslimanëve si terroristë, si dhe përdorimit të ekspertizës teknike për të nxitur paragjykimin. Në anën tjetër, popullata muslimane është në rritje. Përkatësisht, Islami po lind si forcë në një shoqëri që ka pak ekspozim ndaj larmisë fetare. Perëndimi po del si rajon i shumë feve, në të cilat grupet e ndryshme etnike e racore po mundohen të jetojnë bashkë në paqe. Në reagim ndaj kësaj larmie në rritje, në të cilën janë pjesë e konsiderueshme, muslimanët duhet të jenë më proaktivë në nxitjen e dialogut ndërftetar. Ata duhet të bëhen flakadanë të dialogut, duke fituar zemrat e mendjet e njerëzve si paqebërës. Imamët, liderët fetarë e mendimtarët, të gjithë duke u mbajtur fort pas parimeve islamike të dialogut, duhet të bëhen liderë të ndërtimit të paqes botërore. Shpresojmë që ky doracak do të ju ndihmojë atyre në perceptimin e asaj se si Islami po del sërish në skenën botërore si kuadër i paqes, drejtësisë e dialogut.

Në kapitullin e radhës, do të paraqesim një rast të tillë studimi të ndërtimit të paqes nga Roçester, Nju-Jork, si dhe do të trajtojmë disa prej përpjekjeve që janë nisur nga muslimanët e Shteteve të Bashkuara për të promovuar jetesën paqësore dhe mirëkuptimin e ndërsjellë përmes dialogut ndërftetar.

PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT

- Profeti Muhamed bënte çdo gjë që mundte për të ndihmuar e ushqyer komunitetin e tij të ri, të përfronte dallimet mes anëtarëve të bashkësisë, si dhe të ruante mirëbesimin kundrejt kundërshtimeve nga Meka, torturës e keqpërdorimeve të tyre. Kurdo që udhëheqësit e Mekës shkonin për të biseduar me të, ai i dëgjonte me vëmendje e respekt, e pastaj e shtrinte argumentin e tij në mënyrë të sjellshme.
- Në Medinë, Profeti vepronte si shef i shtetit. Në këtë pozitë, ai ndërtoi një konfederatë besimesh që përfshinte hebrenjtë, të krishterët, muslimanët dhe paganët. Qëllimi i tij ishte që të gjente një mënyrë ku secili do të jetonte në paqe së bashku. Nuk kurseu asnjë përpjekje për të arritur marrëveshje me fiset fqinje, e edhe me ato të Mekës, kurdo që kishte mundësi për këtë.
- Muhamedi gjithmonë propagonte parimet islame të faljes dhe mëshirës për të përfruar dallimet ndërmjer individëve, brenda familjes, e edhe brenda bashkësisë së vet e fiseve të armiqësuar.
- Shumë sundues e imamë muslimanë kanë pasur role të rëndësishme në zgjerimin e dialogut ndër-fetar nga origjina e tij ndërmjet pjesëtarëve të besimeve ibrahimike e deri tek hindutë, budistët e të tjerët që eventualisht shtriheshin nën sundimin musliman.
- Shumë muslimanë kanë luajtur role kyçe në nxitjen e dialogut ndër-fetar, edhe gjatë Kryqëzatave e Kolonizimit perëndimor, ditëve më të këqija të historisë muslimane. Derisa gjithmonë kundërshtonin okupimin politik, këta muslimanë asnjëherë nuk u ndalën në dialogun e tyre me fetë tjera.
- Në vazhdimësi të këtyre traditave vërtet islame, organizatat qendrore muslimane në Perëndim, e

edhe shumë organizata e parti politike islame në botën islame, përkrahin dialogun ndërftetar si dhe atë mes feve të ndryshme.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. A dini për ndonjë shembull të rëndësishëm të dialogut nga jeta e Profetit që nuk është përmendur në këtë doracak? Nëse po, shtojeni në listë.
2. Jeni përballur me ndonjë vepër të rëndësishme gjatë epokës klasike të Islamit për dialogun ndërftetar, apo ndonjë tregim të përballjeve të tilla, të cilat mendoni që duhen shtuar këtu si referencë?
3. Në listën tonë shumë të ngushtë të shumë mendimtarëve muslimanë që kanë marrë pjesë në dialogun ndërftetar gjatë shekullit të njëzetë, mos mungon ndonjë individ i rëndësishëm?
4. Jeni të njohur me pasqyrimet biblike të hebrenjve e të krishterëve që ilustrojnë besimet e tyre për pluralizmin?

KAPITULLI V

BESIMET IBRAHIMIKE: RAST STUDIMI NGA PËRVOJA E ROÇESTERIT

NEVOJA PËR DIALOG

Nga perspektiva historike, muslimanët kanë ndikuar në kulturën dhe civilizimin perëndimor për më shumë se një milenium. Përkundër këtyre, për shumë shembuj, kultura perëndimore s'kishte shumë ndikim në botën muslimane. Kundrejt kësaj, ajo përfitoi shumë nga "Iluminizmi Islam" në të gjitha fushat kulturore dhe shkencore. Dr. Hans Koechler, në veprën e tij të quajtur "Lidhjet muslimano-krishtere në Evropë: E kaluara, e tashmja dhe e ardhmja," krahason hollësisht civilizimin e krishterë të Evropës me civilizimin islamik gjatë këtyre shekujve. Sipas tij, civilizimi islamik ishte larg më i rafinuar e i ndriçuar. Muslimanët që të krishterët i gjetën gjatë Kryqëzatave dhe më pastaj zgjuan Evropën nga "gjumi dogmatik" dhe ndihmuan evropianët të bënin hapa drejt krijimit të një botëkuptimi më të ndriçuar, racional e jo-dogmatik. Pa marrë parasysh nëse vjen nga "Biblioteka e Madhe e Evropës" në Toledo (Andaluzi) apo institucione të ngjashme, Islami pati ndikim të madh në Perëndim. Më 1130, shkolla e përkthimit në Toledo kishte tërhequr studentë e kërkues nga e gjithë Evropa. Kjo shkollë mbante vulën e ndikimit musliman.

Marrëdhëniet muslimano-kristiane u përkeqësuan gjatë periudhës së hershme moderne, sepse Perandoria Osmane dhe fuqitë perëndimore u barrikaduan në mosbesim të ndërsjellë. Të pakënaqur me denigrimin e ndikimit pozitiv të civilizimit islamik tek civilizimi evropian, e edhe kontributit në të, Evropa Perëndimore provoi të demonizonte vetë karakterin e Islamit.

Me përparimin e kolonializmit, marrëdhëniet e Evropës perëndimore me muslimanët u prirën më tutje drejt dominimit politik dhe “tutelës kulturore”. Karakterizimi negativ i islamit vazhdoi me diciplinën akademike të “Orientalizmit”, që ka rrënjë në këtë qasje apologjetike kristiane, që e ka bërë doktrinën e krishterë më superiore kundrejt “herezisë” së supozuar islami-ke. Filmata holivudianë, si dhe mediat elektronike e shtypi, kanë luajtur rol në rritje në përforcimin e shtrembërimeve të tilla.

Sot, bashkësitë muslimane në perëndim shpesh portretizohen si kërcënim ndaj kohezionit socio-kulturor të perëndimit. Ekzistenca e bashkësive të konsiderueshme muslimane në rajon ka çuar në reagime përditë e më armiqësore në anën e perëndimorëve. Së pari, mediat elektronike dhe të shtypura i kanë vetëdijësuar njerëzit që numri i muslimanëve po rritet. “Kishat janë të zbrazëta, ndërsa xhamitë të plota”, është frazë e kapshme që shpesh është përdorur për të mbjellur frikë e mosbesim. Pastaj, ndodhi incidenti tragjik i 11 shtatorit, pasuar me bombat në Madrid dhe Londër. Të gjitha këto fatkeqësi kanë përforcuar stereotipizimin e zakonshëm të Islamit dhe muslimanëve në mendjen kulturore popullore të perëndimit. Për më tepër, bashkësitë muslimane dyshohen të jenë aleatë potencialë të “Islamit të ri militant”, i cili perceptohet të jetë kërcënues ndaj identitetit kulturor të perëndimit.¹

Si pakica fetare dhe kulturore, muslimanët në perëndim janë duke përjetuar kohëra të këqija për shkak të këtij stereotipizimi dhe poshtërimit të vazhdueshëm. Megjithatë, edhe përkundër këtyre sulmeve, ata nuk kanë qenë pasivë. Në vend të kësaj, kanë ndërmarrë përpjekje të fuqishme dhe kanë investuar energjitë e tyre në kundërshtimin e këtij demonizimi. Është e qartë që ka nevojë për më shumë përpjekje, e më shumë investim.

Këtu është momenti ku hyn dialogu ndërfeetar, sepse ky aktivitet mund të luajë rol të fuqishëm duke iniciuar programe komunitare të dobishme për mirëqenien e përgjithshme dhe të promovojë drejtësinë sociale dhe të drejtat civile.

Fatmirësisht, shumë kisha kundërshtojnë stereotipizimin e tillë anti-musliman. Në vend të tij, ato kërkojnë të ndërtojnë marrëdhënie të mira me muslimanët. Në orët e tyre të mësimt me të rritur, të krishterët lexojnë për islamin dhe fetë tjera. Shumë grupe kishtarë vizitojnë xhamitë si pjesë kyçe të mësimave të tyre. Ata fascinohen dhe impresionohen kur i shohin muslimanët të falen në devotshmërinë e tyre. Shumë kisha ofrojnë mësim për Islamin dhe vizita studimi në xhami brenda kurrikulave të tyre për konfirmimin e rinisë. Adoleshentët dhe të rinjtë shprehin interesim të vërtetë në të kuptuarit ndërfeetar, si dhe kërkojnë të bashkohen me kolegët e tyre muslimanë në projekte të ndryshme të drejtësisë sociale. Në nivelet më të larta organizative, atë të këshillave kishtarë, dioqezave katolike dhe peshkopatave, si dhe organizimeve tjera kishtarë – ekziston interesim i çiltër për ndërtimin e urave të dialogut me muslimanë.

Megjithatë, përkundër këtyre përpjekjeve të vlefshme, edhe kundërshtimi është në rritje në radhët e disa të krishterëve. Krahu i djathtë konservativ evangjelist është shumë kundër dialogut ndërfeetar, sidomos me muslimanë. Sipas disa evangjelistëve, të krishterët që hyjnë në dialog ndërfeetar me “të pabesët” muslimanë janë vetë “të pabesë”. Por, tendenca të tilla të frikësimit apo gjykimit ngjajnë në secilin grup besimi.

Pa marrë parasysh kërcënimet aktuale, pjesëmarrja në çdo lloj dialogu ndërfeetar, i cili çon drejt mirëkuptimit dhe respektimit të njerëzve, është urdhër i Allahut. Kështu, menjëherë pas vendosjes në cilindo vend të krishterë, muslimanët gjithmonë i janë afruar miqësisht fqinjve të tyre, si dhe me qëllimin e jetesës në paqe e ndërtimit të marrëdhënieve të fuqishme ndërfeetare me ta. Në situata të tilla, muslimanët duhet të jenë të gatshëm të marrin përsipër keqbërjet e kaluara që i janë shkaktuar të krishterëve. Këtë mund ta bëjnë duke ditur që homologët e tyre të krishterë shpesh edhe e bëjnë të njëjtën gjë.

Përkundër vështirësive dhe sfidave, periudha në të cilën po jetojmë sot mund të shihet si mundësi për ndërtimin e marrëdhënieve paqësore. Por, ne muslimanët duhet të jemi të kujdesshëm që të shrytëzojmë atë mundësi, e të mos e kthejmë në garë. Një shembull i keqpërdorimit të kësaj mundësie ndodhi së voni, kur gjatë një dialogu ndërftetar Islam-Krishterim, një musliman i tha imamit: “Dua t’i konvertoj të gjithë në Islam. Më lini të flas”. Megjithatë, siç u tha më lart, dialogu ndërftetar nuk përbëhet nga predikimet, debatimet apo konvertimet, por prej ndërtimit të marrëdhënieve për bashkëjetesë paqësore.

Takimi me muslimanë dhe përfshirja e tyre në familjen e racave e feve me të drejta e detyrime të barabarta për të gjithë është përvojë e re për shumë pjesëtarë të shumicës së bardhë të krishterë të perëndimit. Si rezultat i një pasigurie të tillë, si dhe lidhur kjo me frikën e krijuar pas 11 shtatorit, fanatizmi dhe ksenofobia janë rritur. Përkundër këtij reagimi negativ, grupet fetare si Kisha Katolike dhe shumë denominime protestante me kurajo demonstrojnë gatishmërinë e tyre për dialog dhe bashkëjetesë paqësore. Ata vazhdojnë të mbajnë qëndrimin edhe me koston e humbjes së shumë anëtarëve të tyre tek kongregatat e djathta kristiane.

Pa marrë parasysh vështirësitë, dialogu ndërftetar, i diskutuar në kapitullin II, duhet trajtuar me të drejtë e paanësi, e me respekt për të gjithë. Pra, kur përfaqësuesit muslimanë bindin homologët e tyre të krishterë të bashkohen në seminarë e programe të përbashkëta publike për kuptimin e Islamit, duhet të jenë të kujdesshëm që as të mos japin përshtypjen e predikimit ndaj audiencave të tyre. Përshtypja e tillë shkatërron dialogun. Këta seminarë duhet të adresojnë edhe besimin e krishterë edhe atë musliman, si dhe të ofrojnë një pamje krahasimtare të secilit, pa provuar të gjykohet ndërmjet të dyjave. Dy folës të përgatitur për dialog, prej secilit besim, duhen zgjedhur paraprakisht. Nëse është e mundur, ata duhet të takohen paraprakisht, ashtu që të njohin njëri-tjetrin, si dhe të vendosin për një qasje koherente. Nëse partneri i krishterë sugjeron që seminari të jetë vetëm për Islamin, atëherë ndoshta do të nevojitet vetëm folësi musliman.

Nëse muslimanët provojnë të iniciojnë një seminar për Islamin, mund të përballen me rezistencë. Në disa raste, partnerët e krishterë janë ankuar mbi atë që e shohin si qëndrim tejet kategorik i muslimanëve. Disa edhe braktisin dialogun me atë përshtypje.

DIALOGU HEBRE-MUSLIMAN

Muslimanët dhe hebrenjtë kanë gëzuar një Rilindje të shquar kulturore në Andaluzi, ndërmjet shekullit të dhjetë dhe të dymbëdhjetë. Hasdai ibn Shaprut shërbente në gjykatën e Kalifit 'Abd al-Rahman III të Kordobës. Me inkurajimin e Hasdait, poetët e mendimtarët hebrenjë vërshuan drejt Andaluzisë nga e gjithë bota, e filluan një epokë të re që do të njihej në historinë hebrenje si "Epoka e Artë e Andaluzisë". Nën osmanët, hebrenjtë jetonin në paqe e prosperitet. Për shtatëqind vitet e kaluara, që prej pushtimit të Bursas më 1326 dhe mirëpritjes së ngrohtë të hebrenjëve sefardikë të përzënë nga Spanja e deri sot në Turqinë moderne, komuniteti hebre ka jetuar bashkë me muslimanët në paqe e siguri. Kur Stambolli ra nën pushtimin e osmanëve më 1453, Sulltan Mehmeti II emëroi Moshe Kapsalin si Kryerabin të Stambollit, ashtu që komuniteti hebre të jetonte në paqe e të praktikonte besimin e tyre me dinjitet. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Turqia vazhdoi të shërbente si kalim i sigurt për hebrenjtë që iknin nga tmerret e nacizmit. Në Muzeun Hebre të Stambollit, ka dokumente e dëshmi mbi jetesën paqësore të të dy bashkësive që prej periudhës osmane.²

Prapë, sot, ka një largësi keqkuptimi ndërmjet bashkësive muslimane e çifute. Konflikti Izrael-Palestinë ka krijuar mosbesimin dhe ndjenjë hidhërimi, ndërsa dialogu ka vuajtur si rezultat i kësaj. Megjithatë, shumë rabinë të Reformës, e edhe ata Konservativë, kanë vullnet të dialogojnë me muslimanë. Muslimanët duhet ta inkurajojnë këtë mendje të hapur, sidomos në vigillie të 11 shtatorit, për arsye të ndryshme. Më së pari, kur

kërkojnë të dialogojnë me bashkësinë hebreje, muslimanët përçojnë mesazh të fuqishëm që nuk ngurrojnë të ndërtojnë marrëdhënie, edhe me ata me të cilët kanë diferenca të mprehta. Së dyti, ndërtimi i koalicioneve me liderë komuniteti hebreik mund të rezultojë me dobi politike. Megjithatë, kjo arsye nuk duhet perceptuar si oportuniste, sepse me realitetin ekzistues në perëndim, është edhe pragmatike edhe realiste. Së treti, pasi që hebrenjtë janë pjesëtarë të komunitetit fetar ibrahimik, muslimanët kanë detyrim fetar që të afrohen me ta. Së katërti, tradita e pasur historike e marrëdhënieve të forta e të frytshme hebreike-muslimane nuk duhet harruar. Afërsia e të dy grupeve në besimet e tyre për Zotin dhe në shumë praktika fetare jep arsye të mëtutjeshme për dialog. Së pesti, muslimanët i njohin profetët biblikë si profetë të Islamit. Të kuptuarit e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet portretizimit të tyre në Dhjatën e Vjetër dhe në Kuran do të mund të ishin temë e mirë për dialog të suksesshëm, dialog që do të mund të çonte drejt mirëkuptimit më të thellë të Hebreizmit e Islamit. Së gjashti, muslimanët dhe hebrenjtë ndajnë së bashku përvojën e jetesës si pakica në perëndim. Jo shumë më parë, hebrenjtë kishin provuar persekutimin katastrofik nën duart e shumicës së krishterë evropiane. Ata kanë vuajtur më pak të këqija të tilla në Shtetet e Bashkuara, por prapë përballen me diskriminim. Nën hijen e 11 shtatorit, muslimanët i janë nënshtruar diskriminimit në rritje. Të dy bashkësitë do të mund të përfitonin nga dialogu për të folur me njëri-tjetrin mbi përballjen me diskriminimin.

Por, përtej asaj që mund të përfitohet nga dialogjet, muslimanët e hebrenjtë kanë rol të përbashkët për krijimin e një bote më paqësore. Dialogu i suksesshëm ndërmjet dy bashkësive dhe marrëdhëniet e mira eventualisht do të kontribuonin në zgjidhjen paqësore të konfliktit Izrael-Palestinë. Vizioni i tillë nuk është i pamundur siç mund të duket. Mendojeni të ndjerin Rabin Judea Miller të Tempullit të Roçesterit B'rith Kodesh. Pjesëtar aktiv i Forumit Ndërfetar të qytetit, Rabini Miller ishte shumë i interesuar për ndërtimin e urave e marrëdhënieve më të mira ndërmjet dy komuniteteve. Përkatësisht, Komuniteti Reformues He-

breik i Tempullit B'rith Kodesh dhe Qendra Islamike bashkuan fuqitë për të promovuar shumë aktivitete, sidomos gjatë krizës në Bosnjë. Një prej këtyre aktiviteteve shquhet: një darkë e përbashkët për grumbullim fondesh për viktimat e luftës në Bosnjë, e mbajtur në sinagogë më 1993. Shumë njerëz u bashkuan, përfshirë edhe përfaqësuesit shtetërorë dhe federalë. Për herë të parë në sinagogat e Roçesterit, adhan (thirrja për adhurim) ishte bërë ndërsa muslimanët ishin falur në kongregatë. Kjo me të vërtetë qe ngjarje historike. Rabini Miller, lider i njohur i komunitetit reformues hebreik kishte kaluar shumë kohë e përpjekje në ndërtim të marrëdhënieve të mira. Ai ishte edhe njeri modest e spontan. Nganjëherë, ai vinte në Qendrën Islamike pa lajmëruar fare nëse kishte një ide të re. Në një rast, ai e kishte thirrur Imamin Shafiq në shtëpi nga aeroporti, për të shprehur dhimbjen për një incident në të cilin një hebre i lindur në Amerikë kishte hapur zjarr mbi muslimanët në lutjet e një Xhamie në Hebron. Ai i kërkoi imamit që të thirrin një konferencë të përbashkët shtypi ditën e nesërme për të dënuar incidentin. Qendra ishte mbushur plot me media e liderë komunitetesh në të dyja anët e konfliktit Izrael-Palestinë. Gjatë konferencës së shtypit, Rabini Miller e kishte quajtur sulmuesin mashtrues, tradhtar të besimit hebreik. Ai kërkoi nga Tel-Avivi dhe hebrejët që të merreshin me atë tradhti.

SFIDAT AKTUALE NDËRMJET PJESËTARËVE MUSLIMANË NË DIALOG

Dialogu ndërftuar është përvojë e re edhe për shumë muslimanë. Disa muslimanë janë shumë të ditur për Islamin, por shumë të ngurtë në qasje; të tjerët janë shumë të interesuar për dialogun, por kanë njohuri të pakët për Islamin. Kështu, pjesëmarrësit muslimanë kanë nevojë për trajnime intenzive para se të kenë mundësi të luajnë rol efektiv në një dialog të dizajnuar për të përmirësuar imazhin e përgjithshëm të tyre, si dhe të

thellojnë mirëkuptimin për Islamin tek pjesëmarrësit jo-muslimanë.

Në përgjithësi, cilido dialog i muslimanëve me të krishterët e hebrenjët përballet me disa sfida madhore. Sfida e parë është ajo e numrave. Përfaqësuesit muslimanë janë gjithmonë më të paktë në numër sesa jo-muslimanët. Ka disa shpjegime për këtë: organizatorët shpesh e kanë të vështirë të angazhojnë bashkësinë muslimane, muslimanët vijnë nga kultura në të cilat dialogu i tillë është i panjohur apo dekurajohet, ose në të cilat mundësitë për pjesëmarrje publike të tillë janë të kufizuara. Në fakt, shumë muslimanë në përfundim luftojnë për mbijetesë themelore, ndërsa liderët fetarë priren të anojnë më shumë kah aktivitetet brenda komunitetit.

Sfida e dytë ka të bëjë me vetë dialogun. Pjesëmarrësit muslimanë shpesh nuk i kuptojnë plotësisht parimet dhe udhëzimet përkatëse. Kjo mund të shpjegohet me faktin që pak, nëse ka, sisteme të arsimit formal islamik ofrojnë planprograme që përfshijnë qasjen islamike ndaj dialogut ndërftetar. Pjesërisht, domosdoshmëria socio-ekonomike dhe mungesa e resurseve janë arsye të kësaj mungese. Përveç këtyre, shumica e institucioneve arsimore islamike theksojnë qasjen apologjetike (defanzive apo ofanzive) në trajtimin e feve tjera. Në të dyja rastet, qëllimi është të fitohet debati dhe të vërtetohet superioriteti i Islamit. Rezultati fatkeq është që shumë muslimanë dinë pak, ose aspak, për burimet e pasura islamike dhe historinë e dialogut ndërftetar. Megjithatë duhet theksuar që kjo situatë nuk vlen vetëm për muslimanët dhe sistemet e tyre arsimore. Sistemet e krishtera dhe hebreike vuajnë nga e njëjta qasje apologjetike ndaj të njohurit të “tjetrit”. Si rezultat, edhe pasuesit e tyre arrijnë në dialog jo të gatshëm për të mësuar, apo për të ndërtuar marrëdhënie më të mira, por për të vërtetuar superioritetin e fesë së tyre.

Sfida e tretë rezulton nga mosgatishmëria e liderëve fetarë në komunitet për të nisur rrugën e dialogut. Imamët dhe ekspertët e Islamit rrallë marrin pjesë në takime ndërftetare. Një prej hapave të parë për t'i inkurajuar ta bëjnë është që të tejkalohen disa prej sfidave të brendshme përmes dialogut bren-

da-musliman, trajnimit më të mirë për imamë, si dhe përafrimit me komunitetin. Siç është përmendur më herët, pjesëmarrja e këtyre njerëzve do t'i shërbente më mirë kauzës së islamit.

Sfida e katërt lind nga asimetria. Shumica e grupeve ndërfe-tare iniciohen, ndërtohen dhe financohen nga liderë e instituci-one jo-muslimane. Si rezultat, pjesëmarrja muslimane priret të jetë simbolike, ndërsa kontingjenti musliman e gjenë veten të papërgatitur të ofrojë ndonjë kontribut thelbësor. Në fakt, në shumë raste përfaqësimi musliman i shtohet pasi i gjithë pro-grami të jetë hartuar plotësisht. Pjesëmarrja e tillë për sy e faqe dëmton efektin potencial që dialogu ndërfe-tar mund të ketë në mirëqenien e të gjitha komuniteteve në fjalë. Kontributi dhe pronësia simetrike e procesit të dialogut janë të domosdoshme për një program të suksesshëm dhe efektiv. Sfida e pestë del nga fakti që bashkësitë muslimane shpesh nuk kanë trajnerë e mo-deratorë profesionalë për dialog ndërfe-tar. Kështu, lideri apo moderatori i programit shpesh është jo-musliman që nuk ka rrë-një në traditën islamike. Kjo dobësi që në fillim e zvogëlon kohe-rencën dhe atraktivitetin për muslimanët. Kur ka moderator të aftë musliman, komuniteti do ta shohë grupin e dialogut ndërfe-tar me më shumë besim.

Tejtheksimi i rezultateve konkrete përbën sfidën e gjashtë. Mungesa e rezultateve të tilla mund të dekurajojë pjesëmarrjen e muslimanëve. Për shkak të situatës së vështirë ekonomike dhe politike të shumë muslimanëve, ata priren të kenë më shumë interes për ndryshime konkrete të sjelljes dhe strukturës së si-stemit. Kështu, disa e shohin dialogun ndërfe-tar që fokusohet vetëm tek trajtimi i besimeve si humbje kohe. Rrjedhimisht, ata që marrin pjesë në ngjarje të tilla gjithmonë duhet të theksojnë agjenda specifike dhe rezultate konkrete, për të tejkaluar dyshi-met e ngurrimet e tilla. Përveç këtyre, duhet gjithmonë të hu-lumtohet se si do të përfitojë komuniteti nga procesi i propozuar i dialogut.

BESIMET IBRAHIMIKE: SHEMBUJ BASHKËKOHORË TË DIALOGUT NDËRFETAR

Pasi të jenë edukuar për parimet themelore të dialogut ndërftetar, imamët dhe liderët tjerë të bashkësisë muslimane duhet të sigurojnë takime të suksesshme ndërftetare si dhe dialog brenda-musliman, duke krijuar një grup dialogu me deklaratë të qartë misioni, me themelimin e komisioneve të planifikimit, si dhe me zgjedhjen dhe zbatimin e modeleve të duhura të programit.

Dokumentet dhe deklaratat e misionit: shumë kisha janë të etura të hyjnë në dialog ndërftetar. Mund të ketë dy nivele dialogu: dialogu formal dhe institucional (gjegjësisht, me grupe si dioqeza lokale katolike apo peshkopata, këshilli i kishës, apo organizata të tilla) si dhe dialogu komunitar me kishën lokale. Muslimanët mund të fillojnë procesin duke ftuar grupin e synuar në drekë apo darkë, ose duke vizituar atë grup në objektin e kultit, apo ndonjë objekt tjetër që ata zgjedhin. Në fillim të dialogut formal, do të ketë nevojë të hartohen deklarata e qëllimit dhe rregullat e brendshme. Ky lloj dialogu duhet mbajtur me kujdes, si dhe me konsideratën e duhur për procedurat, hollësitë e synimet.

Përcaktimi i qëllimeve është tejet i rëndësishëm. Suksesi i përpjekjeve ndërftetare në Roçester i kushtohet, pjesërisht, përzgjedhjes së kujdesshme të qëllimeve. Shumica e programeve të tyre kufizohen tek avancimi i lidërshiptit. Rrjedhimisht, Forumi ndërftetar rrallë mundëson programe edukative publike. Në anën tjetër, Qendra Islamike e Roçesterit mundohet të krijojë programe edukative ashtu që muslimanët dhe të krishterët të mund të takohen dhe të mësojnë nga njëro-tjetri dhe të shkëmbejnë qëndrimet e tyre. Në përgjigje të përpjekjeve të tilla, Ati Gordon Vvebster i Kishës Presbiteriane, anëtar aktiv i Forumit Ndërftetar, si dhe disa anëtarë muslimanë, më 1993 vendosën të krijojnë një Komision për Marrëdhënie Kristiano-Muslimane (CCMR). Që prej themelimit, ky komision ka bërë punë të mrekullueshme të ndërtimit dhe mbajtjes së programeve të përafritmit me të gjithë komunitetin e Roçesterit. Seminarët dhe aktivitetet

tetet tjera ndiqen nga më shumë se 250 njerëz. (Shih Shtojcën II për deklaratën e misionit të Komisionit dhe Rregulloret).

Krijimi i grupit formal të dialogut me deklaratë të misionit kërkon shumë punë, e edhe partnerë të dedikuar e me vullnet për të përkushtuar kohën e energjinë e tyre. Ky grup duhet të ketë deklaratë misioni që shpjegon qartë rregullat se si të tërhiqen anëtarë të rinj. Bashkimi i vullnetarëve të rinj është thelbësore, sepse nuk është realiste të pritët që vullnetarët të qëndrojnë të angazhuar për periudha të gjata. Kështu, edhe detyrimet e liderëve fetarë ndryshojnë kohë pas kohe. Mund të ketë edhe pengesa tjera. Për shembull, për muslimanët në Amerikë, shumë xhami nuk kanë imamë, ndërsa ato që edhe mund të kenë imamë, nuk janë të rrjedhshëm në anglisht, apo që ngurrojnë të marrin pjesë. Dialogu formal merr forcën nga institucionet dhe bazohet tek përkrahja publike, pra të dyja janë esenciale që dialogu të arrijë qëllimet e tij. Por, shumë njerëz brenda bashkësive muslimane ngurrojnë të ofrojnë përkrahje institucionale për dialogun ndër fetar. Pasi që kjo veprimtari – në formën e vet aktuale – është koncept relativisht i ri, vlera e saj shpesh dyshohet.

Rezistenca ndaj vetë idesë së dialogut ndër fetar mund të lindë edhe gjatë vetë hartimit e përgatitjes së deklaratës së misionit. Për shembull, në dialogun muslimano-kristian në Nju-Jork, një pjesëmarrës katolik pohonte që ishte gabim të dialogohej me muslimanët, pasi që sipas tij, muslimanët besojnë që të gjithë jo-muslimanët do të shkojnë në ferr. Derisa keqkuptimet e tilla mund të trajtohen gjatë takimeve, ato mund të ftohën cilindo takim që në dëgjim të parë. Përkundër faktit që të krishterët dhe muslimanët ndajnë shumë besime e histori të përbashkët fetare, ata ende përballen me shumë pengesa kur mundohen të krijojnë dialog të suksesshëm. Kjo është e vërtetë edhe për hebrenjtë dhe muslimanët. Sot, muslimanët dhe hebrenjtë janë barikaduar brenda keqkuptimeve e konflikteve të interesit. Siç u përmend më lart, konflikti Izrael-Palestinë ka krijuar mosbesim e hidhërime, që e bëjnë dialogun të vështirë. Fatmirësisht, disa rabinë reforme e konzervativë, e edhe disa imamë, kanë vullne-

tin të dialogojnë; shumë hebrenjë e muslimanë e kuptojnë rëndësinë e dialogut ndërmjet dy komuniteteve dhe kuptojnë rëndësinë e tij për shoqërinë moderne. Muslimanët dhe hebrenjët kanë nevojë për njëri-tjetrin që të ndërtojnë marrëdhënie më të mira ndërmjet komuniteteve të tyre, si dhe të ndihmojnë të sjellin paqe në Lindjen e Mesme dhe në botën e gjerë. Megjithatë, është ende e vështirë për ta të diskutojnë çështjen e Izraelit e Palestinës haptas.

Përkundër këtij realiteti, hebrenjët dhe muslimanët kanë formuar një komision për të krijuar dialogun formal me përkrahjen institucionale. (Shih Shtojcën III për deklaratën e misionit dhe rregullat). Për shumë vite, pjesëmarrësit janë koncentruar tek marrëdhëniet muslimano-hebreike në Shtetet e Bashkuara dhe kanë shmangur bisedat për Izraelin dhe Palestinën. Së voni, kanë filluar të adresojnë këtë temë të ndjeshme në qarkun e liderëve të tyre; megjithatë, nuk kanë arritur të mbajnë seminar publik e dialog të hapur për të. Natyrisht, dialogu hebreik-musliman bëhet më i vështirë derisa ka konflikt të rizgjuar në Lindje të Mesme. Shumë muslimanë do të ngurronin të hynin në sinagogë, ashtu si çifutët do të ngurronin të hynin në xhami, gjatë krizave të tilla. Në shumë raste, anëtarët e grupit të dialogut të qytetit kanë tejkaluar atë ngurrim. Në një ngjarje të përbashkët hebreike-muslimane në Qendrën Islamike, aq shumë njerëz kishin ardhur sa që ishte hapur edhe pjesa e faljeve për të siguruar hapësirë të mjaftueshme. Ishte moment historik kur imami dhe rabini qëndruan së bashku në minbar (vendi prej nga imami jep hytben e të premtes) për të folur për dialogun hebreik-musliman.

Përkundër të gjitha vështirësive, CCMR-ja dhe Komisioni për Mirëkuptimin Çifuto-Musliman (CJMU) kanë pasur ndikim tejet të madh mbi zhvillimin dhe harmoninë e komunitetit në Roçester. Inkurajuar me suksesin e përpjekjeve të tilla, pjesëtarët katolikë të CCMR-së kërkonin të merrnin pjesë më drejtpërdrejt, duke vendosur bashkëpunim të ngushtë ndërmjet komuniteteve katolike dhe muslimane. Kjo marrëdhënie ishte miqësore, por u ngroh edhe më shumë pas 11 shtatorit. Musli-

manët u ftuan të japin prezantime për bazat e islamit (“Islam 101”) në shumë kisha katolike. Një broshurë “Islam 101” u printua bashkërisht dhe u shpërnda në gjithë dioqezën. Përfundimisht, Peshkopi Katolik Roman i Roçesterit, duke reaguar haptas dhe në mënyrë baritore ndaj dëshirës së të dyja palëve për një lidhje të formalizuar solidariteti, u bashkua me imamin e Qendrës Islamike të Roçesterit dhe liderë të ndryshëm të komunitetit musliman për të nënshkruar një marrëveshje historike në maj të vitit 2003. (Shih Shtojcën IV: teksti i marrëveshjes).

Farët e mbjellura në Roçester kanë filluar të lindin tjetërkund. Së voni, bashkësia muslimane e Uashingtonit, DC, iu afruan Dioqezës Katolike të Arlingtonit, Virxhini, përmes përpjekjeve të Qendrës së Roçesterit për Studime e Dialog Ndërfetar (CISD). Fillimisht, kishte ngurrim për të hyrë në dialogun formal, por shpejt, bashkësitë tejkaluan hezitimet e tyre. Grupi i dialogut njihet si Dialogu Katoliko-Musliman (CMD) i Virgjinisë Veriore. (Shih Shtojcën V: Deklarata e Misionit dhe rregulloret).

Planifikimi i programit ndërfetar: në fazën fillestare, dialogu ndërfetar përballet me shumë sfida, mes tyre edhe frika e keqtrajtimit, gjuha pa respekt, si dhe frikësimi. Edhe në grupet e dialogut të Roçesterit, ende mbretëron frika edhe përkundër tregimeve të suksesit. Lidërshipi ndërfetar duhet të përballet me këto sfida së bashku. Nëse liderët ndahen apo përdorin gjuhë të parespektueshme, dialogu thjesht bie. Në paraprirje të këtyre sfidave, lidërshipi ndërfetar doli me një zotim që do të nënshkruhej nga të gjithë liderët fetarë pjesëmarrës.

Zotimi thekson që Roçesteri është komunitet i shquar për bashkëpunimin ndërfetar, si dhe që popullata besimtare është lutur shumë për paqen në botë dhe në komunitetin e tyre gjatë kësaj kohe të krizës në rritje. Edhe pse disa mund të ndjehen të pazotë të ndryshojnë kursin e ngjarjeve globale, ata nuk besojnë që janë të pafuqishëm shpirtërisht apo politikisht. Të dy traditat fetare thërresin pjesëtarët e tyre të vlerësojnë secilën jetë njeriu dhe të ngritën për të drejtat e njeriut e kundër padrejtësisë. Ata besojnë që secili ka rol për të luajtur në krijimin e paqes në komunitet, e duke bërë këtë, do të krijojnë një valë që do të përsh-

kojë shumë më larg sesa Roçesteri (për më shumë hollësi për tekstin e zotimit, shih Shtojcën VI).

KËSHILLA PËR FORMIMIN E PRORAMEVE NDËRFETARE

Formimi i grupit ndërftetar dhe pajtimi mbi një deklaratë misioni, e edhe nënshkrimi i një marrëveshjeje, mund të jenë të vështira. Por, kjo është sipërmarrje ngacmuese dhe përmbushëse. Hapat më të vështirë mund të jenë jo vetëm planifikimi dhe ekzekutimi i programit, por edhe të siguruarit që të gjithë janë në mbështetje të përpjekjes. Për të arritur seminar të suksesshëm ndërftetar, punëtori apo çfarëdo lloj programi tjetër, duhen themeluar nën-komisione dhe komisione planifikimi për të bërë mbikëqyrjen. Këto komisione e nën-komisione planifikimi duhen takuar disa herë për të organizuar detajet e ngjarjes: komisioni i planifikimit duhet të përcaktojë datën, kohën dhe vendin e takimit; komiteti i planifikimit duhet të përgatisë broshurat, të sigurojë publicitetin, si dhe të ndërmarrë fushatë përafrimi; ndërsa komisioni i planifikimit duhet të vendosë për koordinatorin, të përgatisë dokumentin vlerësues, si dhe të kujdeset për sigurinë, nikoqirllëkun dhe të tjera pika të rëndësishme.

Të dy komisionet duhet të sigurojnë që asnjë nga prezantuesit të mos hyjë në proselitizëm. Për më tepër, duhen ndarë përgjegjësitë në mënyrë të barabartë, ashtu që asnjëri grup pjesëmarrës të mos mund të dominojë të tjerët. Me fjalë tjera, secili pjesëmarrës duhet të ketë respekt të plotë. Komisioni i planifikimit duhet të menaxhojë kohën e disponueshme në mënyrë të drejtë, si dhe të sigurojë që secili të ketë kohë të mjaftueshme për të bërë pyetje e përgjigje. Asnjë ankesë apo kritikë nuk duhet lënë anash, si dhe vlerësimet e kryera pas programit duhet analizuar në mënyrë kritike, si dhe sipas mundësisë, duhet zbatuar në programin e radhës. Përfundimisht, kryesia e komisionit

duhet të jetë me rotacion, ashtu që secili grup të trajtohet në mënyrë të barabartë dhe të drejtë (për më shumë hollësi, shih Kapitullin II).

Komisioni për Marrëdhënie Krishtero-Muslimane (CCMR), Aleanca Muslimano-Katolike (MCA), si dhe Komisioni për Mirëkuptimin Hebreik-Musliman (CJMU) kanë organizuar shumë programe edukative, seminare e piknikë për të fituar mirëkuptim më të mirë të fesë së tjetrit, si dhe për të ndërtuar ura ndërmjet komuniteteve fetare pjesëmarrëse në bazë të marrëdhënieve të ngrohta e njerëzore. Edukimi i publikut për Islamin: Islami është feja më e keqkuptuar në Shtetet e Bashkuara. Kur amerikanët e dëgjojnë fjalën “Islam” menjëherë e mendojnë terrorizmin, beduinët arabë, ose fenë e një populli të nxirë nga lëkura e të pacivilizuar. Disa mendojnë që Allahu është në fakt Satani. Mediat bartin storie e imazhe frikësuese që përforcojnë frikën e amerikanëve gati çdo ditë. Për t’u përballur me imazhe e frika të tilla, CCMR-ja ka ofruar shumë programe “Islam 101”: “Islami: Mesazhi dhe i Dërguari”, “Jeta muslimane gjatë gjithë ditës”, “Besimi dhe adhurimi musliman”, “Gratë në Islam”, “Xhihadi: Personal dhe publik”, si dhe të tjerë. Këta seminarë janë pritur mjaft mirë, si dhe kanë tërhequr më se 200 njerëz çdo herë. (Për më shumë hollësi, shih Shtojcën VII).

Prapë, kanë lindur keqkuptime. Për shembull, në një moment, udhëheqja e krishterë ka marrë ankesa që udhëheqësit muslimanë predikonin Islamin dhe (pa vetëdije) kritikonin krishterimin. Edhe pse këto ankesa ishin vlerësuar si të pabazuara, keqkuptimi përbënte rrezik serioz ndaj vazhdimit të dialogut. Disa prej liderëve frikësoheshin që keqkuptimi do të dëmtonte raportet e mira të krijuara ndërmjet dy komuniteteve. Keqkuptime të ngjashme pengojnë mirëkuptimin e muslimanëve për krishterimin, si dhe të krishterëve që flasin për krishterimin. Shumë muslimanë e shohin krishterimin nga botëkuptimi i Kuranit dhe e shpjegojnë në bazë të tij. Ata janë zakonisht të njoftuar me paraqitjen biblike të Krijimit, Mëkatit Fillestar, Mërisë dhe Jezusit, parajsës e ferrit, e shumë koncepte tjera të krishtera. Por, secili denominim i krishterë ka shpjegimet apo interpreti-

met e veta të këtyre besimeve. Pra, kur muslimanët thonë që “kështu e ashtu besojnë të krishterët, si dhe këtë e thotë Islami”, audienca e krishterë në shumë raste befasohet kur dëgjon disa perceptime muslimane, të cilat nuk i kanë dëgjuar më herët, të përshkruara si besime të krishtera. Muslimanët kanë shumë për të mësuar për mënyrat e ndryshme në të cilat të krishterët “i dëgjojnë” storiet që të dy fetë i kanë të përbashkëta.

Dialogu ndërftetar në Roçester ka bërë dy gjëra për të tejkaluar këtë konfuzion: ai i kërkonte folësit muslimanë që të kufizohet tek Islami, si dhe të trajnojnë folësit muslimanë që të jenë të ndjeshëm ndaj krishterimit. Në një mbrëmje, rreth njëzetepesë liderë muslimanë u bashkuan dhe ftuan disa liderë të krishterë në darkë, për të trajnuar muslimanët për ndjeshmërinë ndaj krishterimit. Folësit, mes tyre katolikë, baptistë, presbiterianë, e episkopalianë, trajtuan temat vijuese: Krijimi, Mëkati Fillestar, Trinia, Jezusi (Kush është Ai), si dhe çfarë bashkon të krishterët (për më shumë hollësi, shih Shtojcën VIII).

Përveç këtyre, MCA-ja ofroi një sërë seminaresh mbi praktikat krahasuese të Islamit dhe Katolicizmit në lidhje me ciklet e jetës, besimet (përfshirë parajsën e ferrin), si dhe adhurimin që formëson ato praktika. Këta seminarë ndihmuan të dy komunitetet të kuptojnë fenë e njëri-tjetrit më mirë, si dhe të zvogëlonin nivelin e keqkuptimeve ndërmjet tyre. Si rezultat, ishte më e lehtë të bëheshin miq. Në serinë e dialogjeve hebreiko-muslimane, tema “Udhëtimi jonë drejt Amerikës: Sfida e pengesa” ishte çmuar veçanërisht si përvojë mësimore për të dy grupet. Muslimanët mësuan se si hebrenjtë, në të kaluarën, kishin jetuar në frikë në Shtetet e Bashkuara në mënyrën që i përngjan shumë jetës së tashme të muslimanëve. Muslimanët morën kurajo nga mënyra se si hebrenjtë e kishin tejkaluar paragjykimin dhe kishin gjetur respektin e vendit.

Shumica e seminarëve nga MCA dhe CJMU ishin krahasimtarë në natyrë, e përbëheshin nga një folës nga secili komunitet fetar, i cili fliste vetëm për fenë e tij apo saj. Edhe pse i'u ishte thënë të respektonin këtë rregull, disa në audiencë ndjenin që folësit kishin prirje të nënvlerësonin njëri-tjetrin. Për t'u për-

ballur me këtë vështirësi, liderët ndërfetarë të Roçesterit i kërkuan folësve të takohen dhe të gjenin pikat e përbashkëta para se të paraqiteshin në publik. Gjithashtu, shumica e këtyre programeve ishin vlerësuar në mënyrë të thukët, ndërsa vlerësimi ishte diskutuar në takimet e rregullta, ndërsa sugjerimet ishin futur në programet e ardhshme (Shih shtojcën IX: Mostër e vlerësimit të programit).

Kështu, shumë nga këto programe ishin organizuar në qendra komuniteti musliman. Qendra Islamike e Roçesterit dhe Qendra ADAMS janë shembuj të qendrave komunitare muslimane që kanë arritur të mbajnë veten në përballje të tilla ndërfetare. Ka shumë qendra tjera që duhen vlerësuar e theksuar për ofrimin e hapësirave paralelisht me ato që janë ofruar nga partnerët jo-muslimanë të dialogut.

PIKAT KRYESORE TË KAPITULLIT

- Dialogu ndërfetar ndërmjet pasuesve të besimeve ibrahimike në Shtetet e Bashkuara është bërë prioritet kryesor që prej 11 shtatorit. Imamët dhe studiuesit islamikë duhet të angazhohen më shumë për të ofruar udhëzime të mirëfillta dhe të arrijnë rezultate më të mira.
- Dialogu musliman me të krishterët e vijës bazë është duke ecur mirë. Megjithatë, imamët duhet të për afrohen edhe me të krishterët evangjelistë, për të krijuar mirëkuptimin dhe respektin e ndërsjellë.
- Derisa dialogu musliman me hebrejtë po ndodh në shumë qytete, ai ec me dinamikë të vogël. Konflikti Izrael-Palestinë është pengesa kryesore. Është e këshillueshme që të fokusohen ekskluzivisht tek marrëdhëniet hebreiko-muslimane në Shtetet e Bashkuara, pasi që të dy komunitetet kanë shumë gjëra për të ndarë e provuar mes vete, pasi që jetojnë bashkë.

- Pjesëmarrësit muslimanë nuk duhet të insistojnë të ofrojnë Bazat e Islamit për edukim publik, përveç nëse partnerët tjerët të dialogut e sygjerojnë këtë. Programet duhet të trajtojnë baraz brengat e secilit partner në dialog.
- Pasi liderët dhe imamët muslimanë priren t'i qasen hebreizmit dhe krishterimit nga këndvështrimi Kur'anor, ata kanë nevojë për trajnime të ndjeshmërisë, ashtu që të mund të përfitojnë kuptimin e saktë të mënyrës në të cilën hebrejët dhe të krishterët e kuptojnë fenë e tyre. Kjo do të parandalonte shumë fjalë e incidente ofenduese të paqëllimita.
- Një aspekt i rëndësishëm i përballjeve ndërftetare është që të punohet si partner i barabartë me institucionet apo grupet pjesëmarrëse jo-muslimane.
- Shtojcat në fund të këtij udhëzuesi mund të përdoren për të krijuar programe ndërftetare.

PYETJE PËR DISKUTIM

1. A keni njohuri për ndonjë deklaratë tjetër misioni të ndonjë grupi ndërftetar në të cilin muslimanët angazhohen në mënyrë aktive? Kush janë pjesëmarrësit muslimanë? Nga këndvështrimi juaj, cilat janë sukseset e dështimet e tyre?
2. Nëse ka në zonën tuaj dialog ndërftetar, në çfarë formash paraqitet ai? Çfarë programesh ofrohen? A mund të gjykoni nëse pjesëmarrja e secilit grup është e barazueshme? A ka literaturë për këto programe në dispozicion?
3. Nëse merrni pjesë në dialog ndërftetar, çfarë deklarate misioni keni? Çfarë programesh keni inicuar? Nëse dëshironi të merrni pjesë, cila do të ishte deklarata ideale e misionit? Çfarë programesh do të iniconit ju?

4. Nëse keni marrë pjesë tashmë në dialogun hebreiko-musliman apo i përkisni një grupi musliman që merr pjesë në dialog të tillë, cilat janë fushat e suksesit dhe dështimit në atë dialog? Si është perspektiva e të ardhmes? Si mund të përmirësohet ai?
5. A keni ndonjë deklaratë misioni të ndonjë dialogu hebreiko-musliman, apo a njihni ndonjë grup që ka të tillë?
6. Nëse do të merrnit pjesë në dialogun hebreiko-musliman, çfarë deklarate misioni do të propozonit? Çfarë lloji programesh do të inicionit për të arritur dialog të suksesshëm?

PËRFUNDIM

SOT, asnjë fe nuk mund të jetojë e izoluar nga bota. Të gjitha besimet duhet t'i hapin derën të tjerëve, duke i mundësuar atyre që ta studiojnë, ta vështrojnë në mënyrë kritike, ta çmojnë apo refuzojnë. Fetë me mesazh universal, si Islami, duhet të përshtasin mësimet e tyre ndaj mjediseve bashkëkohore kërkuese, duke ushtruar ijtihad (aplikimi i gjykimeve të arsyeuara ndaj mësimëve të Kuranit dhe Syneetit). Në këtë mënyrë, organet fetare mund t'i bëjnë besimet e praktikat fetare më të kuptueshme dhe zbatueshme për botën moderne. Ky proces natyror ka ndodhur në historinë e të gjitha feve të mëdha; ata që kanë rezistuar ndaj ndryshimit, në pjesën më të madhe, kanë humbur anëtarë dhe janë vyshkur.

Pjesëtarët e të gjitha feve duhet të respektojnë besimet dhe praktikat e feve tjera, për të jetuar në paqe dhe për të tërhequr më shumë anëtarë. Edhe një herë, fetë po dalin si forca të mëdha të botës moderne. Nëse pasuesit e tyre nuk punojnë për bashkëjetesë paqësore me njëri-tjetrin, ata do të përballen me reagi-me të dhunshme nga të gjitha shoqëritë. Fetë që hyjnë në dialog të qetë e kreativ, ofrojnë shërbime shpirtërore, si dhe plotësojnë nevojat e njerëzve, do të jenë fetë dominuese të të ardhmes. Dialogu ndërfeetar nuk do të thotë krijim i fesë civile apo flijim i bazave të besimit të vet; është më shumë përpjekje për të përçarur respektin për njerëzimin, për të jetuar bashkë në paqe, si dhe për të ofruar mundësinë e lirisë së besimit për të gjithë.

Të gjitha programet e prezantuara në këtë udhëzues kërkojnë në të mishërojnë mirëkuptimin e mëtutjeshëm ndërmjet

njerëzve të feve të ndryshme. Theksi i programeve tek Islami është për shkak të faktit që Islami është shumë i keqkuptuar në përfundim, ndërsa muslimanët që jetojnë këtu ndjehen të kërcënuar. Kjo është arsyeja pse Islami duhet shpjeguar për publikun, e edhe për muslimanët vetë. Një synim tjetër është t'i tregohet publikut që shumica dërmuese e muslimanëve nuk pajtohet me dhunën dhe terrorizmin.

Fatkeqësisht, e ndoshta edhe befasisht, dialogu brendafetar shpesh del të hapë më shumë vështirësi sesa dialogu ndërftetar. Pjesëtarët e të njëjtës fe këmbëjnë akuza, fajësime e etiketime ndaj njëri-tjetrit si më "autentik" apo më "besnik" ndaj mësimëve të vërteta të fesë. Por, dialogu brendafetar është edhe më i rëndësishëm, sepse asnjë fe nuk mund të arrijë pozitë të respektueshme në komunitetin botëror nëse pjesëtarët e saj nuk i respektojnë besimtarët brenda vetë fesë të tyre. Pjesëmarrësit muslimanë do të përfitojnë më shumë nga dialogu ndërftetar nëse më parë arrijnë mirëkuptimin brendafetar, si dhe nëse kalojnë më shumë kohë duke hulumtuar perceptimet e besimet e veta për punën ndërftetare së bashku. Ngjashëm, edhe të krishterët dhe hebrenjtë që kanë arritur mirëkuptimin ekumenik shohin që edhe dialogu ndërftetar përforcohet si rezultat i këtij mirëkuptimi.

Përkundër shumë nxitjeve të dialogut ndërftetar, ka prapë disa në secilin komunitet që jo vetëm refuzojnë të marrin pjesë, por edhe pretendojnë të jenë besimtarë të vërtetë, duke i konsideruar dialoguesit jobesimtarë. Këta refuzues shpesh tërheqin më shumë pasues sesa dialoguesit. Për shembull, kishat e krishtera evangjeliste duket të tërheqin përditë e më shumë të konvertuar nga kishat tradicionale. Ka kisha evangjelike që i quajnë të krishterët e vijës bazë të cilët marrin pjesë në dialogun ndërftetar "të pabesë". Ngjashëm, shumë muslimanë salafi e mbajnë veten për të "drejtë", si dhe poshtërojnë muslimanët që marrin pjesë në dialogun ndërftetar. Përveç këtyre, disa grupe muslimane refuzojnë të takohen me jo-muslimanë, edhe përkundër faktit që jetojnë bashkë me jo-muslimanë.¹

Nuk mund të ketë bashkëjetesë paqësore pa dialog brendafetar e ndërftetar, sepse i pari i siguron përkrahjen institucionale këtij

të fundit. Duke punuar bashkë, njerëzit e angazhuar në të dyja grupet mund të iniciojnë programe edukative për t'i ndihmuar pasuesve të tyre të kuptojnë rëndësinë e këtij dialogu. Kur njerëzit e kuptojnë që pjesëmarrja në dialogun ndërftar nuk i bën ata më pak fetarë apo shpirtërorë, apo nuk i bën të braktisin vetë themelet e fesë së tyre, refuzuesit apo ekstremistët do të kenë më pak mundësi të çorientojnë. Siç dihet botërisht, edukimi shpërbën keqkuptimin. Ndoshta disa kongregata do të marrin udhëheqjen duke shtyrë liderët e tyre ngurrues që të marrin pjesë në dialogun brendafetar, të respektojnë të tjerët, si dhe të çmojnë përpjekjet e atyre që punojnë për harmoninë dhe paqen brenda komunitetit dhe ndërmjet komuniteteve. Bashkëjetesa paqësore me të tjerë është motivim i rëndësishëm për shumë pjesëmarrës muslimanë të dialogut ndërftar. Prapë, ka një synim edhe më fundamental: të thellojmë të kuptuarit vetanak të fesë sonë, por edhe atë të tjetrit. Nga ky mirëkuptim, mund të lindë një marrëdhënie e re, marrëdhënie jo e bazuar në qëndrime e motive apologetike apo defanzive, por tek dëshira e vërtetë e autentike njerëzore për të njohur tjetrin.

Për të arritur dialog ndërftar efektiv e të dobishëm për bashkësinë muslimane, imamët dhe liderët islamikë duhet ta marrin seriozisht dialogun brendamusliman. Shumë kënaqen duke vështruar, duke e braktisur përgjegjësinë dhe duke ia lënë këtë përpjekje atyre që ose nuk kanë njohuri të vërtetë të islamit ose nuk e praktikojnë më. Këta imamë që i marrin përgjegjësitë seriozisht duhet të përmbushin tri detyra kryesore: së pari, ata duhet të hyjnë në grupin e dialogut ndërftar për t'i dhënë udhëzimin e duhur në frymën e urdhrave islamë. Pjesëmarrja e tillë është thelbësore, sidomos kur dialogu ndërftar fokusohet tek çështjet teologjike e të besimit; së dyti, imamët duhet të marrin pjesë në dialog brendafetar për të hequr keqkuptimet e zakonshme që ndërliken me këtë përpjekje; së treti, grupet brendafetare e ndërftare duhet të përtafrohën dhe të angazhojnë imamët dhe pjesëtarët e komunitetit që dënojnë sipërmarrje të tilla, sepse, përfundimisht të dyja palët do të përfitojnë.

Iniciativat bashkëkohore për dialog brendafetar dhe ndërftar janë duke nxitur një frymë të re të unitetit publik. Ashtu si

lëvizja amerikane për të drejtat civile në vitet e gjashtëdhjeta kishte shtruar rrugën për më shumë harmoni racore, etnike dhe kulturore, kjo lëvizje e dialogut brendafetar dhe ndërftetar do të zgjojë botën për respekt ndërftetar e brendafetar për njerëzit e të gjitha feve, duke i mundësuar njerëzve të jetojnë së bashku në paqe. Çdo fe që bëhet pishtar i iniciativës do të gëzojë të ardhme më premtuese, sepse do të respektohet e mirëkuptohet.

Ky udhëzues është hapi ynë i parë drejt theksimit të nevojës për dialog brendafetar dhe ndërftetar. Ky udhëzues duhet të inkurajojë imamët që të angazhohen, duke ecur drejt përfitimit të zemrave muslimane dhe duke përfituar edhe përkrahjen e tyre morale dhe financiare. Ka nevojë për më shumë libra e artikuj në këtë fushë. Kemi shpresë që ky publikim do të ofrojë udhëzime thelbësore për ndërtimin e marrëdhënieve të fuqishme brendafetare dhe ndërftetare pa huti, keqmenaxhim apo keqkuptim. Nëse arrihet ky qëllim, grupet e përfshira mund të angazhohen me njëri-tjetrin në baza më të qarta e të barazueshme. Provë e këtij angazhimi do të jetë kapaciteti për të dizajnuar e ekzekutuar programe atraktive në kuadër të një dialogu formal. Dialogjet e tilla kërkohen nga lëvizjet e vërteta fetare që punojnë për paqen në botë. Një hap i suksesshëm në këtë drejtim do të ishte bekimi i Zotit.

SHTOJCAT

SHTOJCA I

DEKLARATA E PARË E ALEKSANDRISË

21 janar 2002

NË emër të Zotit që është i Plotfuqishëm, Mëshirëplotë dhe i Gjithëmëshirshëm, ne, të cilët jemi tubuar si udhëheqës fetarë nga komunitetet muslimane, të krishtera dhe hebreike, lutemi për paqe të vërtetë në Jerusalem dhe në Tokën e Shenjtë dhe shpallim përkushtimin tonë për t'i dhënë fund dhunës dhe gjakderdhjes që mohon të drejtën e jetës dhe dinjitetit.

Sipas traditave tona fetare, vrasja e njerëzve të pafajshëm në emër të Zotit është një përdhosje e Emrit të Shenjtë të Tij dhe diskrediton fenë në botë. Dhuna në Tokën e Shenjtë është një e keqe që duhet të kundërshtohet nga të gjithë njerëzit e besimit të mirë. Ne kërkojmë që të jetojmë së bashku si fqinjë duke respektuar integritetin e trashëgimisë historike dhe fetare të njëri-tjetrit. Ne u bëjmë thirrje të gjithëve të kundërshtojnë nxitjen, urrejtjen dhe paraqitjen ndryshe të tjetrit.

1. Toka e Shenjtë është tokë e shenjtë për të tri besimet tona. Prandaj, pasuesit e feve hyjnore duhet të respektojnë shenjtërinë e tyre dhe gjakderdhja nuk duhet lejuar të ndotë atë. Shenjtëria dhe integriteti i vendeve të shenjta duhet të ruhet dhe liria e adhurimit fetar duhet të sigurohet për të gjithë.
2. Palestinezët dhe izraelitët duhet të respektojnë qëllimet e urdhëruara hyjnore të Krijuesit nga hiri i të Cilit do të jetojnë në të njëjtin vend që quhet vend i shenjtë.

3. Ne u bëjmë thirrje të gjithë liderëve politik të dy popujve të punojnë për një zgjidhje të drejtë, të sigurt dhe të qëndrueshme në frymën e fjalëve të Gjithëfuqishmit dhe Profetëve,
4. Si hap i parë tani, ne bëjmë thirrje për një armëpushim fetar të sanksionuar, që respektohet dhe nderohet nga të gjitha palët dhe për implementimin e rekomandimeve të Mitchell dhe Tenet, duke përfshirë heqjen e kufizimeve dhe kthimit në negociata.
5. Ne kërkojmë që të ndihmojmë të krijojmë një atmosferë ku brezat e sotëm dhe të ardhshëm do të bashkekzistojë me respekt të ndërsjellë dhe besim në tjetrin. Ne u bëjmë thirrje të gjithëve të përmbahen nga nxitja dhe demonizimi dhe për të edukuar brezat tanë të ardhshëm në përputhje me këtë.
6. Si liderë fetarë, ne zotohemi që të vazhdojmë një përpjekje të përbashkët për një paqe të drejtë që çon drejt pajtimit në Jerusalem dhe në Tokën e Shenjtë, për të mirën e përbashkët të të gjithë popujve tanë.
7. Ne shpallim themelimin e një komisioni të përhershëm të përbashkët për të realizuar rekomandimet e kësaj deklaratë, dhe për t'u angazhuar me udhëheqjen tonë përkatëse politike në përputhje me këtë.

Delegatët:

- Hirësia e tij Kryepeshkopi i Kanterberit, Dr. George Carey
- Eminenca e tij Sheikh Mohamed Sayed Tantaëi, Kajro, Egjipt •Krye-rabini Sefardi Bakshi-Doron
- Zëvendës Ministri i Jashtëm i Izraelit, Rabini Michael Melchior •Rabini i Tekoas, Rabini Menachem Froman
- Drejtori Ndërkombëtar i Punëve Ndërfetare, Komiteti Amerikan Hebre, Rabini David Rosen
- Rabini i Savion, Rabini David Brodman
- Rabini of Malot Dafna, Rabini Yitzak Ralbag
- Shefi i Drejtësisë i Gjykatave të Sheriatit, Sheikh Taisir Tamimi

- Ministrii Shtetit për PA, Sheikh Tal El Sider
- Muftiu i Forcave të Armatosura, Sheikh Abdelsalam Abu Shkedem
- Muftiu i Betlehemit, Sheikh Mohammed Taveel
- Përfaqësuesi i Patriarkut të Greqisë, Kryepeshkopi Aristichos
- Patriarku Latin, Fortlumturia e tij Michel Sabbah
- Kryepeshkopi Melkite, Kryepeshkopi Boutrous Mu'alem
- Përfaqësuesi i Patriarkut të Armenisë, Kryepeshkopi Chinchinian
- Peshkopi i Jerusalemit, Rt. Rev. Riah Abu El Assal

SHTOJCA II KOMISIONI PËR MARRËDHËNIET NË MES TË KRISHTERËVE DHE MUSLIMANËVE

*AKTET NËNLIGJORE NË FUQI
1 SHTATOR 2004*

NË vijim janë aktet nënligjore të Komisionit. Këto akte nënligjore janë rishikuar dhe ndryshuar në vitin 2003 dhe u miratuan njëzëri më 1 shtator 2004. *

Deklarata e qëllimit

Komisioni për Marrëdhëniet në mes të krishterëve dhe muslimanëve i Komunitetit Musliman të Zonës së gjerë të Roçesterit, nëpërmjet Këshillit të Mesxhidit (ZRKM) dhe Komunitetit të Kishave të Zonës së gjerë të Roçesterit (ZRKK) ka për qëllim të thellimit të mirëkuptimit dhe vlerësimit të ndërsjellë në mes të komuniteteve të krishtera dhe muslimane. Objektivi ynë është që të zgjerojmë respektin e ndërsjellë dhe për të rritur pjesëmarrjen aktive brenda Zonës së gjerë të Roçesterit. Ne e kuptojmë njëri-tjetrin si popuj që janë të bazuar në traditat fetare e Ibrahimit. Së bashku ne do të adresojmë çështjet etike, shoqërore dhe morale. Qëllimet e përmendura më lart do të realizohen nëpërmjet:

1. Arsimit
2. Bashkëveprimit shoqëror
3. Monitorimit dhe reagimit ndaj mediave
4. Avokimit

Misioni ynë është të rrisë të kuptuarit, të përmirësojë dialogun, dhe të largojë frikën. Komisioni do të nxisë bashkëveprimin, të mbrojë të drejtat e njeriut dhe qytetare dhe të sfidojë nocionet e perceptuara publike të komuniteteve tona përkatëse fetare.

1. Anëtarësia

Çdo komunitet do të ketë më së paku gjashtë anëtarë dhe më së shumti nëntë anëtarë. Komisioni inkurajon organet sponsorizuese që të përpiqen për diversitetet dhe përfaqësim gjinor.

2. Zyrtarët

Komisioni do të zgjedhë një Kryetar dhe Zëvendës-kryetar me rotacion në mes të muslimanëve dhe të krishterëve. Komisioni do të zgjedhë një Sekretar/Arkëtar për të regjistruar dhe për të shpërndarë procesverbalet dhe për të pranuar, regjistruar dhe shpërndarë fondet sipas udhëzimit. Zyrtarët do të shërbejnë në mandate dyvjeçare duke filluar nga data 1 janar. Mandatet e zyrtarëve mund ose mund të mos jenë të rinovueshme sipas zgjedhjes së ekzekutivit dhe anëtarëve të Komisionit.

3. Përgjegjësitë

Komisioni do të paraqesë një raport vjetor për ZRKM dhe ZRKK çdo dhjetor.

4. Financat

ZRKM dhe ZRKK, organizatat sponsorizuese, do të sigurojnë një buxhet minimal. Financimi shtesë për ngjarje të veçanta është përgjegjësi e Komisionit.

5. Amendamentet

Amendamentet e këtyre akteve nënligjore mund të bëhen me shumicën e votave të anëtarëve të Komisionit pas shqyrtimit të dy mbledhjeve të njëpasnjëshme. Së paku katër anëtarë të secilit komunitet duhet të jenë në favor të amendamentit nën shqyrtim.

6. Anëtarësia jetësore nderi

Komisioni mund të japë, në shenjë mirënjohje për shërbimin shembullor për një kohë të gjatë për çështjen e marrëdhënieve të krishtera/muslimane, një Anëtarësi jetësore nderi pa të drejtë vote.

* Këto akte të ndryshuara nënligjore u sugjerua nga Komisioni dhe u diskutuan në dy takime të ndara përpara se të miratohen unanimitisht më 1 shtator 2004.

Komisioni mblidhet çdo muaj. Rishikon procesverbalin, diskuton ndonjë ngjarje të rëndësishme që ka ndodhur gjatë muajit dhe planifikon aktivitetet e ardhshme. Më poshtë do të paraqes disa nga seminarët e përbashkëta që Komisioni ka organizuar për arsimin publik dhe ndërtimin e marrëdhënieve paqësore.

SHTOJCA III KOMISIONI PËR MIRËKUPIM NË MES TË HEBRENJËVE DHE MUSLIMANËVE (KMHM)

KUR Imami i Roçesterit, i cili kishte shkuar në Pakistan në vitin 1994, u kthye në verën e vitit 1997, Rabini Miller kishte vdekur, dhe marrëdhëniet në mes të hebrenjëve dhe muslimanëve ishin në një shkallë të ulët. Falë Rabinit Alan Katz të Tempullit Sanai dhe Isobel Goldman të Federatës së Komunitetit Hebre (FKH), u themelua shpejt një grup kontakti hebre-musliman. Grupi filloi të takohej në shtëpitë dhe vendet e kultit. Ai gjithashtu mbajti disa programe publike mbi tema të ndryshme me interes të përbashkët. Grupi i Kontaktit u bë një Komision në vitin 2002. Në vijim janë aktet nënligjore të Komisionit.

Deklarata e qëllimit

Komisioni për Mirëkuptim hebre-musliman i Zonës së gjerë të Roçesterit ka për qëllim krijimin e mirëkuptimit dhe vlerësimit të ndërsjellë në mes të bashkësive hebreike dhe muslimane duke synuar zgjerimin e respektit të ndërsjellë dhe rritjen e bashkëpunimit aktiv brenda Zonës së gjerë të Roçesterit.

Përmes mundësive arsimore dhe shoqërore dhe aktiviteteve të drejtësisë shoqërore, Komisioni inkurajon mirëkuptimin në rritje dhe dialogun ndërmjet anëtarëve të tij, në sinagogat e tij dhe mesxhidin e tij, dhe brenda komunitetit në tërësi. Një nga qëllimet kryesore të Komisionit hebre-musliman është që të adresojë çështjet arsimore, shoqërore, fetare dhe morale të komunitetit në përgjithësi. Komisioni angazhohet për hapa konkret drejt implementimit të qëllimit të tij:

- Duke nxitur bashkëveprimin ndërmjet komuniteteve hebreike dhe muslimane.
- Duke mbrojtur të drejtat qytetare dhe njerëzore të pjesëtarëve të të dyja komuniteteve përmes avokimit, arsimit, dialogut dhe marrëdhënieve me publikun.
- Duke iu drejtuar mediave në lidhje me rolin e saj në paraqi-

tjen e raportimit të saktë dhe të drejtë mbi çështjet me interes për hebrenjtë dhe muslimanët dhe rolin e tyre në nxitjen e mirëkuptimit ndaj njëri-tjetrit.

- Duke krijuar programe arsimore me interes të përbashkët.
- Duke mbajtur lidhje me grupet e tjera ndërfetare dhe të komunitetit në këtë zonë.

Nënshkruar nga pjesëmarrësit hebrenjë dhe pjesëmarrësit muslimanë

SHTOJCA IV NJË MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI DHE BASHKËPUNIMI

MË poshtë është paraqitur një dokument solemn i marrëveshjes në mes të Dioqezës romake katolike të Roçesterit, NJ dhe Këshillit të Mesxhidit së Roçesterit, NJ. Duke konfirmuar besimin tonë në një Zot të vetëm dhe duke njohur historinë tonë të përbashkët dhe traditat e përbashkëta të Ibrahimit, ne i lutemi Zotit të Mëshirshëm që të frymëzojë tek ne respektin, mirëkuptimin e ndërsjellë dhe dashurinë dhe të na udhëzojë për të ndjekur vlerat tona të përbashkëta për të mirën e të gjithëve në shoqërinë tonë dhe më gjerë.

Neni I

Në frymën e respektimit të ligjeve të traditave tona gjegjëse fetare, të parimeve të Deklaratës Universale për të drejtat e njeriut, si dhe të Kartës të Drejtave të mishëruara në Kushtetutën tonë amerikane, ne konfirmojmë angazhimin tonë për të mbështetur të drejtën e çdo qenieje njerëzore për lirinë e fjalës, mendimit, besimit dhe të ndërgjegjes

Neni II

Ne bashkërisht deklarojmë përkushtimin tonë për të sfiduar vazhdimisht të gjitha format [e jo tolerancës] fetare, jo tolerancës etnike dhe fanatizmit përmes promovimit aktiv të mirëkuptimit të ndërsjellë dhe respektin për jetën dhe dinjitetin njerëzor.

- a. Duke iu përgjigjur në mënyrë të hapur akteve të jo tolerancës fetare, racore, etnike apo të çdo lloji tjetër të jo tolerancës.
- b. Duke investuar kohën, punën dhe talentet për sensibilizimin e vet komuniteteve tona për të këqijat e jo tolerancës së tillë.
- c. Duke informuar dhe edukuar njëri-tjetrin mbi çështjet e interesit publik.

Neni III

Ne përkushtohemi dhe zotohemi për të nxitur marrëdhënie të matur të respektit dhe bashkëpunimit të ndërsjellë në mes të dy komuniteteve tona, duke promovuar një njohuri më të thellë dhe respektim të historisë traditave dhe ndjeshmërive të njëri-tjetrit. Që të arrijmë këtë, komunitetet tona inkurajohen seriozisht për të zbuluar mënyra edhe më të mira për të nxitur dhe promovuar:

- a. Një dialog gjithëpërfshirës që çon në dashamirësi dhe mirëkuptim të ndërsjellë.
- b. Zhvillimin dhe përhapjen e informacionit të duhur që përfshin traditat fetare të njëri-tjetrit si për fëmijët ashtu edhe për të rriturit. Në veçanti, inkurajohen përvojat e kombinuara të të mësuarit.
- c. Domosdoshmëria për të thelluar vetëdijen dhe Sensibilitetit ndaj çështjeve me interes të veçantë bashkëkohor në secilin komunitet.

Neni IV

Sa i përket kontaktit me komunitet, kurdo që është e mundur, ne jemi të inkurajuar fuqishëm që të bashkëpunojmë në zhvillimin e shërbimeve reciprokisht të dobishme duke respektuar integritetin dhe pavarësinë e organizatave të shërbimit të njëri-tjetrit.

- a. Duke mbështetur, sa herë që është e mundur, përpjekjet në komunitetin e njëri-tjetrit, si dhe në publikun e gjerë për të siguruar nevojat themelore për të gjithë.
- b. Duke qenë, kurdo që është e mundur të njoftuar, të kuptueshëm dhe duke qenë të ndjeshëm ndaj nevojave globale të çdo tradite.

Neni V

Do të formohet një komitet i përbashkët nga ana e Dioqezës dhe Këshillit për t'u siguruar që kjo marrëveshje të zbatohet plotësisht dhe me besnikëri.

Nënshkruar sot: ___ 5 maj

2003

Nënshkruar nga Përfaqësuesit

SHTOJCA V

DIALOGU KATOLIK – MUSLIMAN (DKM) I VIRGJINIAS VERIORE

Deklarata e Misionit

DUKE PASUR PARASYSH QË katolikët dhe muslimanët janë dy nga besimet e mëdha të feve të botës që jetojnë si fqinjë në të gjitha pjesët e botës globale;

Duke pasur parasysh që katolikët dhe muslimanët besojnë në Zotin e Plotfuqishëm në Shkrimet e shenjta;

Duke pasur parasysh që katolikët dhe muslimanët e njohin Ibrahimin si themelues të përbashkët të besimeve të tyre; Duke pasur parasysh që katolikët dhe muslimanët besojnë në Shkrimet e shenjta që trajtojnë mirëqenien e nevojtarëve dhe të varfërve, ata që janë në vuajtje dhe ata që janë prekur nga fatkeqësitë;

Duke pasur parasysh që katolikët dhe muslimanët besojnë në vlerat e familjes dhe konsiderojnë që Shkrimet e tyre mbështesin dinjitetin njerëzor, bujarinë, dhembshurinë, mëshirën dhe faljen; duke pasur parasysh që Mësimet e Kishës Katolike dhe Tradita muslimane kërkojnë nga katolikët dhe muslimanët përkatësisht të afrohen dhe të ndërtojnë marrëdhënie më të mira midis dy komuniteteve; duke pasur parasysh që komuniteti botëror ka nevojë për bashkëpunim, thellimin e marrëdhënieve dhe respekt për besimin e njëri-tjetrit në shërbim të njerëzimit, prandaj, ne katolikët dhe muslimanët që jetojmë në pjesën veriore të Virgjinias zotohemi për dialog:

1. Për të kuptuar dhe për të ndërtuar marrëdhënie më të mira;
2. Për të vlerësuar dhe të festuar besimet tona përkatëse si fqinjë të mirë me respekt të ndërsjellë për njëri-tjetrin;
3. Për të adresuar së bashku çështjet fetare, etike, shoqërore, dhe morale me të cilat përballlet njerëzimi.

Misioni ynë është që të rrisë mirëkuptimin, të përmirësojë dialogun, të largojë frikën, dhe të nxitë shpresë. Dialogu do të nxisë bashkëveprimin, do të mbrojë të drejtat fetare, qytetare

dhe njerëzore dhe do të sfidojë nocionet e perceptuara publike të komuniteteve tona përkatëse fetare. Ky mision do të realizohet nëpërmjet:

1. Seminareve dhe konferencave edukuese
2. Programeve të ndërveprimit social
3. Monitorimit, analizimit dhe duke iu përgjigjur mediave për të promovuar mirëkuptimin e publikut
4. Avokimit...

Aktet nënligjore

1. Anëtarësia

Për të arritur qëllimin tonë ne vendosim të formojmë këtë grup të Dialogut ku secili komunitet do të ketë 5 deri në 7 anëtarë. Ne inkurajojmë organet sponsorizuese që të bëjnë përpjekje për diversitet dhe përfaqësim gjinor. Katolikët do të përfaqësohen përmes Dioqezës së Kontesë Arlington dhe muslimanët do të përfaqësohet nëpërmjet Këshillit Koordinues të Organizatës Muslimane të Zonës së Uashingtonit (KKOM).

2. Zyrtarët

Dialogu katolik musliman (DKM) do të zgjedhë një Kryetar dhe një Zëvendës-kryetar me rotacion mes muslimanëve dhe katolikëve. Ai do të zgjedhë një Sekretar/Arkëtar për të regjistruar dhe shpërndarë procesverbalet dhe për të pranuar, regjistruar dhe për të shpërndarë fondet siç udhëzohet. Zyrtarët do të shërbejnë mandate dyvjeçare duke filluar nga data 1 shtator. Mandatet e zyrtarëve janë të rinovueshme.

3. Përgjegjësitë

DKM do të dorëzojë një raport vjetor për komunitetet pjesëmarrëse çdo vit në shtator për të fituar mbështetjen dhe për të rinovuar anëtarësimin/pjesëmarrjen nga komunitetet përkatëse.

4. Financat

Dioqeza katolike e Qarkut Arlington dhe KKOM së bashku do të sigurojë një buxhet për programe.

5. *Amendamentet*

Amendamentet e këtyre akteve nënligjore mund të bëhen me shumicën e votave të anëtarëve të mëposhtëm pas shqyrtimit të dy mbledhjeve të njëpasnjëshme. Së paku katër anëtarë të secilit komunitet duhet të jenë në favor të amendamentit nën shqyrtim.

6. *Takimet*

VKM do të takohet çdo muaj për të shqyrtuar procesverbalet dhe për të diskutuar ngjarjet e rëndësishme që mund të kenë ndodhur gjatë periudhës dhe të planifikojë aktivitetet e ardhshme. VKM mund të caktojë nën-komitetet për të organizuar takime publike, seminare, ngjarje të veçanta, piknikë dhe vizita në kisha e xhami, për të kapërcyer hendekun dhe për të ndërtuar mirëkuptim plot respekt midis dy besimeve në pjesën e Virgjini-s Veriore dhe më gjerë.

Ky Dokument u dëshmuar dhe u nënshkrua më 30 gusht 2006
Nënshkrimet

Kryepeshkopi Paul S. Loverde
Dr. Jamal Barzinji, VP INMI
Atë Don Rooney
Imam Johari Abdul Malik
Atë John J. Dolan, OSFS
Imami Mohammed Magid
Father Bob Menard, OFM
Imam Abolfazl Nahidian
David Natella
Imam Faizul Khan
Claireen E. Enciso
Dr. Hisham Al Talib
Znj. Elizabeth Troiani
Dr. Iqbal Unus

Dëshmuar nga:

Prifti. Canon Francis Tiso, USCCB
Dr. Muhammad Shafiq, Drejtor Ekzekutiv, QSND dhe Qendra Islame Imam e Roçesterit, NJ

SHTOJCA VI ZOTIMI PËR PËRKUJTIM DHE ANGAZHIMI PËR PAQE

Forumi Ndërfetar i Roçesterit miratoi këtë zotim për paqe dhe për angazhim më 21 prill 2002, për të respektuar njëri-tjetrin dhe për të qëndruar në paqe. Ky zotim thotë:

- Ne jemi njerëz të besimit që lutemi shumë për paqe në botën tonë dhe në komunitetin tonë në këtë kohë të krizës në rritje. Ndërsa disa mund të ndjehen të pafuqishëm për të qenë në gjendje për të ndryshuar rrjedhën e ngjarjeve globale, ne nuk besojmë se jemi shpirtërisht apo politikisht të pafuqishëm. Të gjitha traditat tona na bëjnë thirrje të vlerësojmë çdo jetë njeriu dhe të ngrihemi kundër padrejtësisë dhe për të drejtat e njeriut. Ne besojmë se ka një rol të rëndësishëm që secili prej nesh mund të luajë në pajtim në këtë komunitet – komunitetin tone – me potenciale në botën përtej Roçesterit.
- Ne jemi një komunitet i shquar që ka qenë një model për bashkëpunim ndërfetar. Ne nxjerrim forcën nga përvojat që kemi përjetuar së bashku. Ne besojmë se mund të vazhdojmë të bëjmë vullnetin e Zotit duke u afruar me njëri-tjetri përtej dallimeve tona dhe duke refuzuar që të vihemi kundër njëri-tjetrit.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* që ne nuk mund të presim unanimitet për çështje aq komplekse dhe përplot me dhimbje si ato me të cilat përballemi aktualisht – jo nëpër grupe, as brenda grupeve tona, as edhe brenda zemrave dhe mendjeve tona plot ankth.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* premtimet e marrëdhënieve që mund t’iu rezistojnë trazirave dhe pikëllimit. Ne kujtojmë kur kemi qëndruar me njëri-tjetrin në kohë të vështira dhe zotohemi të mbetemi të përkushtuar për të qenë miq kur bota do të na ndante nga njëri-tjetri.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* se secili akt ka fuqinë për të

shëruar dhe për të na sjellë më afër me njëri-tjetrin ose për të na lënduar dhe ndarë edhe më shumë. Kur ne flasim apo veprojmë publikisht, pavarësisht nga ndjenjat tona të zemërimit apo terrorit apo turpit, ne do të kujtojmë se mund të zgjedhim përgjigjet tona dhe të jemi të ndjeshëm për të mos përdorur fjalë që perceptohen si fjalë që lëndojnë.

- *Ne premtojmë të mos harrojmë* se ne mund të mos jemi në gjendje të ndryshojmë mendimet e të tjerëve, por ne mund të nxisim një klimë të sinqeritetit në të cilën mund të eksplorojmë, me ndjeshmëri dhe me mirëkuptim, historinë, pikëpamjet dhe frikët e të tjerëve.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* të lutemi për shërimin e plagëve tona. Të gjitha zemrat tona po thyhen dhe ne nuk harrojmë se zemra e Zotit është thyer gjithashtu.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* se ne jemi të gjithë fëmijët e Zotit. Si të tillë, ne zotohemi që do t'i ofrojmë njëri-tjetrit shpresë dhe një vizion të një bote të drejtë.
- *Ne premtojmë të mos harrojmë* se shpresa kërkon veprim për t'u plotësuar. Ne zotohemi që do të jemi të guximshëm për të arritur dhe për të bërë diçka çdo ditë për të hapur komunikimin, për të kapërcyer dallimet, për të ofruar dhembshuri, dhe për të sjellë shërim.

SHTOJCA VII DISA PROGRAME MODEL TË DIALOGUT NDËRFETAR

Shembujt ndërftetar të programeve të ekspozimit

SPONSORIZUAR nga Komisioni për marrëdhëniet në mes të krishterëve dhe muslimanëve (KMKM)

Komisioni për Marrëdhëniet në mes të krishterëve dhe muslimanëve të Roçesterit, Nju Jork, ka sponsorizuar shumë programe arsimore për të rritur të kuptuarit e komunitetit për Islammin dhe për të ndërtuar ura për marrëdhëniet në mes të krishterëve dhe muslimanëve. Disa nga programet janë paraqitur si modele për të tjerët që t'i ndjekin ato.

ISLAMI 101:

Komisioni për marrëdhëniet në mes të krishterëve dhe muslimanëve dhe Aleanca Katolike Muslimane paraqesin një orë mësimi mbi Islammin në katër seanca.

1. *Mesazhi dhe i Dërguari:* Në këtë seancë ju do të mësoni për mesazhin e Kuranit dhe për Profetin Muhamed si një i dërguar dhe model i gjallë i Kuranit.
2. *Jeta e muslimanit ditë e natë:* Ky sesion do të përgjigjet në pyetjen, si e kalojnë në të vërtetë muslimanët e vëmendshëm ditën e tyre? Si ndikojnë besimet e tyre në mënyrën se si ata jetojnë jetën e tyre nga çasti në çast. Do të ketë një video që vë në qendër të vëmendjes rininë muslimane.
3. *Xhihadit: Personal dhe publik:* Mediat e lajmeve kanë shndërruar Xhihadin në një fjalë të frikshme, praktikisht në sinonim të terrorizmit. Në të vërtetë koncepti i xhihadit, që do të thotë 'përpjekje,' ka dimensione thellësisht shpirtërore si dhe politike jo vetëm në Islam por edhe në krishterim. Kjo seancë i hulumton këto dimensione, duke punuar paralelisht nga njëra fe në tjetrën.
4. *Gratë në Kuran:* Shumë gra dijetare muslimane u janë kthyer fjalëve të Kuranit për të zbuluar një pohim të qartë të bara-

zisë së burrave dhe grave. Kjo seancë do të përqendrohet në barazinë e gruas në Islam në jetën fetare, shoqërore dhe familjare.

Një seancë shtesë: Dhuna dhe Terrorizmi: Krishterimi dhe Islami.

Praktika e dhunës dhe terrorizmit si mjet për zgjidhjen e çështjeve është në rritje alarmuese në botë. Çfarë është perspektiva e të dy feve për dhunën dhe terrorizmin?

Seancë më e avancuar për Islamin:

Seanca I:

A. Kurani: I shkruar dhe i gjallë

Hyrje: Një shumëllojshmëri e stileve të recitimit të Kuranit nga CDqë shoqëron Michael Sells: *Afrimi ndaj Kuranit, Shpalljet e hershme*. (10 minuta) Kurani i shkruar (20 minuta)

Gjuha: mrekulli, zgjedhja e fjalëve e bën gjuhën Kuranore unike për nga stili (ndryshe nga arabishtja e haditheve).

Përbërja: se si u shpall ai, shkrimi i tij, mënyra se si ai u bashkua në formë të librit dhe ruajtja e tij. **Struktura:** Suret (temat e kapitujve), suret e Mekës (më shpirtërore dhe të orientuara më shumë nga besimi) dhe suret e Medinës (të përqendruara në jetën e përditshme).

Seanca I:

B. Hadithet dhe Suneti: Kurani gjallë (20 minuta)

Hadith: Komentim i Kuranit, nga Profeti Muhamed, i shkruar si shpjegim më i thellë i kuptimit të Kuranit. **Suneti:** formë e pashkruar e jetës së Profetit, çfarë tha, bëri dhe miratoi ai.

Pyetje dhe përgjigje (30minuta). **Diskutim i hapur** (30 minuta).

Seanca II:

Sheriati (Ligji Islam): Zbatimi i tij në kohërat moderne

A. Hyrje (10 minuta)

B. Sheriati Ligji Hyjnor (20 minuta)

1. Rrënjët e Sheriatit në Kuran dhe Sunet.
 2. Sheriati dhe dënimi me vdekje.
 3. Sheriati dhe të drejtat e njeriut.
- C. **Fatva:**Zbatimi dhe rëndësia e saj në Sheriat. (20 minuta)
- D. **Pyetje dhe përgjigje**
(30 minuta)
- E. **Diskutim i hapur**
(30 minuta)

Seanca III:

Seminar për shkencën dhe religjionin (Krijimi)

Seancat e tjera të seminarit:

Titulli: Islami në Amerikë: Shumë fytyra

